

Radical Sense
Völlimi 1

2020

Radical Sense
Vällimi 1

2020
28 November

PËRMBAJTJA

SHËNIM HYRËS RADICAL SENSE	7
GRATË DHE NDERI: DISA SHËNIME MBI TË GËNJYERIT ADRIENNE RICH Përktheu: Doruntina Vinca	11
PËRDORIMI I EROTIKËS: EROTIKA SI PUSHTET AUDRE LORDE Përktheu: Silvi Naçi	25
ZËRI PUBLIK I GRAVE MARY BEARD Përktheu: Anna Shkreli	35
MANIFESTI SKAM VALERIE SOLANAS Përktheu: Doruntina Vinca	43
PAGË KUNDËR PUNËVE TË SHTËPISË SILVIA FEDERICI Përktheu: Vasilika Laçi	83
TEORIA E GRUAS SË SËMURË JOHANNA HEDVA Përktheu: Aurora Birbilaj	97
TEORIA TRASTË E RRËFIMIT URSULA K. LE GUIN Përktheu: Mikela Kakeli	115

TRAGJEDIA E EMANCIPIIMIT TË GRUAS	125
EMMA GOLDMAN Përktheu: Gresa Hasa	
MIDIS PËRGJITHMONË & KUDO KU JE: NJË TRANS POETIKË JO BINARE	137
XTIAN W Përktheu: Silvi Naçi	
RAPORTIM NGA BAHAMAS	145
JUNE JORDAN Përktheu: Doruntina Vinca	
BIOGRAFITË	160

SHËNIM HYRËS

Radical Sense është një grup leximi që lindi nga dëshira për të lexuar, dëgjuar dhe menduar bashkë. Gjatë verës 2018, e gjenim veten duke folur përherë e më shumë për një hapësirë ku mund të lexonim dhe diskutonim letërsi feministe në grup, në një formë më të strukturuar. Emri i grupit doli dhe hyri në jetën tonë nga një libër: në një nga takimet tona, mbi tavolinën ku ishim ulur, kishim librin *On Secrets, Lies, and Silence* (Mbi sekretet, gënjeshtat dhe heshtjen) të autores Adrienne Rich. Nga ndjenja e kënaqësisë së diçka e re po lindte mes nesh, filluam një lojë, ku njëra tha numrin 10, tjetra numrin 7, dhe hapëm librin në faqen 17, dhe vumë gishtin mbi fjalinë ku shkruhej, ndër të tjera, se feminizmi është: "... në kuptimin më të thellë, në sensin më radikal: dashuri për veten, dhe për gratë e tjera, dhe angazhim për lirinë e secilës prej nesh ..."

Leximi është angazhim. Radical Sense u mbledh për herë të parë vetëm dy javë më vonë, në korrik 2018. Hapësirën fizike tashmë e kishim: librarinë 28 November, që e mbante Leah, një hapësirë libri që praktikon edhe lidhjen e librave të fotokopjuar. Nga ajo ditë e deri më sot, kemi redaktuar dhe shpërndarë tetë përmbledhje, duke gjurmuar dhe rizbuluar tekste të autoreve gra, feministe, radikale, queer, dhe zëra të njerëzve të zinj, me ngjyrë, dhe indigjen, dhe të atyre që historikisht janë shtypur dhe lënë në harresë.

Përherë të vetëdijshme për kufitë gjuhësorë gjatë leximeve dhe diskutimeve tona në anglisht, rëndësia e përkthimit të teksteve në gjuhën shqipe ka qenë në thelb të punës tonë. Gjuha e parë, ajo që e quajmë gjuhë amtare, shkon përtej komunikimit të përditshëm. Kjo gjuhë krijon ndërlidhje, bashkon. Letërsia feministe në gjuhën shqipe çon atje ku rrallë kemi shkuar gjuhësisht, atje ku revoltohemi, qeshim, ndiejmë dhimbje dhe zbulojmë të vërteta të pathëna, të qenësishme, për veten, për të tjerët. Kjo gjuhë dhemb disi ndryshe, por mbi të gjitha, shëron.

Më shumë se nje grup leximi, Radical Sense është një artikulum i krijimit të një komuniteti që rritet nëpërmjet praktikës së leximit, dëgjimit dhe përkthimit. Ky vëllim i parë i teksteve feministe në gjuhën shqipe, pasqyron muaj të tërë të një pune të bukur dhe plot dedikim të një grupi përkthimi, që mendon bashkërisht mbi gjuhën, politikën, dëshirat dhe potencialin tonë për të krijuar kurjemi bashkë. Falënderojmë Aurora Birbilajn, Gresa Hasën, Mikela Kakelin, Vasilika Laçin, Anna Shkrelin dhe gjithë ata që aktivisht janë angazhuar gjatë këtij procesi — Ana Zhibajn, Bora Baboçin, Rea Nepravishtën, Barbara Hallën, Simon Battistin e shumë të tjerë. Së bashku kemi përkthyer, lexuar e rilexuar këto tekste, të redaktuara në shqip nga Doruntina dhe nga dashuria për të hapur gjuhën dhe mendjen.

Në këto kohë paqartësie, ne vazhdojmë të mblidhemi dhe të imagjinojmë një botë më të drejtë, më të hapur, më të dashur, me ndjeshmëri kritike dhe përkujdesje për njëri-tjetrin; një jetë që shkon përtej patriarkalizmit, kapitalizmit dhe gjinisë — drejt një bote të drejtë në sensin më radikal.

— Radical Sense, Nëntor 2020

Radical Sense është një grup feminist radikal leximi që mblidhet në librarinë 28 November në Tiranë, Shqipëri. Ky grup udhëhiqet kolektivisht nga Silvi Naçi (lindur në Fier, AL; jeton në Los Angeles, SHBA), Doruntina Vinca (lindur në Prishtinë, KS; jeton në Tiranë, AL), dhe Leah Whitman-Salkin (lindur në Anchorage, SHBA; jeton në Tiranë, AL).

GRATË DHE NDERI: DISA SHËNIME MBI TË GËNJYERIT

Adrienne Rich

1975

Këto shënime janë lexuar për herë të parë në Seminarin Hartwick për Gra Shkrimtare, themeluar dhe drejtuar nga Beverly Tanenhaus, në Kolegjin Hartwick, Oneonta, New York, në qershor të vitit 1975. Janë botuar si pamflet nga Motherroot Press në Pittsburgh, 1977; në Herezi: Revistë feministe për art dhe politikë, vol. 1, no. 1; dhe përkthyer në frengjisht na shtypi feminist kebekez, Les Editions du Remue-Ménage, 1979.

Është e qartë se na duhet një etikë e re ndërmjet grave; si gra, një moral i ri. Problemi i përdorimit të fjalës dhe gjuhës vazhdon të jetë thelbësor. Nëse me të folurën tonë ne theyejmë heshtjet e rrënjosura kaherë, dhe, siç thotë Beverly Tanenhaus, “çlirojmë veten nga sekretet tona”, ky në vetvete mund të ishte hapi i parë. E kam shkruar Gratë dhe nderi si përpjekje për të qenë më e sinqertë, dhe për ta kuptuar forcën tmerrësisht negative të gënjeshtërs në marrëdhëniet mes grave. Që nga koha kur është botuar kjo ese, edhe gra të tjera kanë folur dhe shkruar mbi aspekte që unë nuk i kam trajtuar: “Notes on Speechlessness” (Shënime mbi pafjalësinë) nga Michelle Cliff në Sinister Wisdom, nr. 5, që e shtyu edhe Catherine Nicolson të shkruajë (në të njëjtin botim) mbi forcën e “shurdhësisë”, dhe frustrimin e fjalëve tona nga ata që nuk duan të dëgjojnë çfarë kemi për të thënë. Nelle Morton ka shkruar mbi aktin e “dëgjimit të njëra-tjetrës në të folur”.¹ Si të dëgjojmë? Si mund t’ia bëjmë të mundur dikujt ta thyejë heshtjen e saj? Këto janë disa pyetje që plotësojnë pyetje të tjera që kam parashtruar më poshtë.

(Këto shënime trajtojnë marrëdhëniet mes dhe ndërmjet grave. Kur flas për “marrëdhënie personale”, e kam fjalën për marrëdhënien

1. “Beloved Image!” nga Nelle Morton, ese e lexuar gjatë Konferencës Kombëtare të Akademisë Amerikane të Religjionit, San Francisco, California, 28 dhjetor 1977.

mes dy grave. Do të jetë e shkruar qartë në tekstin më poshtë kur flitet për marrëdhëniet mes grave dhe burrave.)

Ideja e lashtë, mashkullore, e nderit. Mjaftonte “fjala” e burrit, thënë një burri tjetër, pa asnjë garanci tjetër.

“Toka jonë e lirë, burrat tanë të ndershëm, gratë tona pjellore” — dollari e njohur koloniale në Amerikë.

Nderi i burrave ka të bëjë edhe me vrasjen: *Nuk mund të të doja, e dashur, kaq shumë/Nderin po mos e doja edhe më shumë.*² Nderi i burrave ka të bëjë edhe me nevojën për t’u hakmarrë: dueli, si rezultat.

Nderi i grave, diçka krejt tjetër: virgjinitet, dëlirësi, besnikëri ndaj burrit. Sinqeriteti tek gratë nuk konsiderohej i rëndësishëm. Përgjithësisht, për ne mendohej se jemi tekanjoze, dinake, delikate, të paqëndrueshme. Dhe na kanë shpërblyer kur kemi gënjyer.

Nga burrat gjithmonë është pritur që ta thonë të vërtetën mbi faktet, por jo mbi ndjenjat. Nga ta nuk pritej kurrë që të flisnin për ndjenjat e tyre.

Por, edhe mbi faktet, ata kanë gënjyer vazhdimisht.

Ne supozojmë se të gjithë politikanët janë të pandershëm. I lexojmë deklaratat e tyre, dhe tentojmë të lexojmë mes rreshtash. Politika e tyre plot skandale: jo vetëm për shkak se burrat në pozita të larta gënjejnë, por se ata gënjejnë aq paftyreshëm, aq pandërprerë, dhe prapë presin t’u besojmë. Jemi mësuar me mospërfilljen si pjesë e qenësishme e gënjeshtërisë politike.

• • •

Megjithatë, kur zbulon se në një marrëdhënie personale dikush të ka gënjyer, kjo pak të çmend.

2. “Lukastës, Duke shkuar në luftë”, poezi e njohur nga poeti amerikan Richard Lovelace.

• • •

Mund të gënjeshtrosh me fjalë, por edhe me heshtje.

Një grua që thotë gënjeshtro në marrëdhëniet e saj personale, gënjen me ose pa dashje. Ndoshta ajo nuk e mendon këtë si një veprim të llogaritur të saj.

Hapet një temë të cilën personi që gënjen dëshiron ta fshehtë. Duhet të zbres deri poshtë, thotë ajo, se po më kalon orari i pagesës së parkimit. Ose, se duhet ta bëjë një telefonatë të cilën duhet ta kishte bërë para një ore.

E pyesin hapur mbi një temë të dhimbshme për të: “Si ndihesh për këtë që po ndodh mes nesh?”, në vend se t’i përshkruajë ndjenjat e veta me gjithë paqartësinë dhe konfuzitetin e tyre, ajo pyet “Po *ti* si ndihesh?” Tjetra, në përpjekjen e saj për të krijuar një atmosferë sinqeriteti dhe besimi mes tyre, fillon dhe përshkruan ndjenjat e saj. Kështu, ajo që gënjen mëson (merr) më shumë sesa që rrëfen (jep).

Ajo mund edhe ta gënjejë veten: sikur ajo po shqetësohet më shumë për ndenjat e tjetrës, sesa për të vetat.

Por, ajo që gënjen shqetësohet për ndjenjat saj.

Ajo që gënjen jeton me frikën se do të humbë kontrollin. Ajo as nuk dëshiron një marrëdhënie pa manipuluar, sepse të jesh e brishtë në praninë e dikujt tjetër, do të thotë të mos kesh kontroll.

Ajo që gënjen ka shumë shoqe, por jeton në vetmi të madhe.

• • •

Gënjeshtarja shpesh vuan nga harresa. Harresa është heshtja e të pavetëdijshmes.

Ta kesh zakon gënjeshtren, si mënyrë jetese, do të thotë të mos kesh kontakt me të pavetëdijshmen. Është si të marrësh ilaçe për gjumë, që të japin gjumë, por t’i fshijnë ëndrrat. E pavetëdijshmja

kërkon të vërtetën. Dhe nuk flet me ato që duan diçka tjetër, më shumë sesa të vërtetën.

Kur flasim për gënjeshtat, nuk mund t'i shmangemi subjektit të së vërtetës. E vërteta nuk është as e thjeshtë dhe as e lehtë. Nuk ka “të vërtetë”, “një të vërtetë” — e vërteta nuk është diçka, nuk është as sistem. Është një kompleksitet në rritje. Motivet e një qilimi janë në sipërfaqe. Kur e shohim nga afër, apo kur ulemi dhe e endim vet, mësojmë se duhen shumë thurje për t'i krijuar këto motive, dhe të gjitha lidhen nyje poshtë qilimit.

Kjo është arsyeja pse të provosh të flasësh me sinqeritet është kaq e rëndësishme. Për atë që gënjen, gënjeshtat janë përpjekje për t'i thjeshtësuar gjërat, për t'i bërë më të thjeshta se që janë, ose se që duhet të jenë.

Duke gënjyer të tjerët, gënjejmë edhe veten. Kur mohojmë rëndësinë e një ngjarjeje, ose të një personi, e privojmë veten nga një pjesë e jetës sonë. Ose kur përdorim diçka nga e kaluara, ose e tashmja, për të filtruar diçka tjetër. Kështu na zbehet besimi edhe në vetë jetën tonë.

E pavetëdijshmja kërkon të vërtetën, ashtu siç e kërkon edhe trupi. Kompleksiteti dhe pjelloria e ëndrrave tona burojnë nga kompleksiteti dhe pjelloria e të pavetëdijshmes sonë, në përpjekjen e saj për ta plotësuar këtë dëshirë. Kompleksiteti dhe pjelloria e poezisë burojnë nga e njëjta luftë.

• • •

Një marrëdhënie e ndershme njerëzore — ku dy persona e kanë lirinë ta përdorin fjalën “dashuri” — është një proces i ndjeshëm, i dhunshëm dhe shpesh i llahtarshëm për të dy personat e përfshirë, është një proces ku të vërtetat që mund t'i thuhen njëri-tjetrit rafinohen.

Ky proces është i rëndësishëm, sepse shpërbën vetëmashttrimin dhe izolimin njerëzor.

Ky proces është i rëndësishëm, sepse kështu i qëndrojmë besnike kompleksitetit tonë.

Ky proces është i rëndësishëm, kur e dimë mirë se sa e vështirë është të gjesh dikë tjetër me të cilën mund t'i shkosh kësaj rruge deri në fund.

• • •

I kthehem përsëri çështjes së nderit të gruas. E vërteta nuk është konsideruar kurrë e rëndësishme për gruan, për sa kohë ne ishim të dëlira, dhe i rrinim fizikisht besnike burrit.

Nga ne pritej të gënjejmë me trupat tanë: t'i lyejmë flokët e verdha, të kuqe, t'i drejtojmë apo dredhojmë, t'i hollojmë vetullat, rruajmë nënsjetullat, të mbajmë mbushje në pjesë të ndryshme të trupit, t'i mbulojmë ato me tyl, të ecim me hapa të vegjël, t'i lyejmë thonjtë e duarve e këmbëve, të veshim rroba që e bëjnë më të dukshme pafuqinë tonë.

Nga ne është kërkuar të gënjejmë për gjëra të ndryshme, në kohë të ndryshme, varësisht nga çfarë burrat e kohës donin të dëgjonin. Nga gratë e kohës viktoriane apo gratë e bardha të jugut, pritej të mos ishin sensuale, ato duhej të "rrinin shtrirë, dhe mos bëzajnë"; nga gratë "e lira" të shekullit njëzet pritej t'i shtirnin orgazmat.

E vërteta e trupave tanë na është fshehur dhe na është shtrembëruar; na kanë mbajtur injorante mbi pjesët tona më intime. Na kanë dënuar për instinktet tona: klitoriktemi për gjithë murgeshat "epshërore" dhe gratë "e vështira". E kemi pasur të vështirë ta kuptonim rolin që luanin gënjeshttrat tona, në gënjeshttrat që besonim.

Për gënjeshtren e shtëpisë, "e martesës së lumtur", për shembull, kemi bashkëpunuar, kemi vepruar sipas përrallës mbi jetën e mirë, derisa një ditë kemi dëshmuar në gjyq mbi përdhunimet, rrahjet, keqtrajtimet psikologjike, poshtërimet private dhe publike.

Gënjeshtria patriarkale i ka manipuluar gratë nëpërmjet shtirjes dhe heshtjes. Faktet që na janë dashur, na i kanë fshehur. Dëshmitarë të rremë kanë dëshmuar kundër nesh.

Dhe ne duhet ta marrim seriozisht çështjen e të vërtetës mes grave, vërtetësinë ndër gra. Kur nuk gënjejme më me trupat tanë, dhe nuk besojmë më në ato çfarë burrat kanë thënë për ne, a nuk është kjo zanafilla e idesë së vërtetë të nderit të gruas?

• • •

Gratë, për të mbijetuar, janë detyruar t'i gënjejnë burrat. Por si ta çmësojmë këtë në raport me gratë e tjera?

“Gratë gjithmonë e kanë gënjyer njëra-tjetrën”.

“Gratë gjithmonë i kanë përshpëritur të vërtetën njëra-tjetrës”.

Të dyja këto aksioma janë të vërteta.

“Gratë gjithmonë kanë qenë kundër njëra-tjetrës”.

“Gratë gjithmonë kanë pasur marrëveshje të fshehta mes tyre”.

Të dy këto aksioma janë të vërteta.

Gjatë luftës për mbijetesë ne gënjejme. Gënjejme eprorët tanë, rojet e burgjeve, policët, burrat që kanë pushtet mbi ne, ata që ligjërisht na zotërojnë ne dhe fëmijët tanë, dashnorët të cilët na duan për të dëshmuar burrërinë e tyre.

Ekziston një rrezik që u kanoset të gjithë të pafuqishmëve: që gënjeshtria kthehet në zakon, apo që të gënjyerit bëhet armë që ne e përdorim edhe në marrëdhëniet me ata që nuk kanë aspak pushtet mbi ne.

• • •

Dua të theksoj se kur flitet për gratë dhe nderin, apo gratë dhe të gënjerit, flitet brenda kontekstit të të gënjerit mashkullor, gënjeshtreve të atyre që kanë pushtet, gënjeshtreve si një burim i rrejshëm pushteti.

Ne gratë duhet të mendohemi mirë nëse duam një pushtet të tillë, që arrihet duke gënjyer, në marrëdhëniet tona me njëra-tjetrën.

Me shekuj gratë gati sa s'janë çmendur nga manipulimi psikologjik, nga mohimi i përjetimeve dhe instinkteve tona, nga një kulturë që vlerëson vetëm përvojën mashkullore. Na është mistifikuar e vërteta e trupave dhe mendjeve tona. Prandaj, kemi një detyrim parësor ndaj njëra-tjetrës: që të mos e nënçojmë ndjenjën që mund të ketë tjetra mbi realitetin, edhe kur kështu është më e lehtë, dhe të mos e manipulojmë njëra-tjetrën.

Gratë janë ndierë sikur janë të çmendura, sa herë kanë folur hapur mbi të vërtetën e përvojave tona. E ardhmja jonë varet nga shëndeti i mendjes tonë, i secilës prej nesh, dhe të gjitha kemi hise, përtej personales, në projektin e përbashkët të përshkrimit të realitetit tonë, në tërësinë e plotë dhe me gjithë sinqeritetin e mundur.

• • •

Kemi edhe shprehje që na e bëjnë më të lehtë fshehjen e të vërtetës: “është jeta ime”, “punë për mua”. Mënyra se si artikuloohen këto shprehje mund edhe të arsyetohet, por duhet patjetër të mendojmë mbi kuptimin e plotë të kësaj gjuhe, dhe mbi pasojat e saj.

Dashuria që gratë ndiejnë për gratë është përshkruar gjithmonë me heshtje dhe gënjeshtër. Institucioni i hetereo-seksualitetit ka detyruar lezbiket të shtiren, dhe i ka quajtur gra perverse, kriminele, të sëmura dhe të rrezikshme. Për këtë arsye, lezbikja është detyruar të gënjejë, njëlloj si prostitutat apo gratë e martuara.

Kjo jetë e pasinqertë, “e mbyllur” — ku gënjejmë, ndoshta nga nevoja, eprorët, klientët, kolegët, familjen tonë, sepse ligji

dhe opinioni publik i kanë themelet mbi gënjeshtër — a përhapet kjo, a e kaplon kjo jetën tonë private, duke e bërë të gënjerit (që ndryshe e njohim si *diskrecion*) në diçka që e bën të lehtë t'i ikim konflikteve dhe komplikimeve? A ndodh që e përbrendësojmë si strategji, dhe përfundojmë duke e përdorur atë edhe me shoqërinë e afërt dhe me më të dashurit tanë?

Heteroseksualiteti si institucion i ka zhytur në harresë edhe ndjenjat erotike mes grave. Edhe unë e kam jetuar gjysmën e jetës në gënjeshtër dhe mohim. Heshtja na bën të gjithave, deri diku, gënjeshtare.

Kur një grua e thotë të vërtetën, ajo krijon mundësinë për më shumë vërtetësi rreth saj.

• • •

Gënjeshtarja bën një jetë tmerrësisht të vetmuar.

Gënjeshtarja ka frikë.

Por ne të gjitha kemi frikë: pa frikë ne bëhemi maniake, mburravece, vetshkatërruese. Çfarë lloj frike është kjo që e përshkon gënjeshtaren?

Ajo ka frikë se të vërtetat e saj nuk janë mjaft të mira.

Ajo ka frikë, jo nga gardianët e burgut dhe shefat, por nga diçka brenda saj që nuk ka emër.

Ajo ka frikë nga hiçi.

Hiçin nuk e krijon patriarkalizmi, racizmi apo kapitalizmi. Dhe as nuk do të zhduket bashkë me një nga këto. Është pjesë e çdo gruaje.

“Thelbi i errët”, e pati quajtur Virginia Woolf, kur shkruante për nënën e saj. Thelbi i errët. Shkon përtej personalitetit; përtej atyre që na duan ose na urrejnë.

Ne ngrihemi nga hiçi, nga errësira dhe boshllëku. Është pjesë e ciklit që e njihnin fetë e vjetra pagane, por që materializmi e

mohon. Nga vdekja, rilindja; nga asgjë, diçka.

Hiçi është kreatrica, matrica. Nuk është thjesht zbrazëti dhe anarki. Por te gratë e kanë barazuar me mungesë dashurie, bjerrësi, shterpësi. Na kanë shtyrë ta përmbushim “boshllëkun” tonë me fëmijë. Ne nuk duhej as ta merrnim atë rrugë, nëpër errësirën e thelbit.

Por, kur guxojmë, ajo që lind nga ky hiç është fillimi i të vërtetës tonë.

Në lemerinë e saj, gënjeshtarja kërkon ta përmbushë boshllëkun me çkado. Gënjeshttrat e saj janë mohim i frikës së saj; një mënyrë për t'i mbajtur gjërat nën kontroll.

Pse ndihemi pak si të çmendura kur e kuptojmë se na kanë gënjyer në një marrëdhënie?

Marrim kaq shumë nga universi, sepse besojmë. Ti më thua: “Në vitin 1950, unë jetoja në anën veriore të rrugës Beacon në Somerville”. Ti më thua: “Unë dhe ajo ishim të dashura, por ka disa muaj që jemi vetëm shoqe të mira”. Ti më thua: “Jashtë është 20 gradë, dhe po shkëlqen dielli”. Për shkak se unë të dua, për shkak se nuk e kam as më të voglin dyshim se mes nesh mund të ketë gënjeshtër, unë i pranoj rrëfimet e universit në mirëbesim: adresën tënde para njëzetepesë vitesh, marrëdhënien tënde me dikë që unë e njoh nga larg, motin sot në mëngjes. Unë hedh lozat e mia të pavetëdijshme të besimit, si dredha të njoma të pranverës, nëpër këto pohime pa nënkuptime, që nuk përmbajnë asnjë hije dyshimi ose qëllimi. Me to ndërtoj mozaikun e botës time. E lejoj universin tim të ndryshojë thellësisht në atë çast, duke u bazuar në ato që ti më thua dhe në besimin që unë kam tek ti.

Kam edhe besim se ti më thua gjëra që unë e kam të rëndësishme t'i di; se ti nuk fsheh fakte nga unë, për të më kursyer mua, ose veten tënde, nga dhimbja.

Ose, së paku, besoj se do të më thuash: “Ka disa gjëra që nuk mund të t'i them”.

Kur kuptojmë se nuk mund mund t'i besojmë më dikujt që i kemi besuar deri dje, kjo na bën ta vëmë në pikëpyetje universin tonë, të dyshojmë në instinktin dhe kuptimin tonë të besimit. Kjo mund të na kthejë pas, për një kohë, të na përplasë në greminat e thella të dëshpërimit, në errësirën e përfshirë nga flakë përcëlluese, të vërshuara nga shiu i fortë, në një botë ku ta ndjesh dikë si familje, emrat përkëdhelës dhe brishtësia, nuk ekzistojnë; kthehemi në prag të çrregullësisë.

• • •

Gënjeshtarja mund t'i rezistojë përballjes, dhe ta mohojë se ka gënjyer. Ose mund të përdori gjuhë tjetër: harresën, privatësinë, mbrojtjen e dikujt tjetër. Ose, trimërisht ta pranojë qyqarinë e saj. Kjo e lejon atë të vazhdojë të gënjejë, sepse kjo është ajo çfarë bëjnë frikacakët. Ajo nuk thotë, *pata frikë*, sepse kjo gjë do të ngrinte diskutim mbi format e tjera të ballafaqimit me frikën e saj. Do të shtronte edhe pyetjen se çfarë e shkakton këtë frikë.

Ajo mund të thotë, *nuk doja të shkaktoja dhimbje*. Në të vërtetë ajo thjesht nuk do të ketë punë me dhimbjen e tjetrës. Gënjeshtria është rrugë më e shkurtër për të arritur te tjetri.

• • •

E vërteta, nderi, nuk është flakë që ndizet vetvetiu; ajo krijohet mes nesh.

Kjo vlen edhe në situata politike. Se sa vlerë dhe thellësi ka politika që buron nga një grup, varet shumë nga mënyra se si ata e kuptojnë nderin.

Një pjesë e madhe e asaj që ngushtësisht quhet “politikë” duket se bazohet në dëshirën për qartësi, edhe në kurriz të sinqeritetit, me analiza që artikulojnë njëherë e mirë, pa nevojë për

rishqyrtim. E tillë është mosrrugëdalje-shmëria — për gratë — e Marksizmit të kohës sonë.

Vërtetësia çdokund do të thotë më shumë kompleksitet. Por është edhe hap drejt evolucionit. Ne gratë vetëm sa kemi filluar t'i shpalosim të vërtetat tona; shumë nga ne do të ishim të lumtura po të na jepej një moment pushimi në këtë betejë, dhe me kënaqësi do të shtriheshim mbi këto rrënoja që me aq shumë dhimbje i kemi gërmuar, dhe vetëm kaq do të na mjaftonte. Shpesh e përjetoj këtë si një rraskapitje brenda trupit tim.

Politikat dhe marrëdhëniet e vetme që ia vlenë t'i mbajmë, janë ato që kërkojnë nga ne të gërmojmë edhe më thellë.

• • •

Mundësitë që ekzistojnë brenda dy njerëzve, ose brenda një grupi njerëzish, janë një lloj alkimie. Vetëm këto e bëjnë interesante jetën tonë. Ajo që gënjen nuk arrin kurrë t'i shohi këto mundësi.

Kur marrëdhëniet kushtëzohen nga manipulimi, nga nevoja për kontroll, ato përmbajnë në vete një lloj drame të lodhshme, të vazhdueshme, por nuk janë më as interesante. Ato janë të përsëritshme; tronditja që vjen nga mundësitë njerëzore, nuk bën më jehonë.

Kur dikush ma thotë një të vërtetë të cilën nuk ma kishin thënë, dhe të cilën unë kisha nevojë ta dija për ta parë jetën time më qartë, kjo mund të më shkaktojë shumë dhimbje, por mund edhe të më përplasit si një dallgë e ftohtë e lehtësuese çlirimi. Shpesh këto lloj të vërtetash thuhet padashje, ose nga të panjohurit.

Për një marrëdhënie të ndershme me ty, nuk do të thotë se unë duhet të di gjithçka për ty, ose se duhet të t'i them të gjitha përnjëherë, dhe nuk mund as t'i di, paraprakisht, të gjitha ato që kam nevojë të t'i them.

Por, do të thotë se unë shumicën e kohës kam etje dhe ndjej mall, për mundësinë e të folurit me ty. Se këto mundësi mund të më duken të frikshme, por jo të dëmshme. Se unë ndihem mjaft e fortë për të dëgjuar fjalët e tua të ndrojtura, dhe ato fjalë që ti me zor i gjen. Se ne të dyja e dimë se po mundohemi, gjatë gjithë kohës, të hapim mundësitë e të vërtetës mes nesh.

Mundësinë e jetës mes nesh.

Përktheu: Doruntina Vinca

PËRDORIMI I EROTIKËS: EROTIKA SI PUSHTET

Audre Lorde

1978

Ka shumë lloje pushteti, të përdorura dhe të papërdorura, të pranuar ose jo. Erotika është një pasuri brenda secilit prej nesh që buron nga një anë thellësisht femërore dhe shpirtërore, thellë e rrënjësor në forcën e ndjenjave tona të pathëna dhe të panjohura. Për ta mirëmbajtur pushtetin, agresorit i duhet të korrtojë ose të shtrembërojë të gjitha burimet e fuqisë të cilat, kur përdoren nga të shtypurit, mund të ofrojnë forcë për ndryshim. Tek gratë kjo ka nodhur nëpërmjet shtypjes së erotikës, që mendohej të ishte burim i fuqisë dhe njohurisë në jetët tona.

Na kanë mësuar të dyshojmë tek ky burim kaq i përfolur, i keqtrajtuar, i zhvlerësuar nga shoqëria perëndimore. Nga njëra anë është inkurajuar erotika sipërfaqësore, si shenjë e inferioritetit femëror; nga ana tjetër, gratë janë detyruar të vuajnë dhe të ndihen të përbuzura dhe, njëkohësisht, të dyshimta për këtë arsye.

Vetëm një hap i vogël e ndan këtë nga ideja e gabuar se vetëm duke e shtypur erotikën brenda jetës dhe vetëdijes sonë, gratë mund të jenë realisht të forta. Por kjo është një forcë e shtirur, sepse është brumosur brenda kontekstit mashkullor të modeleve të pushtetit.

Si gra, kemi arritur deri në atë pikë sa kemi humbur besimin tek forca që na buron nga njohuritë tona më të thella dhe joracionale. Jemi shtyrë deri në këtë pikë, gjatë gjithë jetës sonë, nga bota mashkullore e cila e vlerëson këtë thellësi të ndjenjës vetëm për atë kohë sa gratë t'u rrinë pranë, për t'u shërbyer atyre, ndërkohë që frika nga kjo thellësi është atëherë e madhe sa nuk i lejon ata ta kërkojnë brenda vetes së tyre. Gratë, pra, mbahen në një pozitë inferiore për t'u mjellë mendërisht e shpirtërisht, ngjashëm me milingonat që përkujdesen që kolonitë e tyre të afidëve, të ofrojnë mjaftueshëm lëndë jetike për padronët e tyre.

Por, për një grua që ka guxim ta përqafojë, erotika është si një gurrë force që rigjeneron dhe provokon, dhe që nuk i nënshtrohet bindjes se ndjesia në vetvete mjafton.

Burrat shpesh i kanë dhënë emër të gabuar erotikës dhe e kanë përdorur atë kundër grave. E kanë reduktuar në një ndjesi të paqartë, të kotë, psikotike, e të plastifikuar. Për këtë arsye, ne kemi përfunduar duke mos e kërkuar erotikën dhe duke mos e konsideruar atë si një burim force dhe njohurie. Përkundrazi, e kemi ngatërruar me të kundërtën, me pornografinë. Por pornografia është mohim i drejtpërdrejtë i fuqisë së erotikës, sepse përfaqëson shtypjen e ndjenjës së vërtetë. Pornografia i jep rëndësi ndjesisë pa ndjenjë.

Erotika shtrihet mes ndjenjës sonë fillestare për veten, e deri te kaosi i ndjenjave tona më të fuqishme. Është një ndjenjë e përbrendësuar e gëzimit, të cilin, nëse e përjetojmë vetëm njëherë, do ta dëshirojmë përsëri. Kur përjetojmë një ndjenjë aq të plotë dhe aq të thellë dhe e kuptojmë fuqinë e saj, për hir dhe respekt ndaj vetes, nuk mund të kërkojmë asgjë më pak nga vetja.

Nuk është aspak e lehtë të kërkojmë më të mirën nga vetja, nga jeta, nga puna jonë. Të nxisësh më të mirën, do të thotë të shkosh përtej mediokritetit që nxit shoqëria kur kërkon këtë gjë nga ne. Por, t'i dorëzohesh frikës së ndjenjave dhe të arrish potencialin tënd të plotë, ky është privilegj që arrihet vetëm nga ata që e bëjnë paqëllim, dhe ata që e bëjnë paqëllim, janë ata që nuk kërkojnë të jenë zot të fateve të tyre.

Dëshirën e brendshme për të arritur përsosmërinë, që na e mëson erotika, nuk duhet ta keqinterpretojmë si një kërkesë për të pamundurën nga vetja apo nga të tjerët. Një kërkesë e tillë do ta pengonte këtë rrugëtim. Erotikës nuk i intereson çfarë bëjmë; asaj i intereson se sa e thellë dhe sa e gjerë është ndjenja gjatë këtij rrugëtimi. Kur kuptojmë se sa larg shkon mundësia jonë për të ndierë kënaqësi dhe për t'u përmbushur, vetëm atëherë mund të shohim se cilat rrugëtime jete na çojnë më afër kësaj ndjenje.

Qëllimi i çdo veprimi që bëjmë është të pasurojmë dhe ta bëjmë sa më të mundur jetën tonë dhe të fëmijëve tanë. Duke i thurur lavde erotikës në çdo përpjekje, puna ime kthehet në një

vendim të ndërgjegjshëm — një shtrat aq i dëshiruar në të cilin bie plot mirënjohje dhe nga ku ngrihem e fuqizuar.

Natyrisht, gratë kaq të fuqizuara janë të rrezikshme.

Prandaj na kanë mësuar ta ndajmë nevojën erotike nga pothuajse çdo aspekt i rëndësishëm i jetës, përveç seksit. Dhe fakti që ne e shpërfillim rrënjën dhe kënaqësinë erotike të punës sonë, manifestohet me pakënaqësitë që ne i ndiejmë në kaq shumë gjëra që bëjmë. Për shembull, sa e duam vërtet punën tonë, sidomos kur bëhet e vështirë?

Tmerri kryesor i çdo sistemi që e përkufizon të mirën në bazë të kushteve të fitimit dhe jo të nevojave njerëzore, apo që përkufizon nevojën njerëzore duke përjashtuar anën shpirtërore dhe emocionale të kësaj nevoje — tmerri kryesor i një sistemi të tillë është se e zhvat punën, jetën dhe përmbushjen tonë nga vlera dhe fuqia e saj erotike. Ky sistem e redukton punën në një parodi nevojash bazike, në një detyrë nga e cila fitojmë bukën e gojës, ndërkohë që braktisim veten dhe ata që duam. Kjo është si po t'ia verbonim sytë një piktores dhe më pas t'i kërkonim asaj të pikturojë më mirë, por, njëkohësisht edhe të shijojë aktin e pikturimit. Kjo jo vetëm që do të ishte disi e pamundur, por do të ishte edhe thellësisht mizore.

Si gra, ne duhet t'i shqyrtojmë mundësitë se si bota jonë mund të ndryshojë vërtet. Paramendoj domosdoshmërinë e rivlerësimit të cilësisë së të gjitha aspekteve të jetës dhe punës tonë, dhe se si mund të lëvizim drejt dhe nëpërmjet tyre.

Vetë fjala *erotikë* vjen nga fjala greke *eros*, pra mishërim i dashurisë në të gjitha kuptimet — lindur nga Kaosi, që personifikon fuqinë dhe harmoninë krijuese. Kur flas për erotikën, atëherë flas për frymën e forcës së jetës së grave; të asaj energjie të fuqishme krijuese, të cilën sapo kemi rifilluar ta njohim dhe ta përdorim nëpërmjet gjuhës, historisë, vallëzimit, dashurisë, punës dhe jetës sonë.

Përherë ka pasur përpjekje për të barazuar pornografinë me erotizimin, dy përdorime diametralisht të kundërta të seksuales. Për shkak të këtyre përpjekjeve, e kemi bërë zakon ta ndajmë anën shpirtërore (psikike dhe emocionale) nga ajo politike, duke i parë ato si kontradiktore apo armiqësore. “Për çfarë e ke fjalën, kur thua një revolucion poetik, një i armatosur që mediton?” Në të njëjtën mënyrë, kemi provuar të ndajmë shpirtëroren nga erotikja, duke e reduktuar kështu shpirtëroren në një botë të ndikimit të rrafshët, një botë asketike që aspiron të mos ndiejë asgjë. Por e vërteta është krejt ndryshe. Pozita e asketit është një nga më të frikshmet, më të palëvizshmet. Të heqësh dorë nga çdo gjë, kthehet në obsesionin tënd më qenësor. Dhe nuk është çështje vetëdisipline, por vetëmohimi.

Dikotomia mes shpirtit dhe politikës është gjithashtu e rreme, dhe vjen si pasojë e dështimit tonë për t'i kushtuar vëmendje njohurisë tonë erotike. Ura që i lidh këto dyja përbëhet nga erotikja — nga sensualja — nga ato shprehje fizike, emocionale dhe psikike të anës sonë më të thellë, më të fortë dhe më të pasur brenda secilit prej nesh, dhe të cilën ne e ndajmë me të tjerët: pasionet e dashurisë, në kuptimin më të thellë.

Përtej kuptimit sipërfaqësor, thënia “kjo më bën të ndihem mirë”, e njeh forcën e erotikës si një dije të vërtetë, si një fanar drite që na udhëheq drejt kuptimit të gjithçkasë. Dhe të kuptuarit është thjesht ajo shërbëtorja që e mirëpret njohurinë që na buron nga thellë, dhe hedh dritë mbi të. Erotika është ajo që ushqen dhe përkujdeset për njohuritë tona më të thella.

Erotika për mua funksionon në disa nivele, dhe mbi të gjitha në fuqizimin që ndodh atëherë kur përfshihesh dhe ndan, thellësisht, një përpjekje me dikë tjetër. Të ndash gëzimin tënd, qoftë fizik, emocional, mendor apo intelektual, krijon lidhje me ata që marrin pjesë, dhe kjo krijon edhe mundësinë për të kuptuar çfarë kemi dhe nuk kemi të përbashkët, dhe dobësojnë rrezikun nga dallimet mes nesh.

Një formë tjetër e rëndësishme se si operon lidhja erotike, është manifestimi krejt i hapur dhe i patrembur i kapacitetit tim për gëzim. Kur ndiej trupin tim që hapet ndaj tingujve të muzikës, kur dëgjoj ritmet më të thella të saj, sa më shumë që hapem ndaj thellësisë së ndjesisë sime, aq më shumë e ndiej si një përvojë kënaqësie erotike, kur vallëzoj, kur rregulloj raftin tim me libra, kur shkruaj një poezi, apo kur bie në mendime.

Kjo vetë-lidhje që ndaj me të tjerët është matësi i gëzimit që e di se jam në gjendje ta ndiej, dhe më shërben për të më kujtuar kapacitetin tim për të ndier. Dhe kjo njohuri e thellë dhe e pazëvendësueshme e aftësisë sime për gëzim, vjen dhe kërkon nga unë që ta jetoj gjithë jetën time kështu, duke e ditur mirë se kjo lloj kënaqësie është e mundur, dhe nuk ka pse mban emrin as *martesë*, as *zoë*, as *amshim*.

Kjo është një nga arsyet pse erotika ngjall aq shumë frikë, dhe pse, edhe atëherë kur pranohet, e gjejmë të dëbuar dhe të strukur brenda mureve të dhomës së gjumit. Vetëm kur fillojmë ta ndiejmë çdo aspekt të jetës sonë thellësisht, vetëm atëherë kërkojmë që në çdo hap të jetës tonë, të jemi në harmoni me gëzimin që e dimë mirë se kemi aftësi ta përjetojmë. Njohuria jonë erotike na fuqizon, ajo kthehet në lenten nëpërmjet së cilës ne vështrojmë ekzistencën tonë me të gjitha ngjyrat e saj, dhe na detyron që krejt sinqerisht të vlerësojmë kuptimet e vërteta të çdo aspekti të jetës. Dhe kjo është një përgjegjësi e madhe, që projektohet nga brendia e secilit prej nesh, dhe na bën të mos përfundojmë duke bërë një jetë të rehatshme, të rëndomtë, konvencionale, apo që thjesht na jep siguri.

Mbaj mend dikur, gjatë Luftës së Dytë Botërore, blinim një lloj margarine të bardhë e pa ngjyrë, të paketuara në qese të mbyllura plastike, që kishin një si toptë me ngjyrë të verdhë e të fortë, që dukej si një topaz brenda pakos transparente. E linim margarinën jashtë për njëfarë kohe për t'u zbutur, dhe më pas e shtypnim

topthin për të shpërthyer brenda pakos, që të lëshonte verdhësinë e plotë brenda masës së zbutur të margarinës. Më pas, duke e mbajtur me kujdes mes gishtave, e lëviznim butësisht lart e poshtë, pa pushim, derisa ngjyra të përhapej në të gjithë qesen, duke e ngjyrosur të gjithë margarinën.

Erotikën e shoh si një bërthamë të tillë brenda vetes time. Kur çlirohet nga lëvozhga e saj e fortë dhe kufizuese, ajo rrjedh dhe ngjyros jetën time me një energji që lartëson, sensibilizon dhe forcon gjithë përvojën time.

Jemi rritur me frikën për t'u thënë *po* dëshirave tona më të thella, në brendinë tonë. Por, vetëm kur arrijmë t'i njohim, ato dëshira që nuk e lartësojnë më ardhmërinë tonë e humbasin fuqinë dhe ne mund të arrijmë t'i ndryshojmë. Frika nga dëshirat i bën ato të dyshimta dhe të fuqishme, pa përjashtim, sepse të shkelësh mbi një të vërtetë, do të thotë t'i japësh më shumë fuqi sesa që mund të përballojë. Frika se nuk mund të rritemi përtej gjithë përçudnimeve që i gjejmë te vetja, na mban të urta, të bindura, besnike, dhe na detyron të pranojmë shtypjen ndaj nesh, si gra, në shumë dimensione.

Kur jetojmë jashtë vetes, pra sipas udhëzimeve që na vijnë nga jashtë, dhe jo sipas njohurisë dhe nevojave tona të brendshme, kur jetojmë larg shtytjeve erotike që na vijnë nga brendia, atëherë jeta jonë kufizohet nga trajta të huaja dhe të jashtme, dhe ne i nënshtrohemi nevojave të një strukture që nuk ndërtohet mbi nevoja njerëzore, e aq më pak vetjake. Por kur jeta jonë buron nga brenda-jashtë, kur ne krijojmë lidhje me forcën e erotikës brenda vetes, dhe e lejojmë këtë forcë të ndikojë dhe të ndriçojë veprimet tona mbi botën rreth nesh, vetëm atëherë përgjegjësia për veten tonë, në kuptimin më të plotë të fjalës, është e mundur. Aty ku njohim ndjenjat tona më të thella, aty zë fill edhe pakënaqësia ndaj vuajtjes dhe vetëmohimit që na janë imponuar, dhe mpirjes që aq shpesh ngjan si e vetmja alternativë e shoqërisë sonë. Kur motivimi

dhe fuqia na vijnë nga brenda, veprimet tona kundër shtypjes sonë bëhen pjesë e pandashme e jona.

Kur unë krijoj lidhje me erotikën, e kam më të lehtë të refuzoj pafuqinë, apo gjendjet e tjera të imponuara shpirtërore, dorëzimin, dëshpërimin, vetëpërmbytjen, depresionin, vetëmohimin, të cilat nuk burojnë nga vetja ime.

Dhe po, ekziston një hierarki. Ka një ndryshim mes lyerjes së gardhit në oborr, dhe shkrimit të një poezie, por vetëm nga ana sasiore. Dhe, për mua, nuk ka ndonjë ndryshim nëse shkruaj një poezi të bukur ose nëse vallëzoj drejt rrezeve të diellit që përthyhen mbi trupin e gruas që dashuroj.

Këtu arrij te pika e fundit e diskutimit tim mbi erotikën. Të ndash me tjetrin fuqinë e ndjenjave, dallon nga përdorimi i ndjenjave të tjetrit si të ishin një shami hundësh. Kur ne nuk marrim parasysh përvojën tonë, dhe jo vetëm atë erotike, ne nuk bashkëndiejmë, por përfundojmë duke shfrytëzuar ndjenjat e atyre me të cilët e ndajmë këtë përvojë. Dhe shfrytëzimi pa miratim është abuzim.

Për të përfituar nga ndjenjat tona erotike, ne duhet t'i njohim ato. Nevoja për të ndarë me njëri-tjetrin ndjenjat tona më të thella, është krejt njerëzore. Mirëpo, brenda traditës euro-amerikane, kjo nevojë është plotësuar nga ato veprime që nuk na lejohen. Këto pothuajse gjithmonë karakterizohen nga një mospërballje kolektive, ato janë të shtiruara dhe mbajnë emrin e diçkasë që nuk janë, si religjion, krizë, dhunë bandash, apo duke luajtur doktorin. Akti i keqemërtimit të kësaj nevoje e ka shtrembëruar atë, dhe ka përfunduar si pornografi dhe si sjellje e pahijshme — pra në abuzim të ndjenjës.

Kur nuk e shohim rëndësinë e erotikës si diçka që rrit dhe ushqen fuqinë tonë, ose kur në momentet që përmbushim dëshirat tona erotike në harmoni me tjerët ne nuk shohim nga vetja jonë, atëherë ne i përdorim të tjerët si objekte kënaqësie, dhe jo si mundësi për të krijuar lidhje, bashkë me ngjashmëritë dhe dallimet

tona. Ndoshta është më e lehtë kështu, por nëse ne refuzojmë të jemi përherë të ndërgjegjshëm mbi ndjenjat tona, ne atëherë mohojmë një pjesë të madhe të përvojës tonë, dhe i lejojmë vetes të reduktohem në diçka pornografike, të abuzuar, absurde.

Erotika nuk mund të përjetohet nga larg. Si feministe lezbike e zezë, ndjenjat, njohuritë dhe mirëkuptimi që kam për motrat me të cilat kam vallëzuar çmendurisht, me të cilat kam lozur e kam luftuar, janë krejt të veçanta. Ne kemi arritur të veprojmë si kurrë më parë, vetëm kur i kemi përjetuar këto ndjenja të thella bashkë.

Por, gratë të cilat vazhdojnë të operojnë brenda një tradite ekskluzivisht mashkullore euro-amerikane, nuk e kanë të lehtë të përfshihen në këtë energji. E di se as unë nuk e kam pasur të lehtë, kur tentoja të përshtas vetëdijen time me këtë frymë jetese dhe ndjesie.

Tashmë çdo herë e më shumë shoh gra që identifikohen si gra, që kanë guximin e duhur për të marrë rrezikun që të ndajnë me të tjerët ngarkesën elektrike të erotikës, pa ju trembur syri, dhe pa e shtrembëruar natyrën kaq të fuqishme dhe kreative të këtij shkëmbimi. Duke njohur fuqinë erotike brenda jetës sonë, ne mund të gjejmë energjinë për të kërkuar ndryshimin e vërtetë të kësaj bote, dhe për t'i dhënë fund zëvendësimit të personazheve në këtë dramë të lodhshme dhe të përsëritshme.

Kështu jo vetëm që prekim burimin tonë më të thellë krijues, por bëjmë atë që është femërore dhe vetëafirmuese, përballë një shoqërie raciste, patriarkale dhe anti-erotike.

Letër e dorëzuar në Konferencën e Katërt të Berkshire mbi Historinë e Grave, Kolegji Mount Holyoke, 25 gusht 1978. Së pari u botua si një pamflet nga Out & Out Books.

Përktheu: Silvi Naçi

ZËRI PUBLIK I GRAVE

Mary Beard

2017

Gratë në perëndim kanë shumëçka për të kremtuar; le të mos e harrojmë. Nëna ime u lind përpara se gratë të kishin të drejtë vote në zgjedhjet parlamentare britanike. Ajo jetoi aq sa për të parë një kryeministre grua. Cilatdo të kenë qenë pikëpamjet e saj mbi Margaret Thatcher, ajo ishte e kënaqur që një grua kish arritur deri në banesën numër 10 dhe krenohej që vetë kish kontribuar në ndryshimet revolucionare të shekullit XX. Ndryshe nga breznia para saj, ajo mund të kishte karrierë, e në të njejtën kohë, edhe të martohej e të bëhej me fëmijë (përderisa për nënën e saj shtatzania ishte edhe fundi i pashmangshëm i punës së saj si mësuese). Ajo ishte drejtoreshë tejet e zonja në një shkollë të madhe fillore në Midlandin Perëndimor. Jam e bindur se ajo përfaqësonte vetë simbolin e fuqisë, për shumë gjenerata të djemve e vajzave të fillores atëbotë.

E megjithatë, nëna ime e dinte se nuk ishte aspak e thjeshtë, se barazia e vërtetë midis grave dhe burrave mbetej punë e së ardhmes, dhe se kishte arsye për revoltë, por edhe për kremtim. I mbeti përherë peng që nuk u regjistrua në universitet (ndaj përjetoi një gëzim krejt vetëmohues kur u regjistrova unë). Pezmatohej kur opinionet apo vullneti i saj nuk merreshin aq seriozisht sa do të kish dashur. Edhe pse do ta kish parë me dyshim metaforën e “tavanit të qelqtë”, ajo e dinte mirë se sa më shumë të ngjitej në karrierë aq më pak gra do të haste aty ku ngjitej.

E kam patur shpesh në mendje gjatë kohës që përgatisja dy leksionet tek të cilat bazohet ky libër, që pa dritën e botimit falë *London Review of Books*, në 2014 dhe 2017. Doja të gjeja fjalët e duhura për t'i shpjeguar asaj, vetes sime por edhe miliona grave që ndjejnë të njëjtin zemërim si ne, se sa thellë janë rrënjosur në kulturën perëndimore mjetet me të cilat heshten a shpërfillen gratë, ato mjete a mënyra që i përdorin edhe për t'i larguar ato nga rolet qeverisëse a detyrat e pushtetshme (do të ndalemi edhe këtu). Le

ta thërrasim pra lashtësinë e grekëve dhe romakëve që të na zditë kuptimet, pasi kur vjen puna për të heshtuar zërin e grave, kultura perëndimore ka mijëra vite përvojë.

Dua ta nis shumë pranë zanafillës së traditës letrare perëndimore, ta nis me rastin e parë të regjistruar të një burri që i kërkon një gruaje të heshtë, duke i thënë që zëri i saj nuk bën të ndjehet në publik. Mendja më shkon pikërisht tek një moment i përjetësuar në hyrjen e Odisesë së Homerit, rreth 3.000 vjet më parë. Ne e konsiderojmë librin e Odiseut si një vepër të rëndësishme epike, e cila rrëfen aventurat dhe vështirësitë e kthimit në shtëpi të Odiseut nga lufta e Trojës, teksa e shoqja, Penelopa e priste në shëpi, duke prapsur me durim mëtonjësit që e grishnin të rimartohej. Megjithatë Odiseja është po aq dhe historia e Telemakut, birit të Penelopës. Është historia e rritjes së dikujt, që gjatë poemës piqet e shndërrohet nga djalosh në burrë. Ky shndërrim gjendet qysh në këngën e parë të kësaj poeme, kur Penelopa zbret nga kthinat vetanake në hollin qendror të pallatit dhe gjen një bard që këndon për mëtonjësit e saj vështirësitë e kthimit të grekëve në shtëpi. Duke qënë se kjo këngë nuk i pëlqen, ajo i kërkon në sy të tjerëve të luajë dhe të këndojë diçka më të gëzueshme. Në këtë pikë ndërhyt Telemaku: “Ngjitu prap në dhomë, nënë” — i thotë — “dhe ktheju punëve të tua, vegjës e tezgjahut... fjala është punë burrash, i takon të gjithë burrave, e madje më takon mua mbi gjithkënd tjetër pasi unë kam pushtetin në këtë shtëpi.” Dhe kështu ajo largohet.

Ka diçka fort qesharake në skenën ku ky djalosh “qumështor” i tregon vendin Penelopës së mençur, grua tashmë në moshë të mesme. Por kjo skenë është një dëshmi e mirë se pikërisht aty ku nisin rrënjët e traditës letrare europiane, qëndron dhe shpërfillja dhe asgjësimi i zërit të grave në sferën publike. Për më shumë, siç na dëshmon dhe Homeri, një pjesë e mirë e ritit të kalimit nga djalosh në burrë, konsiston në kontrollin e fjalës publike

dhe heshtjen e individëve gra. Fjalët e përdorura ekzaktësisht nga Telemaku kanë rëndësi të veçantë. Kur ai thotë *fjala* është *punë burrash*, përdor termin *muthos* — veçse jo në kuptimin e “mitit” që ka marrë sot kjo fjalë. Në greqishten e Homerit, kjo fjalë shënjonte “të folurit publik, komunikimin autoritar”, jo bashkëbisedimin, muhabetin apo thashethemnajën në të cilën të gjithë — përfshirë edhe gratë e sidomos ato — kishin “leje” të përfshiheshin.

Ajo çka meriton interes është marrëdhënia mes këtij momenti klasik homerian dhe disa “taktikave” të sotme për asgjësimin e zërit publik të grave, në kulturën tonë dhe në politikat bashkëkohore, nisur nga pozita më e lartë, e deri në atë më të ultën. Është një “shurdhësi” e njohur kjo, që parodizohet bukur në vizatimin e vjetër komik *Punch*: “Ky është një sugjerim i shkëlqyer, znj. Tiggs. Mbase ndonjë nga burrat e pranishëm do të donte ta propozonte...” Dëshiroj të reflektoj sesi kjo “shurdhësi” lidhet me abuzimin që shumë gra ende sot e vuajnë kur vendosin të flasin, dhe ndër pikëpyetjet e mia të vazhdueshme është pikërisht lidhja që qëndron mes të folurit publikisht në mbështetje të një ikone femërore në një kartëmonedhë, një kërcënimi në Twitter që përfundon me përdhunime apo dekapitime, dhe heshtimit të Penelopës nga Telemaku.



‘That’s an excellent suggestion, Miss Triggs. Perhaps one of the men here would like to make it.’

Qëllimi im është të hedh dritë, shumë dritë, mbi marrëdhënien kulturalisht të sikletshme mes zërit të gruas në shoqëri dhe ligjërit, debatit dhe opinioneve në sferën publike: nga zyrat e komiteteve e deri në foltoren e Parlamentit. Kam shpresë se nga ky këndvështrim do të arrijmë të kapërcejmë diagnozën dembele të “misogjenisë”, ku gjithmonë kemi prirjen të përfundojmë. Le të kuptohemi, “misogjenia” është padyshim një ndër mënyrat e cilësimit të situatës (zor se ka fjalë më të përshtatshme nëse pas pjesëmarrjes në një emision televiziv të vijnë në Twitter një tufë mesazhesh që krahasojnë gjenitalet e tua me turlisoj zarzavatesh të kalburës). Por nëse duam të kuptojmë drejtë, dhe të veprojmë mbi faktin se gratë edhe kur nuk heshten, e paguajnë shtrenjtë fjalën e tyre publike, ne duhet të pranojmë se kjo na vjen nga një traditë e gjatë, andaj gjërat nuk janë kaq të thjeshta.

Shpërthimi i Telemakut shënjon thjesht rastin e parë të një tradite përpjekjesh të suksesshme gjatë antikitetit grek e romak, jo vetëm për ta përjashtuar gruan nga ligjërimi publik, por edhe për ta ekspozuar këtë përjashtim. Në shekullin IV para erës sonë, për shembull, Aristofani i kushton një komedi të tërë fantazisë “qesharake” që do të shpërthente nëse shteti drejtohej nga gratë. Pjesë e “humorit” ishte dhe paaftësia e grave për të ligjruar publikisht, madje posaçërisht paaftësia për të përshtatur komunikimin e tyre privat (kryesisht të përqëndruar tek seksi) me ligjërimin e lartë mashkullor. Në botën romake, *Metamorfozat* e Ovidit — epika e jashtëzakonshme mitologjike mbi njerëzit që ndërrojnë formë (mbase vepra me ndikimin më të madh në letërsinë perëndimore pas Biblës) — i rikthehet vazhdimisht idesë së heshtimit të grave gjatë proceseve të tyre të transformimit. E mjera lo shndërrohet në lopë nga perëndia Jupiter, në mënyrë që të mos flasë më por vetëm të pëllasë; ndërsa Echo, muza fjalëshumë, dënohet në mënyrë që zëri i saj të mos jetë më i veti, por thjesht një instrument përsëritës i zërit të të tjerëve. Në pikturën e njohur

të Waterhouse, ajo vështron ngultazi Narcisin e saj të dëshiruar në pamundësi për të nisur një bisedë me të, teksa ai — “narcizisti” i parë — ka rënë në dashuri me imazhin e tij të pasqyruar mbi ujë.

Një antolog i zellshëm romak i shekullit të parë pas erës sonë shkoi aq larg sa shpurriti “tri raste të grave, natyra e të cilave nuk ua lejon të heshtin në forume”. Përshkrimet e tij flasin shumë. E para, Maesia, mbrojti shumë mirë veten në gjyq dhe “meqë kishte natyrën e një burri pavarësisht pamjes së saj femërore” i vunë nofkën “androgjen”. E dyta, Afrania, bëhej vetë nismëtare e çështjeve ligjore dhe ishte kaq “e pacipë” sa të apelonte po vetë, kështuqë njerëzit u lodhën nga “lehjet” e saj (sërish nuk i lejohet “ligjërimi” njerëzor). Na thuhet se ajo vdiq në vitin 48 para erës sonë, pasi që “për krijesa anormale si puna e saj, ka më rëndësi të shënohet data e vdekjes, se ajo e lindjes”.

Në historinë e botës klasike, ka vetëm dy përjashtime ku zëri publik i grave nuk ngjallte neveri. I pari është rasti kur grave, para vdekjes, u lejohet të shprehen si viktima apo martire. Gjatë krishtëritimit të hershëm, gratë portretizoheshin duke deklamuar me fuqi besimin e tyre teksa shkonin drejt luanëve; në një histori të njohur të fillimeve të Romës së lashtë, të virtytshmes Lukrecia, përdhunuar nga një princ i monarkisë sunduese, iu dha fjala e lirë aq sa për të denoncuar përdhunuesin, dhe për të lajmëruar së fundmi vetëvrasjen e saj (të paktën kështu na është paraqitur nga shkrimtarët romakë, pasi nuk e dimë çfarë ka ndodhur vërtetë). Por edhe kjo mundësi e brishtë për t’u shprehur mund të mohohej nga momenti në moment. Një ndër tregimet e *Metamorfozave*, rrëfen përdhunimin e princeshës rioshe, Filomenë, së cilës përdhunuesi i pret gjuhën, për të parandaluar çdo denoncim të stilit Lukrecia. Ky nocion rimerret dhe nga Shakespeare-i në *Titus Andronicus*, ku gjithashtu Laviniës së dhunuar i shkulet gjuha.

Përjashtimi i dytë është më i njohur. Në të rrallë, grave mund t’u lejohej të ngrinin zërin — për të mbrojtur shtëpitë e tyre, fëmijët, burrat, apo dhe interesat e grave të tjera. Në shembullin e

tretë të oratorisë femërore, sjellë nga antologu romak, Hortensia, ia hedh paq ngase duke folur për taksën që do t'u vihej pasurive të tyre për të financuar një luftë të dyshimtë, ajo në fakt po vepron në emër të grave (dhe vetëm të grave) romake, si zëdhënëse e tyre. Me fjalë të tjera, në rrethana specifike, gratë mund të mbrojnë publikisht vetëm interesat e tyre të ngushta e të pjeshme, por jo të flasin për burrat, apo për bashkësinë në tërësi. Me pak fjalë, siç thoshte një guru i shekullit të dytë pas erës sonë, “një grua duhet të ruhet nga shfaqja e zërit të saj ndaj të huajve, njësoj siç do t'i ruhej zhveshjes në sy të tyre”.

Sidoqoftë, çështja është më e thellë se kaq. Kjo memecëri nuk është veç një refleksi i pafuqisë së përgjithshme të grave gjatë gjithë klasicitetit, në të cilin del se janë pa të drejtë vote, ligjërisht dhe ekonomikisht të kufizuara e kështu me rradhë. Pjesërisht është e vërtetë. Nuk kish të ngjarë që gratë e lashta të shpreheshin në sferën politike, në të cilën as që kishin zë në kapitull. Vetëm se këtu kemi të bëjmë me një përjashtim tejet më të vrullshëm dhe aktiv të grave nga fjala publike, përjashtim shumë më të egër seç jemi mësuar të paraqesim në traditat, konventat dhe diskutimet tona mbi zërin e grave.

Ajo çka dua të them është se të folurit publik dhe oratoria nuk ishin thjesht të palejueshme për gratë e lashta: ato ishin praktika dhe cilësi ekskluzive që përcaktonin gjininë mashkullore. Siç e pamë me Telemakun, të burrërohesh (ose të paktën të bëhesh burrë elitari) donte të thoshte të kesh të drejtën për të folur. Fjalimi publik ishte një tipar përcaktues i burrërisë, për të mos thënë i vetmi. Apo, sipas një slogani të mirëditur romak, *qytetari elitari mashkull* mund të përkufizohet si *virusi dicendi peritus*, “njeri i mirë, i zoti të ligjërojë”. Ndërkohë një grua që fliste në publik, në shumicën e rrethanave, nuk mund të përkufizohej si grua.

Përktheu: Anna Shkreli

MANIFESTI SKAM¹

Valerie Solanas

1967

Në këtë shoqëri ku jeta, në rastin më të mirë, është fort e mërzitshme, dhe ku asgjë nuk është në të mirë të grave, u ngelet femrave të emancipuara, të përgjegjshme dhe kërkuese, të hedhin poshtë qeverinë, të eliminojnë sistemin e parave, të vendosin automatizim të plotë dhe të shkatërrojnë seksin mashkullor.

Sot është teknikisht e mundur të riprodhosh pa ndihmën e meshkujve (ose, në fakt, edhe të femrave) dhe të riprodhosh vetëm femra. Kjo punë duhet filluar qysh sot. Meshkujt nuk përmbushin më as rolin e tyre të diskutueshëm të riprodhimit. Mashkulli është aksident biologjik: gjeni (mashkullor) Y është një gjen i pakompletuar (femëror) X, pra, atij i mungon një varg kromozomesh. Me fjalë të tjera, mashkulli është një femër e pakompletuar, një abort me këmbë, i abortuar që në ngjizje. Të jesh mashkull do të thotë të jesh i gjymtuar, emocionalisht i kufizuar; burrëria është një mangësi mendore dhe meshkujt janë sakatë emocionale.

Mashkulli është komplet egocentrik, i ndrydhur brenda vetes, i paaftë për empati apo identifikim me të tjerët, për dashuri, miqësi, dhembshuri a butësi. Ai është një njësi tërësisht e izoluar, i paaftë të bashkëndjejë me dikë tjetër. Reagimet e tij vijnë nga barku, jo nga truri; inteligjenca e tij është mjet në shërbim të instinkteve dhe nevojave të tij; ai nuk është i aftë për pasion mendor, bashkëveprim mendor; atij nuk i intereson asgjë tjetër pos ndjesive të tija fizike.

1. SCUM /skam/: fundërrina, llumi i diçkaje; njeri i poshtër; zgaq; qelbanik. SCUM është përkthyer në disa gjuhë si shkurtesë e "Society for Cutting Up Men" (Shoqëria për asgjësimin e burrave), mirëpo vet Solanas e ka mohuar që SCUM ka këtë kuptim. Për Solanas, SCUM do të thotë qenia më e ulët, që vjen nga llumi, nga fundërrina dhe ka fuqinë të prodhojë dije. Solanas në një rast ka folur edhe për fundërrinat e dalura nga shtrati i krijuar nga çdo gjë që është objektifikuar dhe hedhur si e pavlerë. Në këtë përkthim, SCUM është shqipëruar si SKAM, që përçon edhe kuptimin e skamit/skamjes, pra gjendjes sociale ku mungojnë gjërat thelbësore për jetesë, dhe nga ku buron revolta. (shën. i përkth.)

Ai është një gjysëmkufoëmë, një masë apatike, i paaftë për të dhënë apo për të marrë kënaqësi e lumturi; pra, ai është, në rastin më të mirë, tmerrësisht i mërzitshëm, një filluskë e topitur, sepse sharmantë janë vetëm ata që bashkëndejnë. I ngecur në një zonë të errët, diku mes njeriut dhe majmunit, ai është shumë më keq se majmunët, sepse, ndryshe nga majmunët, ai arrin të përjetojë edhe një mori ndjenjash negative — urrejtje, xhelozë, përbuzje, neveri, faj, turp, dyshim — dhe për më tepër, ai është edhe i vetëdijshëm për atë çfarë ai është dhe nuk është.

Edhe pse qenie krejtësisht fizike, mashkulli nuk e përmbush as rolin e tij prej hamshori. Edhe nëse supozojmë se ai ka aftësi të shkëlqyeshme mekanike, që shumë pak burra i kanë, ai është, pikë së pari, i paaftë për ta shqyer dikë vullshëm e plot eps, dhe prandaj përfundon i dërrmuar nga faji, turpi, frika dhe pasiguria, ndjenja këto që kanë zënë rrënjë thellë në natyrën e tij, ndjenja këto që vetëm një riedukimi i përndritur mund t'i zbusë; së dyti, ndjenjat fizike që ai përjeton janë pothuajse zero; dhe e treta, ai nuk ndjen empati për partnerin e tij, por fiksohet me performancën vetjake, ku ai duhet të shkëlqejë, si një hidraulik kur shpon një tubacion. Është kompliment ta quash një burrë kafshë; ai nuk është asgjë pos një makineri; një dildo me këmbë. Shpesh dëgjojmë se burrat i përdorin gratë, por për çfarë përdorin? Jo për kënaqësi, e sigurtë.

I gërryer nga faji, turpi, frikat dhe pasiguritë, dhe nga dëshira, po qe me fat, të ndjejë diçka sadopak fizike, mashkulli, gjithsesi, e ka mendjen te pallimi; ai do të notonte nëpër një lum qyrrash, dhe do të zhytej e çante nëpër një kilometër të vjellash, po ta dinte se në anën tjetër po e pret një pidh krahëhapur. Ai mund të pallojë edhe një grua që ai përçmon, e edhe një grua leckamane, pa dhëmbë, dhe për më tepër, edhe do ta paguante. Pse? Jo për të çliruar tension, se ndryshe do t'i mjaftonte masturbimi. As për ta kënaqur egon e tij; po të ishte kështu, nuk do pallonte kufoma dhe bebe.

Krejtësisht egocentrik dhe i paaftë të bashkëndejë, të identifikohet me tjetrin a të ndjejë empati, i stërbushur me një seksualitet të thellë, therës dhe gjithëkaplues, mashkulli ngelet mendërisht pasiv. Ai e urren pasivitetin aq shumë sa e projekton atë tek gratë dhe, duke quajtur veten aktiv, ai i rreket mundimit për ta vërtetuar këtë gjë (“ta tregojë që është Burrë”). Pallimi i shërben si mjet vërtetimi (një Burrë me një Kar të Madh që shkëlyen një Copë të Madhe). Duke qenë se ai po përpiket të vërtetojë një të pavërtetë, ai detyrohet ta përsëris rregullisht. Pallimi, në këtë rast, është një tentativë e dëshpëruar kompulsive, një provë se ai nuk është pasiv, nuk është grua; por, ai është pasiv, dhe ai dëshiron të jetë grua.

Mashkulli është një femër e pakompletuar, dhe si i tillë ai e kalon jetën duke tentuar të plotësojë vetveten, të bëhet femër. Ai provon ta bëjë këtë vazhdimisht, dhe kërkon të afrohet, të jetojë dhe të frymojë pranë një gruaje, dhe t’i përvetësojë të gjitha tiparet femërore si të tija — forcën emocionale, pavarësinë, fuqinë, dinamizmin, vendosmërinë, qetësinë, objektivitetin, këmbëngulësinë, guximin, integritetin, vitalitetin, intensitetin dhe thellësinë e karakterit, dëshirën për jetë, etj. — ndërkohë që projekton tek gratë të gjitha tiparet mashkullore — kotësinë, mendjelehtësinë, vogëlsinë, dobësinë, etj. Duhet thënë se, megjithatë, mashkulli është më i aftë vetëm në një fushë veprimi: në atë të marrëdhënieve me publikun (mrekullisht ai ka arritur t’i bind miliona gra se burrat janë gra dhe se gratë janë burra). Pretendimi mashkullit se femra përmbushet vetëm përmes seksit dhe kur bëhet nënë, pasqyron atë çfarë meshkujt do të donin për veten e tyre, po të ishin femra.

Gratë, me fjalë tjera, nuk ndiejnë zili për penisin; burrat ndiejnë zili për vaginën. Kur një mashkull pranon pasivitetin e tij, ai e sheh veten si një grua (meshkujt, njëlloj si femrat, mendojnë se burrat janë gra dhe gratë janë burra), dhe shndërrohet në një trans që nuk ka dëshirë të pallojë (nuk bën më asgjë; si hyjneshë

drag ndihet i përmbushur) dhe tredh karin e tij. Më pas, ai arrin të transmetojë një emocion të vazhdueshëm seksual nga “të qenurit grua”. Pallimi, për një burrë, është mekanizmi që e mbron atë nga dëshira për të qenë grua. Burri ka shkaktuar:

Luftërat

Për të kompensuar faktin që nuk është femër, mashkulli reagon në mënyrën më të gabuar duke shkrepur Armën e Tij, armë kjo me një numër të limituar plumbash; prandaj ai gjuan breshërima, që të dëshmojë para botës se ai është “Burrë”. Ai nuk ka ndjeshmëri apo empati dhe nuk identifikohet me dhimbjen e të tjerëve, prandaj burrërinë e dëshmon duke shkaktuar gjymtime, vuajtje dhe humbje pafund jetësh, përfshirë edhe të tijën. Jeta e tij është e pavlerë: ai më parë pranon të digjet lavdishëm, sesa të zvarritet i ngrysur për pesëdhjetë vite të tjera.

Mirësia, mirësjellja dhe “dinjiteti”

Çdo burrë, brenda vetes, e di se është një copë muti i pavlerë. I përfshirë nga një ndjenjë shtazërie dhe thellësisht i turpëruar nga kjo; i mbushur me dëshirën jo për tu shprehur, por për të fshehur me çdo kusht fizikalitetin dhe egocentrizim e tij absolut, urrejtjen dhe përçmimin që ndjen për burrat e tjerë, dhe për të fshehur nga vetja e tij urrejtjen dhe përçmimin që dyshon se burrat e tjerë e kanë për të; me një sistem nervor të ndërtuar pandjeshmërisht dhe që preket lehtë nga çfarëdolloj shpërfaqje emocionesh a ndjenjash, mashkulli tenton të instalojë një kod “social” që garanton mirësjellje të përkryer, të pacënuar nga ndonjë gjurmë ndjenje apo mendimi shqetësues. Ai përdorë terma si “çiftëzim”, “kongres *seksual*”, “të kesh marrëdhënie” (për burrat raporti seksual është i tepërt), stolitur me manerizma të ngurta; pra, një shimpanze me kostum.

Paraja, martesë dhe prostitucioni; puna dhe parandalimi i automatizimit të shoqërisë

Nevoja për të fituar para nuk është aspak njerëzore dhe nuk ka asnjë arsye pse dikush duhet të punojë më shumë se tre deri në katër orë në javë, maksimum. Të gjitha punët jokreative (praktikisht të gjitha punët që ekzistojnë sot) mund të ishin automatizuar prej kohësh, dhe në një shoqëri pa para, të gjithë do të mund të kishin sa dhe çfarë t'u donte zemra. Por, ekzistojnë arsye jonjerëzore, arsye mashkullore, që kërkojnë të ruajnë sistemin monetar, që janë:

1. Pidhi. I neveritur nga vetja e tij e pamjaftueshme, i përfshirë nga një ndjenjë e fortë ankthi, nga vetmia e thellë që ndjen në shoqërinë e boshllëkut të vet, ai kërkon dëshpërimisht të lidhet me një grua me shpresën e vakët se ajo do ta plotësojë; nisur nga bestytia mistike se nëse prekesh nga ari, shndërrohesh në ar, mashkulli dëshiron të jetë përherë në shoqërinë e një gruaje. Edhe prania e gruas më të pavlerë është më e mirë sesa vetmia apo jeta mes meshkujsh të tjerë, që i përkujtojnë sa i neveritshëm është. Ndërkohë femrat, përveç kur janë shumë të reja ose shumë të sëmura, duhet t'i detyrosh apo t'i paguash për t'u lidhur me një mashkull.

2. Jepini një mashkulli vetmitar iluzionin se është i dobishëm dhe mundësinë të justifikojë ekzistencën e tij duke hapë e mbyllë gropa. Mashkullin e tmerron koha e lirë, ku përfundon duke menduar mbi natyrën e tij groteske. I paaftë të ndiejë empati dhe dashuri, mashkullit i duhet të punojë. Gratë kanë etje për aktivitete që të bëjnë për vete, që të japin kënaqësi, që kanë kuptim, por kur nuk e kanë këtë mundësi apo aftësi, ato zgjedhin të rrinë kot dhe të bëjnë çfarë ju pëlqen — flejnë, bëjnë pazare, luajnë *bowling*, bilardo, me letra e lojëra të tjera, lindin fëmijë, lexojnë, ecin, ëndërrojnë, hanë, vetëpërkëdhelen, gëlltisnin pilula, shkojnë në kinema, analizojnë

veten, udhëtojnë, rrisin qen e mace, shëllehen në diell, në plazh, notojnë, shohin televizor, dëgjojnë muzikë, rregullojnë shtëpinë, kopshtin, qëndisin, shkojnë nëpër klube, vallëzojnë, vizatojnë, “pasurojnë mendjen” (bëjnë kurse) dhe përthithin “kulturë” (me ligjërata, shfaqje, koncerte, filma “artistik”). Prandaj, shumë femra preferojnë, edhe po të kishim barazi të plotë ekonomike mes gjinive, ose të jetojnë me meshkuj ose të shesin trupin e tyre në rrugë, që të kenë sa më shumë kohë të lirë për veten e tyre, dhe jo duke punuar për dikë tjetër, dhe duke kaluar orë të tëra në një punë të mërzitshme, topitëse e jokreative, më keq se një kafshë, si një makinë, ose, në rastin më të mirë — kur ke “një punë të mirë” — duke bashkëmenaxhuar bërllokun. Përfundimisht, gratë do të çlirohen nga kontrolli i meshkujve kur t’i japin fund sistemit punë-para, dhe jo kur të arrijnë barazi ekonomike me burrat brenda këtij sistemi.

3. Pushteti dhe kontrolli. I pazoti në marrëdhëniet e tij personale me gratë, mashkulli arrin zotësi vetëm duke manipuluar me para dhe me çdo gjë tjetër që kontrollohet nga paratë, me fjalë të tjera, çdo gjë dhe çdo njeri.

4. Zëvendësimi i dashurisë. I paaftë të dashurojë dhe të përkëdhelë, mashkulli jep para. Kështu ndihet si nënë. Nëna jep qumësht; ai jep bukë. Është ai që siguron bukën në shtëpi.

5. Jepi mashkullit një qëllim. I paaftë të shijojë momentin, mashkulli ka nevojë të ketë një plan për të ardhmen dhe para që i japin mundësinë të ketë vazhdimisht, përjetësisht, një qëllim: Mendo se çfarë mund të bësh me 80 trilionë dollarë — investoji! Pas tre vitesh mund të kesh 300 trilionë dollarë!!!

6. Jepi mashkullit shtyllën e tij kryesore për të ushtruar kontroll dhe manipulim: atësinë.

Atësia dhe sëmundjet mendore (frika, droja, përulësia, pasiguria, pasiviteti)

Nëna dëshiron më të mirën për fëmijët e saj. Babi dëshiron më të mirën për Babin, pra paqe dhe qetësi, teksa miklon iluzionin e dinjitetit të tij (respektit), që të duket mirë para botës (statusit) dhe mundësinë të kontrollojë dhe manipulojë. Nëse është baba “i ngritur”, atëherë ai “jep këshilla”. Të bijën, përveç tjerash, e dëshiron seksualisht — ai e jep *dorën* e saj për martesë; të tjerat i do për vete. Babi, ndryshe nga Mami, nuk jepet pas fëmijëve të tij, sepse ai duhet, me çdo kusht, të ruajë imazhin e shtirur të dikujt që ka vendosmëri, forcë, pushtet dhe gjithmonë të drejtë. Kur dikush nuk bën atë çfarë ai do, kjo e bën atë të humbasë vetëbesimin dhe aftësinë për t’u përballur me botën, dhe e bën që të pranojë status quo-në në mënyrë pasive. Mami i do fëmijët e saj, dhe pavarësisht se ndonjëherë e kap zemërimi, ajo megjithatë arrin të japi dashuri dhe t’i pranojë fëmijët e saj. Babi i sëmurë emocionalisht nuk i do fëmijët e tij; ai i miraton ata — ata janë “të mirë” nëse sillen mirë, pra, nëse e respektojnë, i binden dhe i shërbejnë vullnetit të tij, nëse janë fjalëpak dhe nuk shfaqin shenja temperamenti që mund të acarojnë sistemin mashkullor nervor të Babit; pra, me pak fjalë, nëse ata janë bimë që vegjetojnë. Nëse ata nuk janë “të mirë”, Babi nuk zemërohet — sidomos kur është baba modern, pra “i civilizuar” (më mirë kur baballarët ishin të pamëshirshëm e bërtisnin si dikur, ashtu së paku dukeshin qesharak dhe përçmoheshin më lehtë) — por ai shpreh mosmiratimin e tij, situatë kjo, që ndryshe nga zemërimi, reziston dhe refuzon të pranojë tjetrin, duke e lënë fëmijën e tij me një ndjenjë të thellë pavlefshmërie dhe me nevojën e përvetshme për të marrë miratim nga të tjerët; dhe, rrjedhimisht, edhe me frikën për të pasur mendim të pavarur, mendim i cili do ta çonte drejt një jetese jokonvencionale, një jetese dhe mendësie që nuk aprovohen.

Që fëmija të dojë miratimin e Babit, ai duhet të respektojë Babin, por Babi, si një plehrë që është, e di se respekti fitohet vetëm

duke mbajtur distancë, duke qenë i rezervuar, nisur nga parimi se “afërsia krijon mosrespekt”, parim ky që edhe mund të vlejë kur dikush me të vërtetë nuk meriton respekt. Duke qenë i ftohtë dhe i largët, ai arrin të mbetet i panjohur, misterioz, dhe, kështu, të ngjalli frikë (“respekt”).

Mosmiratimi i “skenave” emocionale krijon frikë nga emocionet e forta, frikë nga zemërimi dhe urrejtja jote. Kur vuan nga mungesa e vetëbesimit për t’u përballur me botën dhe për ta ndryshuar atë, apo të luash sadopak rol në fatin tënd, kjo të bën të besosh naivisht se shumica e njerëzve në botë janë të mirë, dhe se aktivitetet më banale, më mondane, janë thellësisht argëtuese dhe të këndshme.

Ndikimi i atësisë, në veçanti tek meshkujt, është që t’i bëjë ata “Burra”, pra, t’i mbrojë ata nga çdo impuls pasiviteti, pederastie, apo dëshire për të qenë femër. Çdo djalë dëshiron të imitojë nënën e tij, të bëhet si ajo, të shkrihet në të, por Babi nuk e lejon këtë gjë: *ai* është nëna; vetëm *atij* i lejohet të shkrihet me të. Prandaj ai i thotë djalit, ndonjëherë prerazi e ndonjëherë indirekt, të bëhet Burrë, e jo qullac. Djali, i tmerruar nga frika dhe nga “respekti” për të atin, bindet dhe bëhet si Babi, model i përkryer i Burrërisë, ideali Amerikan: një heteroseksual i sjellshëm e i bajatshëm.

Ndikimi i atësisë tek femrat është t’i bëjë ato meshkuj — të varura, pasive, shtëpiake, shtazarake, të pasigurta, në kërkim të miratimit dhe sigurisë, frikacake, të përlulura, që respektojnë burrat dhe autoritetet, të mbyllura, të vakëta në përgjigje, gjysëmkuforma, banale, bajate, konvencionale, të ngathta dhe që meritojnë përbuzje. Vajza e Babit, gjithmonë e tendosur dhe me frikë, jo interesante, pa thellësi mendimi, joobjektive, e çmon Babin, dhe si pasojë, krejt burrat e tjerë, duke u nisur nga frika (“respekti”). Kështu, ajo jo vetëm që nuk arrin ta shohë boshllëkun që fshihet pas fasadës së tij, por edhe e pranon si të mirëqenë vetëpërkufizimin e mashkullit si qenie superiore, dhe për femrën,

dhe veten e saj, si qenie inferiore, pra qenie mashkull, që ka ardhur në jetë falë Babit të saj.

Është pikërisht forcimi i atësisë, që ka ardhur si pasojë e rritjes dhe përhapjes së pasurisë, pa të cilën atësia nuk lulëzon, që ka çuar deri në përhapjen e budallakisë dhe dobësimin e pozitës së gruas në SHBA gjatë viteve 1920-të. Kjo marrëdhënie e ngushtë mes pasurisë dhe atësisë ka çuar, përgjithësisht, deri në atë pikë sa “të arsimohen” vetëm vajzat e gabuara, pra, ato që vinë nga klasët e mesme “të privilegjuara”.

Ndikimi i baballarëve, me pak fjalë, është kalbja e botës me burrëri. Prekja e tij është e kundërta e Midas — çdo gjë që ai prek bëhet mut.

Ndrydhja e individualitetit, shtazëria (jeta shtëpiake dhe amësia) dhe funksionalizmi

Mashkulli është veç një grumbull refleksesh të kushtëzuara, i paaftë për të pasur një reagim mendërisht të lirë; ai ka ngecur në kushtëzimet e tija fillestare, të përcaktuara krejtësisht nga përvojat e kaluara të tij. Përvojat e tij të para lidhen më nënën e tij, dhe gjatë gjithë jetës ai mbetet i lidhur me të. Ai asnjëherë nuk do ta kuptojë plotësisht, se ai nuk është pjesë e pandashme e nënës së tij, se ai është ai, dhe ajo është ajo.

Nevoja e tij më e zjarrtë është të udhëhiqet, mbrohet, përqafohet dhe adhurohet nga Mami (burrat presin që gratë t'i mbrojnë ata nga llahtari më i madh — vetja e tyre) dhe, duke qenë krejtësisht fizik, ai dëshiron ta kalojë kohën e tij (atë kohë që “nuk e kalon nëpër botë” për t'u mbrojtur nga pasiviteti i tij) duke u zhytur në veprimet e tij më bazike, duke ngrënë, fjetur, dhjerë, pushuar dhe duke u ledhatuar nga Mami. Pasive, Vajza kokë-gjarpërushe e Babit, përherë në kërkim të miratimit, të një ledhatimi të kokës, për pak “respekt” nga çdo lloj plehre që i kalon pranë, reduktohet shumë lehtë në një Mami, në një administratore të përkushtuar

ndaj nevojave të tij fizike, përkëdhelëse e vetullës së tij të ngrysur prej majmuni, ledhatuese e egos së tij të vocërr, vlerësuese e të papranueshmes, pra reduktohet në një termus me cica.

Reduktimi në kafshë i grave të shtresës më të prabambetur të shoqërisë ku Babi është mbreti suprem — pra, i klasës së mesme të “privilegjuar dhe arsimuar”, zbatues së njerëzimit — ka qenë aq i thellë, sa ato kanë përfunduar duke shijuar dhimbjet e lindjes, dhe, sot e kësaj dite, në vendin më të avancuar në botë, në mes të shekullit të njëzet, ato enden lart e poshtë me bebe që mbllaçiten pas cicave të tyre. Kur “ekspertët” u thonë grave që Mami duhet të qëndrojë në shtëpi dhe të zvarritet si shtazë, nuk është se e thonë për të mirën e fëmijëve, por për të mirën e Babit; cicat janë që t’i thithi Babi; dhimbjet e lindjes janë që Babi triumfalisht t’i shijojë (gjysëm i vdekur, ai kërkon stimuj të fuqishëm për t’ia ngacmuar shqisat).

Reduktimi i femrës në shtazë, në Nënë, në mashkull, është e domosdoshme për arsye psikologjike dhe praktike: mashkulli është anëtar i thjeshtë i llojit, lehtësisht i zëvendësueshëm me një mashkull tjetër. Ai nuk shquhet për individualizëm të fortë, që buron nga interesa të jashtëm që të ngacmojnë, të intrigojnë, të bëjnë të krijosh marrëdhënie. Krejtësisht të vetëpërfshirë, në marrëdhënie vetëm me trupat e tyre dhe ndjesitë e tyre fizike, meshkujt dallojnë nga njëri-tjetrit vetëm përsa i përket formës që zgjedhin për t’u mbrojtur nga pasiviteti dhe nga dëshira për të qenë femër.

Individualiteti i femrës, për të cilën ai është pafundësisht i vetëdijshëm, por të cilën ai nuk e kupton dhe nuk është në gjendje ta internalizojë apo ta kuptojë emocionalisht, i shkakton atij frikë, mërzi dhe verbim nga zilia. Prandaj ai mohon individualizmin e saj, dhe ka krijuar sisteme vlerësimi bazuar vetëm mbi funksionet apo dobitë e saj, duke ia dhënë vetes, sigurisht, funksionet më të rëndësishme — mjek, president, shkencëtar — dhe, rrjedhimisht, duke i dhënë vetes një lloj identiteti, nëse jo individualitet, ndërkohë

që bind veten dhe gratë (këtë e ka bërë me sukses) se funksioni i femrës është të lindi dhe rrisë fëmijë dhe ta qetësojë, ledhatojë dhe forcojë egon e tij; funksioni i saj është reduktuar aq shumë, sa e bën atë lehtësisht të zëvendësueshme me një femër tjetër. E vërteta është se funksioni i gruas është të bashkëndejë, të gëzojë, të dashurojë dhe të jetë vetja e saj e pazëvendësueshme; funksioni i mashkullit është të prodhojë spermë. Ne sot kemi banka spermash.

Në fakt, funksioni i femrës është të eksplorojë, të zbulojë, të shpikë, të zgjidhi probleme, të bëjë humor, të krijojë muzikë — të gjitha me dashuri. Me pak fjalë, të krijojë një botë magjike.

Cenimi i privatësisë

Mashkulli, i turpëruar nga vetja e tij dhe nga çdo veprim i mundshëm që bën, insiston për privatësi dhe fshehtësi në të gjitha fushat e jetës së tij, por nuk ka respekt për privatësinë. Si njeri bosh, i pakompletuar, vetmitar, që nuk di të kënaqet me veten dhe që vuan nga nevoja e përhershme për të qenë i shoqëruar nga një femër, nuk sheh asgjë të keqe kur ia pret rrugën një gruaje, edhe krejt të panjohur, në çfarëdo kohe, përkundrazi, ndihet i zemëruar dhe i ofenduar kur e qortojnë për këtë gjë, por dhe i hutuar — atij nuk i hyn në kokë se dikujt i pëlqen vetmia shumë më shumë se shoqëria me çdo zuzar që i afrohet. Nga dëshira për t'u bërë grua, ai mundohet të jetë gjithmonë në shoqërinë e femrave, si mënyra më e përafërt për t'u ndjerë grua, dhe për këtë arsye ai ka krijuar një "shoqëri" të organizuar rreth familjes — një çift mashkull-femër dhe fëmijët e tyre (arsyetimi për ekzistencën e familjes), të cilët praktikisht ia zënë frymën njëri-tjetrit, dhe dhunojnë pamëshirshëm të drejtat, privatësinë dhe shëndetin e gruas.

Izolimi, lagjet periferike dhe pengimi i komunitetit

Shoqëria jonë nuk është shoqëri komuniteti, por një varg njësishe të izoluar familjesh. Dëshpërimisht i pasigurtë, i frikësuar se gruaja

do ta braktisë nëse takon një burrë tjetër, ose diçka që i përngjason jetës së vërtetë, mashkulli përpiqet ta izolojë atë nga bota dhe nga ai pak civilizim rreth saj, duke u zhvendosur në një lagje periferike, ku jetojnë çifte të vetëkënaqura, bashkë me fëmijët e tyre. Izolimi i lejon burrit të vazhdojë të sillet sikur është një “individ i lirë”, një vetmitar, për të cilin mosbashkëpunimi dhe vetmia janë të barabarta me individualitetin.

Ka edhe një arsye tjetër pse mashkulli kërkon të izolohet: çdo burrë është një ishull. I ndrydhur brenda vetes, emocionalisht i bllokuar, i paaftë për të bashkëndjerë, mashkulli e ka makth civilizimin, njerëzimin, qytetet dhe çdo lloj situatë ku kërkohet aftësia për të kuptuar dhe jetuar me të tjerët. Kështu, si një lepur tutcan, ai largohet me vrap, bashkë me vrimën e bythës së tij prej Babi, drejt vendeve të pabanuara, mes natyrës, në lagjet më periferike, ose në rastin e hipikut — ky ka shku’ shumë larg! — larg ndër lëndina lopësh, ku ai mund të pallohet dhe shumohet pafundësisht, duke futur rruza në pe dhe duke i rënë fyllit.

Ky hipik, dëshira e të cilit për t’u bërë “Burrë” dhe “individualist i vrazhdë” nuk është aq e fortë sa e një burri mesatar, dhe të cilin, përveç tjerash, e eksiton mendimi i të pasurit shumë gra rreth tij, rebelohet ndaj jetës së vështirë të kryefamiljarit dhe montonisë së një gruaje. Në emër të bashkëjetesës, ai ndërton një bashkësi apo një fis, i cili, pavarësisht bashkësisë dhe pjesërisht për shkak të saj (bashkësia, si zgjatim i familjes së gjerë, është një zgjatim i shkëljes së të drejtave, privatësisë dhe shëndetit të gruas) nuk është komunitet sa është kopje e një “shoqërie” normale.

Një komunitet i vërtetë përbëhet nga individë — dhe jo vetëm nga anëtarë të species sonë dhe nga çiftet — që respektojnë individualitetin dhe privatësinë e njëri-tjetrit, dhe njëkohësisht bashkëveprojnë mendërisht dhe emocionalisht — shpirtira të lirë në marrëdhënie të lirë me njëri-tjetrin — që bashkëpunojnë për të arritur qëllime të përbashkëta. Tradicionalistët thonë se njësia bazë

e “shoqërisë” është familja, hipikët thonë se është fisi; askush nuk e thotë se është individi.

Edhe “hipiku” që llogotit mbi individualitetin, si gjithë burrat, nuk e kupton thelbin e këtij nocioni. Dëshira për t’iu kthyer Natyrës, egërsisë, habitatit të kafshëve me lesh si puna e tij, larg qytetit, atje ku nuk ka gjurmë qytetërimi, ku mund të jetojë si kafshët e tjera, duke kaluar ditën me aktivitete të thjeshta, jo-intelektuale — bujqësi, pallim, rruza në pe. Aktiviteti kryesor i këtij lloj komuniteti, thelbi i tij, është pallimi në grup. Hipiku joshet nga bashkësia pikërisht nga perspektiva e pidhit pa pagesë — e mira kryesore materiale që do të duhej ta ndante me të tjerët, por, i verbëruar nga lakmia, ai nuk e ndan, dhe si posesiv dhe xheloz që është, i do ato vetëm për vete.

Burrat nuk mund të bashkëpunojnë për një qëllim të përbashkët, sepse qëllimi i çdo burri është t’i mbajë pidhat për vete. Për këtë arsye, jeta në bashkësi është e destinuar të dështojë; nga paniku, çdo hipik do ta grabisë mendjelehtën e parë që i del para, dhe ta çojë, me vrap, diku larg në periferi. Mashkulli nuk mund të arrijë progres social, për shkak të luhatjes së tij konstante nga izolimi te pallimi në grup.

Konformizmi

Pavarësisht se ai do të jetë një individ, mashkullin e frikëson çdo tipar i tij që e dallon nga meshkujt e tjerë, dhe fillon vuan nga dyshimi se ai ndoshta nuk është mjaft “Burrë”, se ai është pasiv dhe totalisht seksual, një dyshim tepër i dhimbshëm. Nëse burrat e tjerë janë “alfa” dhe ai nuk është, atëherë ai nuk ndjehet burrë, por peder. Prandaj ai provon ta afirmojë “Burrërinë” e tij duke u bërë si gjithë burrat e tjerë. Ai ndjehet i kërcënuar nga dallimet mes burrave dhe vetes së tij; nëse janë ndryshe, janë homoseksuale që duhen shmangur me çdo kusht, prandaj sigurohet që të gjithë burrat rreth tij të jenë konformistë.

Mashkulli guxon të jetë ndryshe vetëm kur pranon pasivitetin

e tij, dëshirën për të qenë femër, pederastinë, etj. Mashkulli që është përafuar më së shumti është një hyjneshë drag. Megjithatë, edhe pse ndryshe nga meshkujt e tjerë, ai mbetet identik me gjithë hyjneshat e tjera dhe funksionalisht ka një identitet — ai është femër. Edhe pse mundohet të artikulojë atë çfarë e mundon, ai prapë ngelet pa individualitet. Jo krejt i bindur se është grua, nga pasiguria e madhe e të mosqenurit mjaftueshmërisht femër, ai përqafton në formë kompulsive stereotipet e krijuara nga meshkujt dhe përfundon si asgjë më shumë sesa një grumbull manerizmash të shtirura.

Që të sigurohet se është “Burrë”, mashkulli sigurohet që edhe femra të jetë padyshim “Grua”, e kundërta e “Burrit”, pra, femra duhet të sillet si një peder. Vajza e Babit, me të gjitha instinktet femërore të saj të ndrydhura qysh në fëmijëri, me lehtësinë më të madhe, bindet dhe përshtatet në këtë rol.

Autoritetet dhe qeveria

Duke mos e pasur gjykimin për të dalluar të mirën nga e keqja, për shkak se i mungon ndërgjegjja që buron vetëm nga aftësia për të bashkëndjerë me të tjerë... në mungesë të besimit në veten e tij, me nevojën e kotë për të garuar, dhe në paaftësinë për të bashkëpunuar, mashkulli ndjen nevojën ta udhëheqin dhe kontrollojnë. Për këtë arsye ai ka krijuar autoritete — priftërinjë, ekspertë, shefa, liderë, etj. — dhe qeverinë. Duke dashur që të udhëhiqet nga femra (Mami), por në pamundësi për ta pranuar këtë fakt (fundja, *BURRË* është), duke dashur të luajë Gruan, të uzurpojë rolin e saj si Udhëheqëse dhe Mbrojtëse e tij, ai sigurohet që të gjitha autoritetet të jenë meshkuj. Nuk ka as edhe një arsye pse një shoqëri, që përbëhet nga qenie racionale, empatike, të përmbushura dhe pa asnjë arsye për të qenë në garë me njëri-tjetrin, duhet të kenë qeveri, ligje dhe liderë.

Filozofia, feja dhe moraliteti i bazuar në seks

Paaftësia e mashkullit për të krijuar lidhje me këdo apo çfarëdo, e bën jetën e tij të pakuptimtë dhe të paqëllimtë (pikëpamja më e thellë mashkullore është se jeta është absurde), prandaj ai ka krijuar filozofinë dhe fenë. Si një qenie boshe, ai sheh drejt të jashtmes, jo vetëm për udhëheqje dhe kontroll, por edhe për shpëtimin e tij e kuptimin e jetës. Në pamundësi për ta përjetuar lumturinë mbi tokë, ai shpiku Parajsën.

Për një burrë, në mungesë të empatisë për të tjerët dhe si qenie tërësisht seksuale, “gabimi” është “leje” seksuale dhe përfshirja në akte seksuale “devijante” (joburrërore), pra në akte që mund të shpërfaqin natyrën e tij krejt pasive dhe seksuale, dhe të cilat nëse shijohen, larg qoftë, “civilizimi” ynë do të merrte fund, sepse ky “civilizim” është tërësisht i bazuar mbi nevojën e tij për ta mbrojtur veten nga këto prirje. Për një grua (sipas burrave) çdo sjellje që zgjon te burrat “lejen” seksuale është “gabim” — pra, të mos vendosë nevojat e saj para nevojave të tij, dhe të mos jetë peder.

Feja jo vetëm që i jep mashkullit një qëllim (Parajsën) dhe i mbanë gratë të lidhura me burrat, por ofron edhe rituale për shlyerjen e fajit e turpit që ai ndjen se nuk ka mbrojtur veten nga impulset e tija seksuale; pra, në thelb, fajin e turpin që ndjen se është mashkull.

Shumica e burrave, tmerrësisht qyqarë, ua mveshin grave dobësitë e tyre të lindura, i quajnë ato dobësi femërore dhe besojnë se meshkujt zotërojnë forcën femërore; shumica e filozofëve, më pak qyqarë, përballen me pamjaftueshmëritë e burrave, por, megjithatë, nuk e pranojnë se ato i përkasin vetëm burrave. Prandaj, ata e quajnë gjendjen mashkullore Konditë Njerëzore, e pozicionojnë problemin e tyre të hiçit, që i tmerron, si një dilemë filozofike, dhe rrjedhimisht i japin rëndësi shtazërisë të tyre, në mënyrë grandioze e quajnë hiçin e tyre “Problem identiteti” dhe më pas turtullisin me pompozitet mbi “Krizën e individit” dhe “Esencën

e qenies”, “Qenien që i paraprinë esencës”, “Format ekzistenciale të qenies”, etj. etj.

Gruaja, jo vetëm që e merr identitetin dhe individualitetin e saj si të mirëqenë, por e di mirë, instinktivisht, se mënyra e vetme për të gabuar është kur lëndon të tjerët, dhe se kuptimi i jetës është dashuria.

Paragjykimet (racore, etnike, fetare, etj.)

Mashkulli ka nevojë për viktima të cilët mund t'i fajësojë për dështimet dhe paaftësitë e tij, si dhe ta shfryjë gjithë mllefin e tij që nuk është femër. Projektimi i skemave diskriminuese ndihmon burrat që kanë më shumë pushtet të zgjerojnë sasinë e pidhit që kanë në dispozicion.

Konkurrenca, prestigji, statusi, arsimimi formal, injoranca dhe klasa sociale dhe ekonomike

Me dëshirën e flaktë për t'u adhuruar nga gratë, por rrënjësisht i pavlerë, mashkulli ndërton një shoqëri tejet artificiale që i lejon atij të përvetësojë ato që në dukje duken si vlera, siç janë paraja, prestigji, “klasa e lartë” shoqërore, titujt, pozitat profesionale dhe akademike, duke shtypur në aspektin profesional, social, ekonomik e arsimor sa më shumë burra të tjerë.

Qëllimi i arsimit “të lartë” nuk është edukimi, por përjashtimi i sa më shumë njerëzve nga profesione të ndryshme.

Mashkulli, krejtësisht fizik dhe i paaftë për marrëdhënie mendore, edhe pse ka aftësi të përdori njohuri dhe ide, megjithatë nuk arrin të identifikohet me to, t'i kuptojë emocionalisht: ai nuk vlerëson njohurinë dhe idetë në vetvete (ato janë thjesht mjete për të arritur qëllime), prandaj nuk e ndjen nevojën për bashkëmendimtarë ose kultivim të potencialit intelektual të të tjerëve. Përkundrazi, mashkulli përfiton shumë nga injoranca; një grup i vogël i burrave të dijsëm kanë epërsi ndaj atyre të padijshmëve, dhe, mbi të gjitha,

mashkulli e di shumë mirë se në një shoqëri grash të përndritura dhe të vetëdijësuar, ai do të marrë fund. Femrës së shëndoshë, ballëllartë, i pëlqen të shoqërohet me ata që janë të barabartë me të, t'i respektojë dhe të ndajë kënaqësi me ta; meshkujt dhe femrat që vuajnë nga pasiguria, nga mungesa e vetëbesimit, u pëlqen të shoqërohen me krimba.

Asnjë revolucion i mirëfilltë social nuk mund të arrihet nga meshkujt, sepse ata që janë lart e duan status quo-në, ndërkohë ata që janë poshtë tyre duan vetëm të bëhen si ata lart. Mashkulli “rebel” është një farsë; kjo është një “shoqëri” e mashkullit, e ndërtuar nga *ai*, për të përmbushur nevojat e *tij*. Ai nuk kënaqet asnjëherë, sepse e ka të pamundur të kënaqet. Në thelb, mashkulli rebelohet vetëm ndaj të qenurit mashkull. Ai ndryshon vetëm kur e detyron teknologjia, apo kur nuk ka rrugëdalje tjetër, kur “shoqëria” arrin në një pikë që nuk mban më, kur ai ose duhet të ndryshojë ose të vdesë. Në këtë pikë jemi sot; nëse gratë nuk marrin situatën në dorë, me shumë gjasë do të vdesim.

Pengimi i bashkëbisedimit

Duke qenë tërësisht egocentrik dhe i paaftë për të krijuar lidhje me çdo gjë jashtë qenies së tij, “bisedat” e mashkullit, kur nuk janë mbi veten e tij, janë një llomotitje jopersonale, larg çdo gjëje që ka ndonjë vlerë njerëzore. “Bisedat intelektuale” mes meshkujve janë një përpjekje e tyre kompulsive dhe e sforcuar për t'i mahnitur femrat.

Vajza e Babit, pasive, që përshtatet, respekton dhe adhuron mashkullin, i lejon atij t'i imponohet asaj me llafë të kota. Ajo e bën këtë lehtësisht, për shkak se tensioni, ankthi, mungesa e qetësisë, pasiguritë, vetëdyshimit, mungesa e besimit tek ndjenjat dhe intuita e saj, të gjitha këto të rrënjosura thellë në kokën e saj nga Babi, ia kanë mjegulluar perceptimin dhe aftësinë për të kuptuar kur një mashkull flet palidhje; si ai esteti kur “vlerëson” bërlllokun e ashtuquajtur “Art i Madh”, edhe asaj i duket sikur po shijon praninë e dikujt që është

mërzitshëm deri në vdekje. Ajo, jo vetëm i jep atij hapësirë për të thënë dokrra, por edhe i përshtatet nivelit të tij të bisedimit.

E mësuar qysh në fëmijëri të hershme të silltet me mirësi, edukatë, “dinjitet”, ajo akomodon nevojën e mashkullit për ta fshehur shtazërinë e tij, duke e ulur njerëzishëm nivelin e saj të “bisedimit” në imtësira, në diskutime krejt të parëndësishme, pa kripë — ose “edukohet” me diskutime “intelektuale”, pra ligjërime jopersonale mbi tema të kota — siç janë Prodhimi i Brendshëm Bruto, Tregu i Përbashkët apo ndikimi i Rembosë në pikturën simboliste. Aq e mësuar është ajo të përshtatet në këtë formë, sa i është bërë natyrë e dytë dhe ajo vazhdon akomodon burrat edhe kur është duke diskutuar me femra të tjera.

Përveç akomodimit, “bisedimi” i saj është gjymtuar edhe nga ndjenja e pasigurisë se mos padashje artikulon ndonjë mendim devijant apo krejt origjinal, por edhe nga sensi i vetëpërfshirjes që i vjen nga pasiguria dhe që e pengon të bëjë një bisedë të këndshme. Mirësia, mirësjellja, “dinjiteti”, pasiguria dhe vetëpërfshirja nuk nxisin thellësinë dhe mençurinë, dy karakteristikat më thelbësore për një bashkëbisedim të vërtetë. Këto lloj bisedash shpërthejnë rrallë, dhe vetëm femrat me vetëbesim të plotë, arrogante, të hapura, krenare dhe kokëforta janë të afta për biseda të thella, të zgjuara, kuçkash.

Pengimi i miqësisë (dashurisë)

Burrat përbuzin veten e tyre dhe burrat e tjerë që i kanë tërë kohës në mendje por nuk i shohin si femra (p.sh. analistët “dashamirës” dhe “Artistët e Mëdhenj”) apo si agjentë të Zotit, si dhe gjitha gratë që sillen me ta me përkëdheli dhe respekt: femrat-meshkuj, të pasigurta dhe që duan aprovim, përbuzin veten dhe gratët e tjera si vetja: femrat-femra, me vetëbesim, jetëdashëse, kërkuese, më përbuzin mua dhe të gjitha femrat-meshkuj. Shkurt, pra, përbuzja është rendi i ditës.

Dashuria nuk është varësi apo seks, por është miqësi, dhe si e tillë, dashuria nuk mund të ekzistojë mes dy meshkujve, mes një mashkulli dhe një femre, apo mes dy femrave, njëri apo të dy nga të cilët janë meshkuj të mendjelehtë, të pasigurtë, miklues; njëlloj si bashkëbisedimi, edhe dashuria mund të ekzistojë vetëm mes dy femrave-femra me vetëbesim, të lira, të pavarura, plot jetë, sepse miqësia bazohet në respekt, dhe jo në përbuzje.

Edhe femrat plot jetë e kanë të vështirë të krijojnë marrëdhënie të thella miqësore kur janë në moshë madhore, sepse në atë moshë ato ose janë të lidhura me një burrë për të mbijetuar ekonomikisht, ose janë fundosur nga përpjekjet për të çarë rrugën nëpër xhungël dhe për të mbajtur kokën mbi masat amorfe. Dashuria nuk mund të lulëzojë në një shoqëri që bazohet në para dhe në punë të pakuptimta: dashuria kërkon liri të plotë ekonomike dhe personale, kohë të lirë dhe mundësi për t'u marrë me aktivitete që të përfshijnë thellësisht dhe janë emocionalisht të kënaqshme, të cilat kur ndahen me ata që respektojmë, çojnë drejt miqësisë së vërtetë. “Shoqëria” jonë nuk ofron pothuajse asnjë mundësi për t'u marrë me aktivitete të tilla.

Duke e zhveshur botën nga bashkëbisedimi, miqësia dhe dashuria, mashkulli në vend të tyre na ofron këto koncepte të mjera:

“Arti i Madh” dhe “Kultura”

“Artisti” mashkull tenton ta zgjidhë dilemën e tij të pamundësisë për të jetuar, pra për të qenë femër, me ndërtimin e një botë shumë artificiale, ku burri merr përmasa heroike, pra, shfaqet me tipare femërore, ndërkohë që femra merr rolin e saj të nënshtruar, të boshatisur e tejet kufizues, pra, bëhet mashkull.

Duke qenë se qëllimi “artistik” i mashkullit nuk është të komunikojë (ai nuk ka asgjë brenda vetes për të thënë), por vetëm të fshehtë shtazërinë e tij, ai reduktohet në simbolizëm dhe lakonizëm (“çështje të thella”). Shumica e njerëzve, sidomos ata “të

arsimuarit”, modestë, që dyshojnë tek gjykimi i tyre, që respektojnë autoritetin (“Babi e di më mirë”), shumë lehtë mund të mashtrohen dhe të besojnë se lakonizmi, pakuptueshmëria, shmangia, paqartësia dhe bajatizmi janë shenja të thellësisë dhe përndritjes.

“Arti i Madh” dëshmon se burrat janë superiorë ndaj grave, se burrat janë gra, duke mbajtur etiketën “Art i Madh”, të cilin, siç kanë dëshirë të na e përkujtojnë vazhdimisht anti-feministët, është krijuar nga burrat. Ne e dimë se “Arti i Madh” është i madh sepse kështu kanë vendosur autoritetet mashkullore, dhe nuk mund të mos pajtohemi, sepse vetëm ata që kanë ndjeshmëri të mprehta dhe tejet më superiore se tonat, vetëm ata mund ta kuptojnë dhe të vlerësojnë llumin që kanë vlerësuar.

Me vlerësime mirren ata që mbahen si “të kultivuar”; pasivë dhe të paaftë, pa fije imagjinate dhe dije, ata nuk kanë aktivitet tjetër; të patalentuar për të krijuar vetë, për të gdhendur një botë të re rreth vetes, për të lënë një gjurmë aty ku jetojnë, ata pranojnë atë që iu serviret; në vend që të bëhen krijues dhe veprues, ata bëhen spektatorë. Përthithja e “kulturës” është një përpjekje e dëshpëruar dhe e shfrenuar për t’u argëtuar në një botë joargëtuese, një ikje nga tmerri i ekzistencës shterpe dhe idiote. “Kultura” është një cucëll për egot e të paafteve, mjet për t’i dhënë kuptim sehirrit pasiv; mundësi për t’u krenuar me aftësinë për të çmuar gjëra “delikate”, dhe për të parë margaritarë aty ku ka vetëm bagla (ata duan të adhurohen që adhurojnë). Ata nuk besojnë në forcën e tyre për të ndryshuar gjërat, të nënshtruar ndaj status quo-së, atyre nuk u mbetet asgjë tjetër pos të adhurojnë bukurinë e mutit, sepse, me aq sa u shohin sytë, vetëm muti u ngelet.

Adhurimi i “Artit” dhe “Kulturës” përveçse i shtyn gratë të bëjnë aktivitete të mërzitshme dhe pasive, i pengon edhe të merren me gjëra të rëndësishme dhe me vlerë, të kultivojnë aftësi aktive, dhe bën që ndjeshmëritë tona të kenë ndërhyrje të vazhdueshme nga disertacionet pompoze mbi bukurinë e thellë të kësaj dhe

asaj lëvizje. Kjo bën që “artisti” të duket si njeri me ndjeshmëri, me perceptime, njohuri dhe gjykime superiore, duke dobësuar kështu besimin e grave të pasigurta në vlerën dhe vlefshmërinë e ndjenjave, perceptimeve, njohurive dhe gjykimeve të tyre.

Mashkulli, me shtrirjen e tij të kufizuar të ndjenjave, dhe rrjedhimisht, me perceptime, njohuri dhe gjykime tejet të kufizura, ka nevojë që “artisti” ta udhëheqë atë, t’i flasë atij mbi kuptimin e jetës. Por “artisti” mashkull, tërësisht seksual, i paaftë të bashkëndjejë me çfarë ndodh jashtë ndjesive të tija fizike, duke mos pasur asgjë për të thënë përtej idesë se jeta na qenka absurde dhe e pakuptimtë, nuk mund të jetë artist. Si mund të na flasë mbi kuptimin e jetës dikush që nuk di të jetojë? Nocioni “artist mashkull” është në vetvete kundërthënës. Një bastard mund të prodhojë vetëm art bastard. Artist i vërtetë është secila femër me vetëbesim, me mendje të shëndoshë, dhe në një shoqëri femrash Arti i vetëm, Kultura e vetme, janë femrat krenare, lozonjare, unike, që vallëzojnë me njëra-tjetrën dhe me çdo gjë tjetër në univers.

Seksualiteti

Seksi nuk është pjesë e një marrëdhënie: përkundrazi, është përvojë vetmitare, jokreative, një harxhim kolosal kohe. Me një lehtësi të madhe — shumë më të madhe se ç’mund të paramendojë ajo — femra mund ta braktisë dëshirën e saj për seks, gjë që do ta bëjë atë të qetë dhe cerebrale dhe të lirë për t’ju përkushtuar marrëdhënieve dhe aktiviteteve që kanë vërtet vlerë; por, mashkulli, që tërhiqet seksualisht nga femrat dhe që kërkon vazhdimisht t’i joshë ato, e stimulon femrën e tejseksualizuar deri në epsh të pakontrolluar, duke e futur atë kështu në një thes seksi prej ku shumë pak gra arrijnë të dalin. Mashkulli hamshor eksiton femrën epshërore; ai s’ka çare — kur femra të shkojë përtej trupit të saj, kur të shkojë përtej kafshërisë, mashkulli, egoja e të cilit përbëhet nga penisi i tij, do të zhduket.

Seksi është ikje për mendjelehtat. Sa më mendjelehtë një grua, aq më shumë është shkrië ajo në “kulturën” mashkullore, pra, sa më zemërmirë, aq më seksuale është ajo. Gratë më zemërmira të “shoqërisë” sonë janë maniake seksi. Por, duke qenë shumë të mira, jashtëzakonisht të mira, ato natyrisht nuk përfundojnë duke bërë seks — kjo është e pahijshme — ato bëjnë dashuri, komunikojnë me trupat e tyre dhe krijojnë raporte sensuale; ato më të lexuarat janë në harmoni me hyrje-daljet fërkuese të Erosit, dhe kapin një copë Universi me grusht; besimtarët arrijnë të shkrihen spiritualisht në Sensualizmin Hyjnor; mistikët shkrihen në Parimin Erotik dhe bëhen një me Kozmosin; ndërsa, ato që bëjnë acid kontaktojnë qelizat e tyre erotike.

Në anën tjetër, ato femra që pranojnë më së paku “Kulturën” mashkullore, pra ato jo zemërmirat, me shpirtrat e tyre të thjeshtë e të pagdhundur që reduktojnë seksin në seks, që janë shumë naive për botën e të rriturve me lagjet e rregullta periferike, me shtëpi, kredi, fshesa e gjëra bebesh, që janë tepër egoiste për të rritur fëmijë e për të mbajtur burra, aq të pacivilizuara sa nuk u han bytha se çfarë mendojnë të tjerët për to, tejet arrogante për të respektuar Babin, “të Mëdhenjtë” apo dituritë e lashta Antike, që besojnë vetëm në instiktet e tyre të brendshme, kafshërore, që barazojnë Kulturën me zogëza, devijimi i vetëm i të cilave është gjuetia për emocione dhe eksitime emocionale, të cilat u lëshohen “skenave” të gërditshme, të ndyta, kuçka të dhunshme që urrejnë, që duan t’i godasin me grusht turinjve të gjithë ata që i irritojnë, ato që në shikim të parë do t’ia ngulnin një mashkulli thikën në gjoks ose do t’ia fusnin një pincë drejt e në vrimë të bythës, sikur ta dinin se mund ta bënin dhe nuk do t’i kapnin, me pak fjalë, ato që, sipas standardeve të “kulturës” sonë, janë SKAM... ato femra janë të geta dhe relativisht cerebrale dhe në prag të aseksualitetit.

E pazmbrapsur nga korrektesa, bukuria, diskrecioni, opinioni publik, “moral”, respektimi i trapave, SKAM gjithmonë qelbanike, e

ndytë, e ulët, që ka jetuar... dhe jeton, jeton... ato e kanë parë gjithë shfaqjen — deri në detajin më të vogël — skenat e seksit, skenat lezbike — ata kanë ecur përgjatë bregut të ujit, kanë përfunduar nën çdo liman dhe mol — moli i Piter, moli i pidhit ... duhet të bësh shumë seks për të arritur në anti-seks, dhe SKAMi i ka parë të gjitha, ato janë gati për një shfaqje të re; ato duan zvarriten nga poshtë urës së molit, të lëvizin, të ngrihen, të fluturojnë. Por SKAMi ende nuk ka fituar; SKAMi qëndron akoma në llogoret e “shoqërisë” sonë, shoqëri kjo e cila, nëse nuk ndryshon në themel, apo nëse nuk zhduket nga një Bombë, do ta qijë veten deri sa të japi shpirt.

Mërzitshmëria

Jeta, në një shoqëri të krijuar nga dhe për krijesa që, kur nuk janë të zymta dhe depressive, janë thellësisht të mërzitshme, mund të jetë, kur nuk është e zymtë dhe depressive, thellësisht e mërzitshme.

Fshehtësia, censura, frenimi i njohurive, ideve dhe zbulimeve të reja

Sekreti më i madh dhe i neveritshëm që çdo mashkull e mban thellë brenda vetes, është frika se një ditë dikush do ta zbulojë se ai nuk është femër, por mashkull, pra një kafshë subnjerëzore. Ai nuk përdor vetëm mirësinë, mirësjelljen dhe “dinjitetin”, por për ta fshehur më mirë ekspozimin e seksit të tij mashkullor dhe për të ruajtur pozitën e panatyrshme dominante të tij në “shoqëri”, mashkulli përfundon duke përdorur:

1. Censurën. Duke iu përgjigjur me refleks punëve dhe frazave në formë të izoluar dhe jo kuptimit të përgjithshëm duke përdorë trurin, mashkulli tenton të parandalojë epshin dhe shpërfaqjen e shtazërisë së tij duke i bërë censurë jo vetëm “pornografisë”, por çdo punë që përmban fjalë “të ndyta”, pavarësisht kontekstit në të cilat përdoren ato.

2. Frenimin e të gjitha ideve dhe njohurive që mund të shpërfaqin apo të kërcënojnë pozitën e tij dominuese në “shoqëri”. Të dhënat biologjike dhe psikologjike injorohen përgjithësisht, për shkak se dëshmojnë inferioritetin e thellë të meshkujve ndaj femrave. Gjithashtu, ne kurrë nuk do t'i japim zgjidhje sëmundjeve mendore, përderisa mashkulli është ai që ka pushtet, sepse ai përfiton drejtpërdrejtë nga kjo gjë — vetëm ato femra që kanë disa dërrasa mangut u lejojnë meshkujve të kenë kontroll mbi çkado, dhe, së dyti, mashkulli nuk mund ta pranojë se atësia luan rol në shkaktimin e sëmundjeve mendore.

3. Ekspozimin. Kënaqësia e vetme e mashkullit në jetë — për aq sa një burrë i ngurtë e i ngrysur arrin të ndiejë kënaqësi — është ekspozimi i të tjerëve. Nuk ka rëndësi për çfarë i ekspozon, për aq sa i ekspozon; kështu largon vëmendjen nga vetja. Ai kënaqet më së shumti kur indentifikon të tjerët si agjentë armiqsor (Komunistë dhe Socialistë), dhe kështu ai pozicionon jo vetëm veten, por edhe vendin nga vjen dhe gjithë botën perëndimore, si hapësira që nuk paraqesin asnjë rrezik. Çimkat nuk janë në bythën e tij, por janë në Rusi.

Mosbesimi

Në pamundësi për të ndjerë empati, dashuri apo besnikëri, i përfshirë vetëm me veten e tij, mashkulli nuk di si të luajë pa hile; si qyqan, me nevojën e vazhdueshme që të përkëdhelet dhe të aprovohet nga një femër, pa të cilën ai është i pafuqishëm, dhe në mënyrë që të mos zbulohet shtazëria e tij, pra fakti që është mashkull, gjithmonë duke u fshehur, atij i duhet vazhdimisht të gënjejë; si njeri bosh, ai nuk ka nder apo integritet — ai as nuk e di kuptimin e këtyre fjalëve. Shkurt, mashkulli është i pabesë dhe në një “shoqëri” mashkullore, qëndrimi më i çmuar është cinizmi dhe mosbesimi.

Shëmtia

Duke qenë krejt seksual, i paaftë të japë përgjigje cerebrale apo estetike, krejtësisht materialist dhe lakmitar, mashkulli, përveç që ia imponon botës “Artin e Madh”, dhe ka zbukuruar qytetet e tij të betonizuara me ndërtesa të shëmtuara (brenda e jashtë), me orendi, stenda, autostrada, vetura e kamionë mbeturinash të shëmtuara dhe, mbi të gjitha, me veten e tij të qelbur.

Urrejtja dhe dhuna

Mashkullin e grin përbrenda tensioni, mllefi që nuk është femër, paaftësia e tij për të ndërjerë një pikë kënaqësie; e gërryen urrejtja — jo urrejtja e arsyeshme ndaj atyre që të abuzojnë apo të fyejnë — por urrejtja e paarsyeshme, pa dallime... urrejtja, fundja, ndaj vetes së tij të pavlerë.

Dhuna e shfrenuar, përveçse “dëshmon” se ai është “Burrë”, i shërben edhe për të kanalizuar urrejtjen dhe, po ashtu — meqenëse mashkulli arrin të artikulohet vetëm seksualisht, dhe si një gjysëm i vdekur që vuan dëshpërimisht për një stimulim — ai ngacmohet nga dhuna edhe seksualisht...

Sëmundja dhe vdekja

Të gjitha sëmundjet janë të shërueshme, dhe nëse plakja dhe vdekja janë pasojë e sëmundjeve, atëherë është krejt e mundur të mos plakemi kurrë dhe të jetojmë përjetësisht. Në fakt, problemet e plakjes dhe vdekjes do të mund të zgjidhen brenda pak vitesh, nëse shkenca tronditet nga zbulime të tilla. Por institucionet mashkullore nuk e lejojnë këtë gjë, për këto arsye:

1. Shkencëtarët meshkuj evitojnë hulumtimet biologjike, nga tmërri i zbulimit se meshkujt janë femra, dhe u dedikohen programeve virile e “burrërore” të luftës dhe vdekjes.

2. Ngurtësia, mërzitshmëria, shtrenjtësia, kohëgjatësia dhe ekskluziviteti i padrejtë i sistemeve “të larta” arsimore, janë dekurajuese për shumë shkencëtarë potencialë.
3. Propaganda që përhapet nga profesionistë meshkuj të pasigurtë, që me xhelozë ruajnë pozitat e tyre, në mënyrë që konceptet abstrakte shkencore të kuptohen vetëm nga një grup i vogël e i përzgjedhur.
4. Mungesa e përhapur e vetëbesimit që ushqehet nga sistemi i baballarëve që dekurajojnë shumë vajza të talentuara që të jenë shkencëtare.
5. Mungesa e automatizimit. Sot ka një mori të dhënash, të cilat po të procesohen dhe ndërveprojnë, do të çonin drejt zbulimit të ilaçit kundër kancerit dhe sëmundjeve të tjera, dhe, me gjasë, edhe vetë çelësit të jetës. Por procesimi i këtyre të dhënave masive bëhet vetëm me kompjuterë të shpejtësisë së lartë. Avancimi i kompjuterëve do të vonohet pafundësisht nën sistemin e kontrollit mashkullor, sepse mashkullin e llahtaris mendimi se një ditë mund ta zëvendësojnë makinat.
6. Nevoja e parreshtur e sistemit të parave për produkte të reja. Ata pak shkencëtarë që nuk punojnë në programe të vdekjes detyrohen të bëjnë kërkime për nevoja korporatash.
7. Meshkujt adhurojnë vdekjen — vdekja e eksiton seksualisht, dhe si një i vdekur përbrenda, ai kërkon të vdesë.
8. Sistemi i njëanshëm i parave mbështet shkencëtarë jokreativë. Shumica e tyre vijnë nga familje relativisht të pasura ku pushtetin suprem e ka Babi.

I paaftë të përjetojë lumturinë e vërtetë, të vetmen gjë që i jep kuptim jetës, mashkulli është, në rastin më të mirë, i relaksuar, i qetë, neutral, një gjendje kjo jashtëzakonisht kalimtare, sepse mërzia vjen fill pas saj; ai pra është i dënuar të jetojë një jetë të mjerë, me momente të shkurtra e kalimtare të rehatisë, gjendje kjo të cilën ai e arrin falë një gruaje. Pra, për nga natyra, mashkulli është shushunjë, parazit emocional dhe, si rezultat, nuk e meriton të jetojë, sepse askush nuk duhet të gëzojë të drejtën të jetojë në kurriz të tjetrit.

Ashtu siç mendohet se jeta e një njeriu ka ma shumë vlerë se jeta e një qeni, me argumentin se njeriu është qenie më e evoluar dhe me vetëdije më superiore, ashtu edhe gratë mund të kërkojnë që ekzistenca e tyre të ketë vlerë superiore në krahasim me burrat. Pra, elimini mi çdo mashkulli është jo vetëm veprim i drejtë dhe i mirë, në dobi të grave, por edhe akt bamirësie.

Mirëpo, këtë dilemë morale do ta zbusë koha, sepse mashkulli gradualisht do të asgjësoj vetveten. Përveç se do të vazhdojnë me luftërat e tyre klasike shumëshekullore, si dhe me trazira racore, meshkujt çdo herë e më shumë ose po bëhen homoseksualë ose po vetëshkatërrohen me drogë. Femrës do t'i duhet që një ditë, deshi apo s'deshi, të marrë situatën në dorë, dhe, mbi të gjitha, do të jetë e detyruar ta bëjë këtë gjë për arsye praktike, sepse një ditë mashkulli mund të zhduket.

Ky trend është në rritje, për shkak se meshkujt përherë e më shumë po vetëedukohen dhe po reflektojnë mbi faktin se çfarë është në interesin e femrave është edhe në interesin e tyre; se ata mund të jetojnë vetëm nëpërmjet femrës dhe sa më shumë inkurajohen femrat të jetojnë, të përmbushin vetveten, të jenë femra dhe jo meshkuj, aq më shumë do të jetojë edhe ai; ai do ta kuptojë se jeta është më e lehtë dhe më e bukur kur ai jeton *nëpërmjet* saj, dhe jo kur tenton të bëhet ajo dhe të uzurpojë cilësitë e saj, t'i huazojë ato, dhe t'i bëjë presion femrës duke i thënë së ajo është mashkull.

Edhe për ata që janë pедера, që e kanë pranuar që janë meshkuj, pra, pasivitetin dhe seksualitetin e tyre të plotë, femininitetin e tyre, edhe për ta është më mirë të solidarizohen me gratë që janë krejtësisht femra, se kështu është më e lehtë që ai të jetë mashkull, feminin. Po të ishin të mençur, burrat do të tentonin të bëheshin me të vërtetë femra, dhe do të bënin hulumtime serioze biologjike që do t'i çonte në këtë pikë, me anë të ndërhyrjeve në tru dhe në sistemin nervor, duke u shndërruar kështu mendërisht dhe fizikisht në gra.

Se a duhet apo jo të vazhdojnë femrat të riprodhojnë apo nëse riprodhimi duhet të ndodhë në laborator, kjo çështje një ditë do të studiohet në akademi: çfarë ndodh kur të gjitha femrat mbi moshën 12 vjeç marrin Pilulën, dhe nuk ka më aksidente? Sa gra do të ngelin ose do të mbajnë shtatzaninë qëllimisht? Jo, e dashur, gratë nuk e adhurojnë pjellshmërinë, pavarësisht se çfarë thonë gratë trushpërlara, që janë kthyer në robotë. A do të duhej që të ndanim një tufë burra mënjane dhe t'i përdornim ata si objekte riprodhimi? Kjo nuk është zgjidhje, pa dyshim. Zgjidhje është vetëm riprodhimi i foshnjeve në laborator.

Sa i përket çështjes se a do të duhej të vazhdojmë të riprodhojmë meshkuj apo jo, kjo nuk vihet në diskutim, sepse meshkujt, ashtu si sëmundjet, gjithmonë kanë ekzistuar dhe do të ekzistojnë. Atëherë kur kontrolli gjentik do të jetë i mundur — gjë që do të ndodhi së shpejti — në atë rast pa dyshim se duhet të riprodhojmë vetëm qenie të plota, të formësuara, dhe jo qenie të mangëta, me defekte të thella emocionale, siç është mashkulli. Njëlloj siç nuk do të ishte etike të riprodhosh qëllimisht njerëz të verbër, njëlloj joetike është edhe riprodhimi i qëllimshëm i sakatëve emocionalë.

Po pse të prodhojmë femra? Në fakt, pse duhet të kemi breza të ardhshëm?

Cili është qëllimi i tyre? Për çfarë shërben riprodhimi në rast se i japim fund plakjes dhe vdekjes? Pse shqetësohemi se çfarë ndodh kur ne vdesim? Pse duhet të na interesojë nëse do të

trashëgohemi nga gjenerata të reja?

Herët a vonë, me evolucion social, natyrshëm do të vijë dita kur femrat do të sundojnë botën dhe, rrjedhimisht, dita kur nuk do të ketë më riprodhim meshkujsh, dhe përfundimisht, nuk do të ketë më as riprodhim të femrave.

Por SKAMit i ka humbur durimi; SKAMin nuk e ngushëllon më mendimi se gjeneratat që vijnë do të kenë një jetë më të mirë; SKAMi dëshiron ta gëzojë jetën e vet. Dhe, po të ishin shumica e grave SKAM, brenda pak javëve ato do të arrinin të kishin kontroll të plotë mbi këtë shtet, duke u tërhequr nga tregu i punës dhe, kështu, duke paralizuar gjithë vendin. Ekonomia do të thyhej në mes nëse gratë heqin dorë nga sistemi monetar, ndëprerëjnë të gjitha blerjet, dhe, duke mos respektuar asnjë rregull që nuk duhet respektuar, fillojnë e plaçkisin. As forcat policore, as garda nacionale, as ushtria, flota e marinët, sikur të bëheshin gjithë bashkë, nuk do të mund t'i bënin ballë rebelimit të gjysmës së popullsisë, popullsi kjo pa të cilën ata nuk mund të mbijetojnë.

Nëse gratë thjesht i braktisin burrat dhe vendosin të mos kenë më punë me ta — kurrë më — burrat, qeveria dhe ekonomia e vendit do të shembeshin në çast. Ato gra që janë të vetëdijshme për superioritetin dhe pushtetin e tyre në krahasim me meshkujt, do të mund të arrinin pushtetin e plotë dhe nënshtrimin e meshkujve ndaj femrave edhe pa i braktisur ata. Në një shoqëri të shëndoshë, mashkulli do të pranonte të udhëhiqej nga femra. Mashkulli është genie butake që lehtësisht i bindet dominimit të çdo femre që i ofron dominim. Në fakt, mashkulli kërkon dëshpërimisht të udhëhiqet nga femrat, ai kërkon që fjalën e fundit ta thotë Mami, dhe do që t'i dorëzohet krejtësisht përkujdesjes së saj. Por, ne sot nuk kemi një shoqëri të shëndoshë, dhe shumë gra nuk e kanë as idenë më të vogël se ku qëndrojnë në raport me burrat.

Prandaj, konflikti nuk qëndron mes femrave dhe meshkujve, por mes grave SKAM — pra, femrave dominante, të sigurta, me

vetëbesim, të prapta, të dhunshme, egoiste, të pavarura, krenare, kërkuese, jetëplota, liridashëse, arrogante, që e kanë kuptuar potencialin e tyre për të sunduar botën, që kanë prekur limitet e kësaj “shoqërie” dhe kërkojnë të shkojnë përtej asaj që shohin sytë — dhe, nga ana tjetër, femrave pasive, “të kultivuara”, me edukatë, me dinjitet, të përlurura, të varuara, të frikësuara, naive, të pasigurta, Vajzat-e-Babit që duan aprovim, që kanë frikë nga e panjohura, që duan të rrinë në shoqërinë e majmunëve, që ndiejnë siguri vetëm pranë Babit të Madh, një burri të fortë ku ato mund të mbështeten, dhe një fytyrë të dhjamosur e leshatore në Shtëpinë e Bardhë, që janë si qyqe përballë këtij realiteti të shëmtuar, përballë fytyrës së vërtetë të burrit dhe të Babit, femra që janë katandisur me derrat, që e kanë përbrendësuar shtazërinë, dhe deri diku kanë gjetur një lloj rehatie, në errësirën e mosdijes se kjo jetë mund të ishte ndryshe, që trurin, mendimet dhe pikëpamjet e tyre i kanë varfëruar në nivelin e mashkullit, dhe i kanë zhveshur nga sensi, imagjinata dhe mençuria, se vetëm kështu ato kanë vlerë në “shoqërinë” mashkullore, dhe kanë reduktuar rolin e tyre mbi këtë tokë, ose, më mirë, në këtë llum, si qenie pjellore që përkëdhelin, përkundin e ushqejnë ego, që përjashtojnë njëra-tjetrën për imtësira, që projektojnë dobësitë e tyre, mashkullësinë e tyre, tek femrat e tjera, dhe i shohin femrat si të mjera.

Por, SKAMi nuk ka më durim të pres ditën deri sa të kthjellohen miliona idiotë trushpërlarë. Pse duhet që femrat e fuqishme të vazhdojnë të zvarriten dëshpërimisht në krah të burrave të mërzitshëm? Pse ato që janë plot jetë dhe imagjinatë, të konsultohen mbi politikat sociale me ata që janë pasivë dhe paimagjinatë? Pse ato që janë të pavarura, të notojnë në të njëjtin llum me të varurat, që nuk ia lëshojnë dorën Babit? Brenda një viti, një grusht SKAMësh do të mund të merrte pushtetin nëse do ta shkatërronin pandërprerë sistemin duke asgjësuar në mënyrë selektive pronën dhe duke vrrarë:

SKAMët do të bëhen pjesë e fuqisë jopunëtore, fuqisë përmbysëse; do të zënë vende të ndryshme jopune. Për shembull, shitëset SKAM nuk do të pranojnë para për mallra; operatorët telefonike SKAM nuk do të marrin para për thirrje; punëtorët SKAM në zyra dhe fabrika, jo vetëm se do ta bëjnë punën keq, por fshehurazi do të shkatërrojnë edhe pajisjet. SKAMët do të bëjnë jopunë deri sa t'i përjashtojnë nga puna, dhe më pas do të gjejnë punë tjetër për të mospunuar.

SKAMi do t'i lirojë me forcë nga puna shoferët e autobusëve, taksistët dhe shitësit e biletave të trenit, dhe do të organizojë autobusë, taksi dhe transport publik falas.

SKAMi do të shkatërrojë objekte të padobishme dhe të dëmshme: vetura, vitrina dyqanesh, “Vepra të Mëdha Arti”, etj.

Me kohë, SKAMi do të uzurpojë valët e rrjeteve radio-televizive, duke i liruar nga detyra të gjithë ata punonjës që mund pengojnë hyrjen e SKAMit brenda studiove të transmetimit.

SKAMi do godasë çifte — sa herë të gjejë një çift miks (mashkull-femër) do t'u hyjë në mes dhe do t'i ndajë.

SKAMi do të vrasë të gjithë burrat që nuk janë pjesë e Burrave Rezervistë të SKAMit, pra burra që punojnë me zell për t'u vetëasgjësuar, burra që veprojnë drejt, pavarësisht motiveve, burra që janë pjesë e lojës SKAM. Sa për ilustrim, në grupin e Burrave Rezervistë SKAM hyjnë: burrat që vrasin burra; shkencëtarë biologë që japin kontribut në programe jetike, dhe jo në luftëra biologjike; gazetarë, shkrimtarë, redaktorë, botues dhe producentë që përhapin dhe promovojnë idetë që çojnë drejt arritjes së qëllimeve SKAM; homoseksualët që me vezullimin dhe flakërimin e tyre japin shembull dhe inkurajojnë burrat e tjerë të çburrërohen, dhe, rrjedhimisht, të bëhen më të padëmshëm; burrat që vazhdimisht japin gjëra — para, sende, shërbime; burrat që i thonë gjërat ashtu siç janë (deri më sot nuk ka ndodhur), që u japin grave të drejtë, që shpërfaqin të vërtetën mbi veten e tyre, që u mësojnë meshkujve-

femra kokëbosh fjalitë e duhura për t'i përsërituar, dhe u thonë së qëllimi kryesor i një gruaje në jetë është të shpartallojë seksin mashkullor (për t'u ndihmuar burrave në këtë proces SKAMi do të bëjë Seanca Muti, ku çdo mashkull i pranishëm do të mbajë një fjalim që fillon me fjalinë: “Unë jam një mut, një mut i vogël, i ndyrë”, dhe do t'i rendisë të gjitha arsyet që e bëjnë të tillë. Si shpërblim, pas seancës, atij do t'i jepet mundësia të shoqërohet, për një orë të tërë, me SKAMët e pranishëm. Gjithashtu, meshkujt-femra që bëjnë jetë mondane dhe pedante, do të kenë mundësinë të marrin pjesë në këto seanca, për të qartësuar çdo lloj keqkuptimi apo dyshimi që mund të kenë në lidhje me seksin mashkull; të gjithë krijuesit dhe promovuesit e librave dhe filmave mbi seksin, etj. që përshpejtojnë procesin duke dhënë vetëm skena me Gojore dhe Qirje (meshkujt, si minjtë që ndjekin fyellin magjik, do të tundohen nga Pidhi deri sa t'ju vijë fundi, deri sa të mposhten dhe fundosen nën të, deri sa të mbyten si copa mishi pasive që janë); si dhe, trafikantët e drogës dhe avokatët që përshpejtojnë fundin e burrave.

Për t'i shpëtuar listës vrastare të SKAMit, parakusht për burrat, por jo shpëtim, është që ata të bëhen pjesë e Burrave Rezervistë. Për ta shpëtuar bythën e tyre të pavlerë, nga burrat pritet që ata jo vetëm të bëjnë mirë, por edhe ta luftojnë ligësinë. Disa nga shembujt më të ligë dhe më të dëmshëm janë: përdhunuesit; politikanët dhe ata që janë në shërbim të tyre (hartuesit e fushatave, anëtarët e partisë, etj.); këngëtarët dhe muzikantët e dobët; Kryesuesit e Bordeve; kryefamiljarët; qiradhënësit; pronarët e restoraneve e tavernave të yndyrshme që luajnë muzikë ashensori; “Artistët e Mëdhënj”; kumarxhinjtë dhe fajdexhinjtë koprracë; policët; magnatët; shkencëtarët që kontribuojnë në programe vdekjeprurëse e shkatërruese apo për industri private (praktikisht të gjithë shkencëtarët sot); gënjeshtarët dhe mashtruesit; DJ-ët; burrat që i vardisen qoftë sadopak çdo gruaje të panjohur; burrat që shesin pasuri të patundshme; agjentët

e bursave; burrat që flasin edhe kur nuk kanë asgjë për të thënë; burrat që rrinë rrugëve kot dhe shëmtojnë lagjen me praninë e tyre; stërshitësit; artistët sharlatanë; ata që hedhin plehrat përtoke; plagjiatorët; burrat që ia lëndojnë gruas edhe një fije floku; të gjithë burrat e industrisë së reklamave; psikologët dhe psikiatërët klinikë; shkrimtarët, gazetarët, redaktorët, botuesit e pandershëm, etj.; ata që censurojnë publikisht apo privatisht; të gjithë pjesëtarët e forcave mbrojtëse, përfshirë edhe ushtarët e thjeshtë (LBJ dhe McNamara japin urdhëra, por ushtarët i zbatojnë ato) dhe sidomos pilotët (bombën e hedh piloti, jo LBJ).² Në rast se një burrë sillet edhe mirë edhe keq, atëherë vlerësimi i përgjithshëm subjektiv i tij do të bëhet duke matur e peshuar të mirën dhe të keqen.

Tunduese është t'i fusësh këtu, bashkë me burrat, edhe "Artistet e Mëdha" femra, gënjeshtarët e mashtrueset, etj., por kjo do të ishte e pakuptimtë sepse shumë nga publiku nuk do ta kuptonin se kjo femër e vrarë në fakt është mashkull. Të gjitha gratë kanë një damar bashkëfajtorësie, por kjo ndodh ngaqë ato kanë bashkëjetuar shumë gjatë mes burrash. Asgjësoni burrat dhe gratë do të rilindin. Gratë janë të përmirësueshme; burrat jo, por sjellja e tyre po. Kur t'u djegi bytha nga SKAMi, shpejt do ta ndryshojnë faqen.

Ndërkohë që shemb, plaçkit, godet-çifte, shkatërron dhe vret, SKAMi edhe rekruton. Të rekrutuarit do të ndahen në dy grupe, trupat elitare, ku hyjnë aktivistët më të devotshëm (përmbysës, grabitqarë dhe shkatërrues) dhe elitat e elitave, që janë vrasësit.

Është e domosdoshme të shkatërrosh, dhe jo të dorëzohesh. Shumica e grave janë dorëzuar qysh në fillim. Ato që dorëzohen ia lënë në dorë pushtetin e plotë atyre që nuk dorëzohen; pikërisht këtë duan ata që janë në pushtet; ata nga ky

2. Lyndon B. Johnson, i njohur me inicialet LBJ, president i SHBA-së (1963–1969) dhe Robert McNamara, Sekretar i Mbrojtjes (1963–1969); të dy në detyrë gjatë luftës në Vietnam. (shën. i përkth.)

dorëzim nxjerrin vetëm përfitime; ky sistem i bazuar tërësisht mbi mospjesëmarrjen, pasivitetin, apatinë dhe mospërfshirjen masive të grave, vetëm sa forcohet. Por, dorëzimi është rruga e duhur për burrat, dhe SKAMi me entuziazëm do ta inkurajojë.

Shih brenda vetes për të gjetur shpëtim, medito duke parë kërthizën tënde, kjo është përgjigja, thonë ata që janë dorëzuar. Por nuk është kështu. Lumturia jeton jashtë nesh, dhe arrihet vetëm duke ndërvepruar me të tjerët. Qëllimi ynë duhet të jetë vetëharrimi, dhe jo vetëpërfshirja. Mashkulli, me aftësinë e tij për t'u sjellë sikur është qendra e botës, e ka kthyer vetëpërfshirjen nga një e metë e pafalshme, në një virtyt, duke e interpretuar atë jo vetëm si diçka të mirë, por si një e Mirë Filozofike, dhe, për këtë gjë, e lavdërojnë si të thellë.

SKAMi nuk do të organizojë protesta, demonstrata, marshime dhe greva për të arritur qëllimet e veta. Këto taktika i përdorin vetëm zonjat e këndshme dhe të sjellshme, të cilat me vetëdije të plotë ndërmarrin veprime që janë të garantuara të dështojnë. Për më tepër, vetëm femrat meshkuj që bëjnë jetë pedante e të rregullt, që janë mirëtrajnuar t'i përshtaten llojit, veprojnë me mentalitet turme. SKAMi përbëhet nga individë; SKAMi nuk është turmë, nuk është fluskë. Vetëm aq njerëz sa duhen për të kryer një punë SKAMi, aq njerëz do të përfshihen. Gjithashtu, SKAMi duke qenë së është egoist dhe kuller, nuk pranon të goditet në kokë me shufra gomash; shufrat janë për zonjat e mira, "të privilegjuara dhe të arsimuara" të klasës së mesme, që kanë konsideratë të lartë për besimin mallëngjyes se Babi dhe policët, në thelb, janë të mirë. Nëse një ditë SKAMi marshon, do të marshojë kundër fytyrës idiote dhe neveritëse të Presidentit; nëse një ditë SKAMi godet, do të godasë në errësirë, me një thikë tehçjatë.

SKAMi do të operojë gjithmonë në formë kriminale, dhe jo në formë të mosbindjes civile, pra, jo duke vepruar hapur kundër ligjit dhe duke shkuar në burg për të tërhequr vëmendje mbi një

padrejtësi. Këto taktika e pranojnë se sistemi përgjithësisht është i drejtë, dhe përdoren vetëm për të ndryshuar dhe çuar përpara ligje specifike. SKAMi e kundërshton sistemin në tërësi, pra vetë idenë e ligjit dhe qeverisë. SKAMi synon të rrënojë sistemin, dhe jo t'i fitojë disa të drejta brenda tij. Gjithashtu, si kuller dhe egoist që është, SKAMi nuk e ka për qëllim të hetojë dhe ndëshkojë. SKAMi përherë do të jetë tinëzare, dinake, e zgjuar (pavarësisht se SKAMi nuk do t'i mohojë vrasjet).

Shkatërrimet dhe vrasjet do të jenë të përzgjedhura dhe të kontrolluara. SKAMi është kundër protestave tollovitëse, të rrëmujshme, ku vetë protestuesit mund të lëndohen. SKAMi kurrë nuk do të nxisë, inkurajojë apo të marrë pjesë në trazira, apo në shkatërrime të pakontrolluara. Ftohtë, tinëzisht, SKAMi do ta joshi prenë e saj dhe do të lëvizi qetësisht për ta vlarë. Shkatërrimi nuk do të bëhet duke bllokuar rrugë që duhen për transportim ushqimesh dhe gjërash tjera esenciale, nuk do ta ndërpresë apo kontaminojë furnizimin me ujë, nuk do të bllokojë rrugë që nevojiten për auto-ambulanca apo që vështirësojnë funksionimin e spitaleve.

SKAMi do të vazhdojë të shkatërrojë, plaçkisë, godasë dhe vrasë deri në zhdukjen e sistemit të punës të bazuar në para dhe vendosjen e një sistemi të automatizimit të plotë, apo deri sa mjaftueshëm gra të bashkëpunojnë me SKAMin, dhe dhuna për të arritur qëllimet të mos jetë më e nevojshme, pra, deri sa mjaftueshëm gra ose të braktisin punën ose të fillojnë mospunën, plaçkitjen, braktisjen e burrave dhe refuzimin për t'ju bindur ligjeve të padrejta në një shoqëri vërtet të emancipuar. Shumë gra do të rreshtohen, por shumë të tjera, që i janë dorëzuar me kohë armikut, që janë mësuar aq shumë me kafshërinë, me mashkullsinë, që kanë pranuar cungimin dhe robërinë, dhe nuk dinë çfarë të bëjnë me lirinë e tyre, do të vazhdojnë të përulen dhe përdhosen, ashtu siç mbesin edhe fshatarët e fushave të orizit përherë fshatarë të fushave të orizit, teksa një regjim zëvendëson tjetrin. Ato më të

ndjeshmet, buzëvarura e të përqyrrosura, do të kundërshtojnë duke hedhur përtoke lodrat e leckat e enëve, por SKAMi do të vazhdojë presionin mbi to.

Një shoqëri tërësisht e automatizuar mund të arrihet shumë shpejt, në momentin që ka kërkesë publike. Një model i këtij sistemi tashmë ekziston, dhe do të duheshin vetëm pak javë dhe disa miliona krahë pune për ta realizuar atë. Edhe pse kjo punë nuk do të paguhet, të gjithë, me kënaqësinë më të madhe, do të japin kontributin e tyre në ndërtimin e një shoqërie automative; kjo shënon edhe fillimin e një epokë të re dhe fantastike, dhe një atmosferë feste do të mbretërojë gjatë gjithë procesit.

Të gjitha reformat e SKAMit do të jenë të mundura pas eliminimit të sistemit të parave dhe institucionalizmit të plotë të automatizmit; pa këto dyja, as të tjerat nuk mund të ndodhin; me këto dyja, të tjerat do të vijnë shumë shpejt. Qeveria automatikisht do të marrë fund. Automatizimi i plotë do ta bëjë të mundur që çdo grua të votojë mbi çdo çështje në formë elektronike nga shtëpia e saj. Meqenëse qeveria merret kryesisht me rregullimin e çështjeve ekonomike dhe me ligjet që kontrollojnë çështje krejtësisht private, eliminimi i sistemit të parave, dhe, rrjedhimisht, eliminimi i meshkujve që duan të ligjësojnë “moralin”, do të bëjë që të mos ketë më as për çfarë të votohet.

Me asgjësimin e parave, nuk do të ketë më nevojë as për të vrarë burra; ata do të ngelen pa të vetmen fuqi që kanë mbi femrat psikologjikisht të pavarura. Ata do t’u imponohen vetëm grave të përdhosura, që u pëlqen nënshtrimi. Pjesa tjetër e grave do të jenë të zëna duke u dhënë zgjidhje problemeve të fundit që duhen zgjidhur, para se të hartojnë agjendën e tyre të përjetshme dhe Utopinë — ato do të rishkruajnë programe të tilla arsimore që lejojnë formimin e lartë intelektual të miliona grave brenda pak muajve, formim ky që sot kërkon vite të tëra (kur qëllimi i arsimit është arsimi dhe jo mirëmbajtja e elitave intelektuale, kjo gjë është

lehtësisht e mundur); do të zgjidhin edhe problemin e sëmundjeve, pleqërisë dhe vdekshmërisë; do të bëjnë riplanifikimin e plotë të qyteteve dhe lagjeve ku jetojmë. Për një kohë të caktuar, shumë gra do të vazhdojnë të mendojnë se tërhiqen nga burrat, por kur ato të mësohen me shoqërinë e re femërore dhe të përfshihen në projektet e tyre, me kohë ato do të kuptojnë se sa i padobishëm dhe banal është mashkulli.

Ata pak burra që ngelin, do t'i shtyjnë jetët e tyre të mjera të droguar apo të pispillosur në drag, apo si spektatorë që bëjnë jetë të dorës së dytë, duke soditur pasivisht gratë e plotfuqizuara³ ose duke u shumuar nëpër kullota lopësh me lajkataret e tyre, ose duke vizituar qendrën më të afërt miqësore të vetëvrasjeve, ku në dhomat e gazit mund të vdesin, paqtë dhe pa dhimbje.

Para instalimit të automatizimit të plotë dhe zëvendësimit të meshkujve nga makineritë, mashkulli fillimisht duhet të jetë i dobishëm për femrën, t'u shërbejë tekave të saj, t'i rrij në këmbë para e mbrapa, t'i bindet urdhërave të saj, totalisht i nënshtruar, dhe të veprojë në harmoni të përkryer me vullnetin e saj, pra krejt e kundërta e realitetit të mbrapshtë dhe të degjeneruar që kemi sot, ku ata sillen me mospërfillje, dhe rëndojnë botën me praninë e tyre të neveritshme, vetëm se janë përkëdhelur masivisht nga gratë, nga miliona gra që u kanë rënë në gjunjë, si besimtare të devotshme që adhurojnë Viçin e Artë, ku ata sillen si qeni që lidh të zotin me zinxhir, kur në fakt, mashkulli, një hap larg të qenurit hyjneshtë drag, lumturohet pa masë kur sillet si klysh — kur prej tij nuk pritet asgjë thellësisht emocionale, me femrën që ka mbledhur veten dhe ka kontroll të plotë mbi të. Burrat racionalë kërkojnë të shtypen,

3. Çdo mashkull do të ketë mundësinë që në formë elektronike të sodisë jetën e një graje dhe çdo veprim të saj. Detyrimisht, gratë me mirësi do ta pranojnë këtë akt krejt të padëmshëm për to, si një nga mënyrat më njerëzore dhe më të dashura për t'i trajtuar këto qenie të gjymtuara dhe të gjora.

nëpërkëmben, shkilen e përdhosen, të trajtohen si qelbësira të ndyta, që të vërtetojnë sa të neveritshëm janë.

Burrat e sëmurë, joracionalë, që refuzojnë të shohin sa të neveritshëm janë, kur të shohin SKAMin që si ortek po bie mbi ta, nga frika do të kacavirren pas Mami të Madhe me Cica të Mëdha që Tunden, por Cikat nuk do t'i mbrojnë nga SKAMi; Mami e Madhe do t'i qepet pas Babit të Madh, i cili do të jetë strukur në një cep duke dhjerë brekët e tija të forta prej trimi. Nga ana tjetër, burrat e arsyeshëm nuk do të bëjnë rezistencë, nuk do të gjuajnë shkelma, por, të ulur këmbëkryq, të relaksuar, do ta shijojnë këtë lundrim mbi dallgën e madhe drejt fundosjes së tyre.

Përktheu: Doruntina Vinca

PAGË KUNDËR PUNËVE TË SHTËPISË

Silvia Federici

1974

*Ata thonë është dashuri. Ne themi është punë e papaguar.
Ata e quajnë ftohtësi seksuale. Ne e quajmë shmangie.
Çdo abort spontan është një aksident në punë.
Homoseksualiteti dhe heteroseksualiteti janë të dyja kushte
pune... por homoseksualiteti është kontrolli i punëtorëve
mbi prodhimin, dhe jo qëllimi i punës.
Buzëqesh më shumë? Fito më shumë. Asgjë nuk ka
më shumë forcë për të shkatërruar vetitë shëruese të
buzëqeshjes.
Neurozat, vetëvrasjet, deseksualizimi: sëmundje
profesionale të shtëpiakes.*

Shpeshherë, vështirësitë dhe paqartësitë që gratë shprehin kur diskutojnë pagën e punës shtëpiake, vijnë nga prirja për të reduktuar pagën në një gjësend, në një grusht me para, dhe jo në një çështje të trajtuar nga një këndvështrim politik. Dallimi mes këtyre dy qëndrimeve është jashtëzakonisht i madh. Të trajtosh pagën e punës shtëpiake si një send, dhe jo si një perspektivë politike, do të thotë ta ndash qëllimin e luftës tonë nga vetë lufta, dhe të mos e kuptosh rëndësinë që kjo luftë ka në çmitizimin dhe përmbysjen e rolit në të cilin shoqëria kapitaliste i ka kufizuar gratë.

Kur pagën për punë shtëpiake e shohim në këtë formë të thjeshtuar, fillojmë dhe pyesim veten: a thu ç'ndryshim do të sillnin në jetët tona pak para më shumë? Madje mund edhe të pajtohemi se për shumë gra që nuk kanë zgjidhje tjetër veç punës shtëpiake dhe martesës, kjo pagesë përbën goxha ndryshim. Por, për ato mes nesh që duket sikur kanë mundësi të tjera — karrierë profesionale, burra mendjehapur, jetë të organizuara në bashkësi, marrëdhënie gej ose një kombinim i gjithë këtyre mundësive — atëherë kjo pagesë nuk sjell aspak ndryshim. Pavarësia jonë ekonomike mendohet të jetë e mundur për shkak të këtyre mundësive, dhe

nuk do të donim kurrë të identifikoheshim si shtëpiake, përkundrazi, një fat i tillë do të ishte për ne, si me thënë, më keq se vdekja. Problemi me këtë qëndrim është se ne shtojmë një grusht para në imagjinatën tonë, dhe pyesim se a do të mund të përmirësohej kështu kjo jetë muti, pa e kuptuar se këto para nuk mund t'i fitojmë pa revolucionarizuar njëkohësisht — përgjatë përpjekjes tonë — të gjithë marrëdhëniet tona në familje dhe në shoqëri. Por, nëse e trajtojmë çështjen e pagës për punë shtëpiake prej një perspektive politike, do të kuptojmë se vetë lufta për pagë, do të prodhojë një revolucion në jetët tona dhe në pushtetin tonë social si gra. Është po ashtu e qartë se, nëse mendojmë se nuk kemi “nevojë” për këto para, kjo ndodh sepse i kemi pranuar format nëpërmjet të cilave ne prostituojmë trupin dhe mendjen tonë, vetëm për të përfituar një pjesë të këtyre parave që e zbusin këtë nevojë. Siç do të parashtrij në vijim, jo vetëm që paga e punës shtëpiake përbën një perspektivë revolucionare, por është *edhe e vetmja perspektivë revolucionare nga një pikëpamje feministe, dhe përfundimisht për gjithë klasën punëtore.*

“Një punë dashurie”

Është me rëndësi të theksohet se kur flasim për punë shtëpiake, nuk flasim për një punë si gjithë të tjerat, por, flasim për manipulimin më të thellë, dhunën më të përhapur dhe tinëzare që kapitalizmi ka ushtruar ndaj çdo segmenti të klasës punëtore. Është e vërtetë që nën kapitalizëm punëtorët manipulohen dhe shfrytëzohen, ndërkohë që marrëdhënia e tyre me kapitalin është krejt e mjegullt. Paga shihet si një shpërblim i drejtë: ti merr pagë për punën, prandaj ti dhe shefi yt jeni të barabartë; por, në realitet, pas pagës nuk qëndron vetëm shpërblimi për punën, por e gjithë puna e papaguar që çon drejt rritjes së fitimit. Paga, megjithatë, të njeh si punëtor dhe të jep mundësinë të negociosh dhe të bësh përpjekje rreth dhe kundër kushteve dhe sasisë së pagës, si edhe

kushteve dhe sasisë së punës që bën. Të kesh pagë do të thotë të jesh pjesë e një kontrate sociale, përmbajtja e së cilës nuk vihet në diskutim: ti punon jo se të pëlqen apo se të vjen natyrshëm të punosh, por ngaqë puna është i vetmi kusht nën të cilin të lejohet të jetosh. Por ama, sado i shfrytëzuar që të jesh, *ti nuk je puna që bën*. Sot je postier, nesër shofer taksie. E rëndësishme, mbi të gjitha, mbetet sa punë bën dhe sa para merr.

Në rastin e punës shtëpiake, situata është cilësisht ndryshe. Ndryshimi qëndron në faktin se grave jo vetëm se u është imponuar puna shtëpiake, por kjo punë është cilësuar edhe si një tipar i pandashëm i fizikut dhe personalitetit femëror, një nevojë dhe aspiratë që mendohet të burojë nga thellësitë e karakterit tonë femëror. U desh që kjo punë të shndërrohej në një tipar të lindur, dhe jo të njihej si pjesë e një kontrate sociale, sipas skemës më të hershme të kapitalit për gratë, që puna e tyre shtëpiake të mbetej gjithmonë e papaguar. Që të pranohet punë të papaguar, kapitalit iu desh të na bindte se kjo punë është një aktivitet i natyrshëm, i pashmangshëm dhe madje edhe shpirtërisht përmbushës. Kushtet e punës së papaguar rezultuan arma më e fuqishme në përforcimin e mendimit të përhapur se *puna shtëpiake nuk është punë*, duke mos u lejuar kështu grave mundësinë për të kundërshtuar këtë punë, përveçse në sherrat e vogla brenda hapësirës private dhomë-kuzhinë, që përqeshen nga të gjithë, duke e përulur kështu protagonisten e këtij kundërshtimi. Ne ngajmë si shtriga që vetëm ankohe mi, dhe jo si punëtore që luftojmë për të drejta.

Aq e natyrshme është të jesh shtëpiake, sa duhen njëzet vite socializim — një specializim i përditshëm profesional që kryhet nga nëna e papaguar — për ta përgatitur një vajzë për këtë rol, për ta bindur se burri dhe fëmijët janë gjëja më e mirë që mund të presë nga jeta. Megjithatë, zor se ia dalim me sukses. Sado të mirëtrajnuara të jemi, të pakta janë ato gra të cilat nuk ndihen

të mashtruara, kur, pasi kanë kaluar ditët e nusërimit, e gjejnë veten pranë enëve të palara. Disa prej nesh akoma rrojnë me iluzionin se martohemi me dashuri. Shumë prej nesh e pranojnë se martohemi për para dhe siguri; por, ka ardhur koha ta kemi të qartë se, ndërkohë që ka shumë pak dashuri dhe para në këtë mes, punët që na presin nuk kanë fund. Prandaj gratë më të moshuara na thonë: “Shijojë lirinë sa e ke, bli çfarë të duash sot...”. Por, fatkeqësisht, është e pamundur të shijojmë çfarëdolloj lirie nëse, që nga ditët e para të jetës, na mësojnë të jemi të urta, të nënshtruara dhe të varura, dhe mbi të gjitha, të gatshme të *sakrifikojmë vetveten*, e madje edhe të ndiejmë kënaqësi nga kjo. Nëse nuk të pëlqen, ky është problemi yt, dështimi yt, ndjenja jote e fajit, abornmaliteti yt.

Duhet ta pranojmë se kapitali ka arritur me sukses ta fshehë më së miri punën tonë. Ai ka krijuar një kryevepër të vërtetë në kurriz të grave. Duke i mohuar punës shtëpiake një pagë, dhe duke e shndërruar atë në një akt dashurie, kapitali ka vrarë shumë zogj me një gur. Së pari, ka përfitur gjithë atë punë, pothuajse falas, dhe ka siguruar që gratë, në vend se të ngrihen kundër, ta duan këtë punë si gjëja më e mirë në jetë (fjalët magjike: “Po, e dashur, ti je grua e vërtetë”). Njëkohësisht, e ka disiplinuar punëtorin burrë, duke e bërë gruan e *tij* të varur nga *puna* dhe *paga e tij* dhe i ka ngritur kështu atij një kurth brenda këtij disiplinimi, duke i dhënë një shërbëtores, pasi ai ka kaluar orë të gjata pune në fasoneri apo në zyrë. Në fakt, roli ynë si gra është të jemi të papaguara por të lumtura, dhe, mbi të gjitha, shërbëtores të dashura të “klasës punëtores”, pra të asaj shtrese proletariati të cilës kapitali është detyruar t’i jap më shumë pushtet në shoqëri. Ashtu siç zoti krijoi Evën për t’i dhënë kënaqësi Adamit, ashtu edhe kapitali krijoi shtëpiaket për t’u shërbyer fizikisht, emocionalisht dhe seksualisht punëtorëve burra — t’i rrisë fëmijët e *tij*, t’i arnojë çorapet e *tij*, t’ia përkëdhelë egon e nëpërkëmbur

nga puna dhe nga marrëdhëniet sociale (thelbi i të cilave është vetmia) që kapitali ka krijuar për të. Është pikërisht kjo shkrirje krejt e veçantë e punës fizike, emocionale dhe seksuale, pjesë e rolit që gratë kryejnë për kapitalin, që i japin asaj karakterin e veçantë të shërbyeses, gruas shtëpiake, dhe që e bëjnë punën e saj aq të rëndë, dhe njëkohësisht, aq të padukshme. Nuk është rastësi që shumica e burrave mendojnë për martesë vetëm kur gjejnë punë. Kjo ndodh jo vetëm sepse martesë bëhet ekonomikisht e përbalueshme, por sepse të kesh dikë në shtëpi që kujdeset për ty është i vetmi kusht që të mos luash mendsh, pas një dite të kaluar para linjës së montimit, ose mbi tavolinën e zyrës. Çdo grua e di se kjo është detyra dhe obligimi i saj, si një grua e vërtetë, dhe si kontribut për një martesë “për së mbari”. Edhe në këto raste, sa më e varfër familja, aq më i madh është skllavërimi i gruas, dhe jo thjesht për shkak të situatës financiare. Në fakt, kapitali ka një politikë të dyfishtë, një për klasën e mesme, dhe tjetrën për familjen proletare. Nuk është rastësi edhe që maçizmin më të egër e gjejmë tek familjet e klasës punëtore: sa më shumë goditje që merr një burrë në vendin e punës, aq më shumë goditje duron gruaja e tij, dhe aq më shumë i lejohet atij të shërojë egon në kurriz të gruas së tij. Ti e rreh gruan dhe ia nxjerr asaj inatin kur je i mërzhitur ose i sfillitur nga puna, ose kur ndihesh i gjunjësuar nga disfatat (të shkosh në minierë është në vetvete një disfatë). Sa më shumë nëpërkëmbet e urdhërohet një burrë, aq më shumë ai urdhëron. Shtëpia e një burri është kështjella e tij... dhe gruaja e tij duhet të mësojë të heshtë kur ai ka varur turinj të, t'i kthejë humorin kur ai ndihet i thyer dhe mallkon botën, të kthehet në krahun tjetër në krevat kur ai thotë “Jam shumë i lodhur sonte”; ose kur bën dashuri me ngut, siç tha njëherë një grua, “le ta fusë më mirë në një kavanoz me majonez”. (Gratë gjithmonë kanë gjetur mënyra për t'i kundërshtuar këto gjëra, ose për t'u hakmarrë, por gjithmonë brenda privatësisë së mureve të shtëpisë. Pyetja që shtrohet,

në këtë pikë, është si ta nxjerrësh këtë luftë prej kuzhinës dhe dhomës së gjumit, në rrugë).

Kjo farsë, që mban emrin dashuri dhe martesë, na prek të gjithave, edhe kur nuk jemi të martuara, sepse *kur puna e shtëpisë shndërrohet në një gjë të natyrshme dhe seksuale*, kur shndërrohet në një tipar femëror, të gjitha ne si femra karakterizohemi nga kjo punë. Kur bën diçka që shihet si e natyrshme, atëherë pritet që çdo grua ta bëjë dhe ta pëlqejë këtë gjë — përfshirë edhe gratë që gëzojnë status shoqëror që nuk i detyron të bëjnë punë të tilla (burrat e tyre kanë para për të paguar shërbyese, psikologë dhe forma të tjera relaksimi dhe argëtimi). Ne mund të mos jemi në shërbim të një burri të caktuar, por ne jemi në një marrëdhënie shërbimi kundrejt gjithë botës mashkullore. Kjo është arsyeja pse të quhesh femër është një përçmim, një gjë kaq përulëse. (Çdo burrë, pavarësisht a është burri yt, biletashitësi apo shefi në punë, mendon se ka të drejtë të të pyes “Oj zemër, si e ke hallin, pse nuk buzëqesh?”)

Perspektiva revolucionare

Duke u nisur nga kjo analizë mund të shohim se kërkesa e pagës për punë shtëpiake ka implikime revolucionare. *Me këtë kërkesë i jepet fund natyrës tonë dhe lufta jonë lind, sepse të duash thjesht pagë për punë shtëpiake do të thotë të refuzosh këtë punë si shprehje e natyrës sonë*, dhe rrjedhimisht të refuzosh pikërisht rolin femëror që kapitali ka shpikur për ne.

Vet akti i të kërkuarit pagë për punën shtëpiake i lëkund pritshmëritë që shoqëria ka nga ne, pritshmëri — thelbi i formimit tonë — që janë të gjitha në funksion të kushteve të papaguara në shtëpi. Në këtë kuptim, është absurde të krahasosh përpjekjen e grave për pagë, me përpjekjen e burrave për pagë më të lartë në një fabrikë. Rrogëtari i cili kërkon pagë më të lartë e sfidon vërtetë rolin e tij, por mbetet brenda tij. Kur ne luftojmë për pagë,

ne luftojmë qartazi dhe drejtpërdrejt kundër rolit tonë shoqëror. Në të njëjtën formë, ekziston një dallim cilësor mes përpjekjes së një rrogëtari, me përpjekjen e një skllavi për *një pagë kundër atij skllavërimi*. Megjithatë, që ta kemi të qartë, përpjekja jonë për një pagë nuk është njëkohësisht përpjekje për t'u bërë pjesë e marrëdhënieve kapitaliste, sepse ne kurrë nuk kemi qenë jashtë tyre. Përpjekja jonë është ta zhbëjmë planin e kapitalit për gratë, që në thelb ka paracaktuar ndarjen e punës dhe pushtetit shoqëror brenda klasës punëtore, ndarje kjo që i ka mundësuar kapitalit të ruajë dhe të mbajë pushtetin. Paga për punën shtëpiake, atëherë, është një kërkesë revolucionare, jo sepse në vetvete arrin ta shkatërrojë kapitalin, por se e sulmon dhe e *detyron atë* të rindërtojë marrëdhënie sociale në kushte më të favorshme për ne, dhe rrjedhimisht *në kushte më të favorshme për barazinë e klasës*. Në fakt, kërkesa e pagës për punë shtëpiake nuk do të thotë se nëse paguhemi, do të vazhdojmë ta bëjmë këtë punë. Është pikërisht e kundërta. Kur themi se duam para për punë shtëpiake, ky është vetëm hapi i parë drejt refuzimit për ta bërë këtë punë. Kërkesa për pagë e bën punën tonë të dukshme, dhe është kushti më i domosdoshëm për ta kundërshtuar këtë punë në dy plane: si refuzim i punëve shtëpiake, por edhe refuzim i karakterizimit tinëzar të kësaj pune si diçka feminine.

Ndaj të gjitha akuzave të “ekonomizimit”, duhet të kujtojmë se *paratë janë kapital, pra pushtet për të zotëruar punën*. Prandaj, duke i ripërvetësuar këto para që janë fryt i punës sonë — punës së nënave dhe gjysheve tona — në të njëjtën kohë e godasim fuqinë e kapitalit për të urdhëruar punë të detyruar nga ne. Për më tepër, nuk duhet ta nënvlerësojmë forcën që ka paga për të çmitizuar aspektin tonë femëror dhe pahtësimin e punës sonë — punës tonë femërore — pasi, fundja, mungesa e pagës përmban në vete fuqinë për të na karakterizuar dhe për ta fshehur punën tonë. Të kërkojë pagë për punët e shtëpisë do të thotë të vësh në dukje

që mendjet, trupat dhe emocionet tona, janë tjetërsuar në shërbim të një funksioni të veçantë, brenda një funksioni të veçantë, dhe më pas na janë servitur si modeli i vetëm që duhet ndjekur nëse duam të pranojemi si gra në këtë shoqëri.

Të themi se duam pagë për punët e shtëpisë, do të thotë të ekspozojmë faktin se punët e shtëpisë kanë vlerë monetare për kapitalin, se kapitali ka akumuluar dhe akumulon para për faktin se ne gatuajmë, buzëqeshim dhe qihemi. Njëkohësisht, tregon edhe se si ne kemi gatuan, kemi buzëqeshur dhe jemi qirë gjatë gjithë këtyre viteve, jo vetëm se kështu ne bëjmë një jetë më të lehtë se të tjerët, por sepse nuk kishim asnjë rrugëdalje tjetër. Fytyrat tona janë shtrembëruar nga buzëqeshja, ndjenjat tona janë tretur duke dhënë dashuri, mbiseksualizimi ynë i tepërt na ka deseksualizuar krejtësisht.

Paga për punët e shtëpisë është vetëm fillimi, por mesazhi është i qartë: *nga sot e tutje duhet të na paguajnë, sepse ne si femra nuk garantojmë më asgjë*. Duam që puna të quhet punë, që të mund të arrijmë një ditë të rizbulojmë se çfarë është dashuria për ne, dhe të krijojmë, për herë të parë, atë që do të jetë seksualiteti ynë. Sa i përket punës, ne mund të kërkojmë jo vetëm një pagë, por shumë paga, sepse na kanë detyruar të bëjmë shumë punë njëherësh. Ne jemi shërbyese shtëpiake, prostituta, infermiere, psikologe; ky është thelbi i bashkëshortes “heroike” që kremtohet në “Ditën e Nënës”. Ne themi: mjaft festuat shfrytëzimin tonë, gjasme heroizmin tonë. Nga sot e tutje, duam para për punët që bëjmë. Kështu do të mund t’i refuzojmë disa prej tyre, dhe, përfundimisht, të gjitha. Parë kështu, nuk ka asgjë më të dobishme sesa të tregojmë se si virtytet tona femërore kanë një vlerë të llogaritshme në para, që deri sot i kanë shërbyer kapitalit i cili rritej në përpjestim të zhdrejtë me shtypjen tonë; dhe, nga sot e tutje do të jenë vetëm *në shërbimin tonë*, kundër kapitalit, dhe në përputhje me forcën tonë të organizimit.

Lufta për shërbime sociale

Kjo është perspektiva më radikale që mund të përqafojmë, se edhe nëse kërkojmë shumë, si çerdhe, paga të barabarta, lavanderi falas, prapë nuk do të arrijmë kurrë ndryshime thelbësore, po nuk e goditëm ashpër, deri në rrënjë, rolin tonë të përshkruar femëror. Lufta jonë për shërbime sociale, pra për kushte më të mira pune, do të jetë gjithmonë e gjysmake, nëse fillimisht nuk e përkufizojmë punën tonë si punë. Në qoftë se nuk luftojmë për tërësinë e saj, atëherë as fitore të vogla nuk do të mund të kemi. Lavanderia falas nuk ndryshon asgjë nëse ne nuk luftojmë faktin se dashuria që ne japim, rëndon mbi punën tonë të pandërprerë, që çdo ditë gjymton trupin tonë, seksualitetin tonë dhe marrëdhëniet tona shoqërore; nëse nuk i japim fund nevojës sonë të shantazhueshme për të dhënë dhe për të marrë dashuri, që tashmë ka marrë formën e një detyrimi pune, dhe si e tillë është kthyer kundër nesh, dhe na bën të ndiejmë mllaf ndaj burrave, fëmijëve dhe miqve tanë, dhe njëkohësisht të kemi edhe ndjenja faji për këtë mllaf. Ky rol nuk ndryshon as duke marrë një punë të dytë, dëshmuar nga vite të tëra pune jashtë shtëpisë. Puna e dytë jo vetëm që rrit shfrytëzimin tonë, por edhe e riprodhon rolin tonë në forma të ndryshme. Ngado që kthejmë kokën, shohim se punët që kryejnë gratë, janë vetëm zgjatim i kushteve të amvisërisë, në të gjitha nuancat e saj. Pra, jo vetëm që ne bëhemi infermiere, shërbyese, mësuese, sekretare — funksione këto për të cilat na kanë mirëtrajnuar brenda shtëpisë — por njëkohësisht hasim në të njëjtat shtrëngesa që pengojnë luftën tonë brenda shtëpisë: izolim, jetë njerëzish që varen nga ne, ose pamundësi për të dalluar se ku fillon dhe ku mbaron puna jonë, ku mbaron puna dhe ku fillojnë dëshirat tona. T'i bësh kafe shefit dhe të dëgjosh hallet e martesës së tij, është pjesë e punës sekretariale apo një nder personal? Fakti që jemi të detyruara të vrasim mendjen për pamjen tonë, është kusht pune apo vanitet femëror? (Deri vonë stjuardesat e kompanive ajrore në Shtetet e

Bashkuara të Amerikës peshoheshin rregullisht dhe duhej të mbanin vazhdimisht dietë, torturë kjo që e njohin të gjitha gratë, nga frika se mos pushoheshin nga puna). Siç thuhet shpesh, sigurisht në rastet kur nevojat e tregut të punës e kërkojnë praninë e gruas, “një grua mund të bëjë çdo punë pa e humbur feminitetin e saj”. Pra, pavarësisht se çfarë pune bën, ti ngelesh thjesht një pihd.

Sa i përket propozimit të shoqërizimit dhe kolektivizimit të punëve shtëpiake, mjaftojnë dy shembuj për të kuptuar dallimin mes këtyre alternativave dhe perspektivës sonë. Po, është alternativë të ndërtojmë çerdhe siç duam ne dhe t’i kërkojmë Shtetit të paguajë, por është krejt tjetër gjë t’ia dorëzojmë Shtetit fëmijët tanë dhe t’i kërkojmë atij t’i kontrollojë, t’i edukojë, t’u mësojë himnin e flamurit, jo për pesë orë, po për pesëmbëdhjetë a njëzetekatër orë. Po, është alternativë që ne bashkërisht të organizojmë mënyrën se si duam të ushqehemi (vetëm, në grupe, etj.) dhe më pas t’i kërkojmë Shtetit të na paguajë ushqimin, dhe është krejt e kundërta nëse kërkojmë nga Shteti të organizojë vaktet tona. Në rastin e parë, ne rimarrim një trohë kontrolli mbi jetët tona, në rastin e dytë, ne ia dorëzojmë Shtetit kontrollin mbi ne.

Lufta kundër punëve të shtëpisë

Disa gra pyesin: çfarë ndikimi do të ketë paga për punët shtëpiake në sjelljen e burrave tanë? A nuk pritet nga ne që të kryejmë punët e njëjta, madje të bëjmë edhe më shumë, nga momenti që paguhemi? Këto gra duhet të kuptojnë se burrat presin kaq shumë nga ne, vetëm se ne bëjmë punë të papaguar, duke supozuar se kjo është “punë grash” që nuk kërkon shumë mund. Burrat janë në gjendje të pranojnë shërbimet tona dhe t’i gëzojnë ato, me mendimin se punët e shtëpisë ne i bëjmë me lehtësi dhe kënaqësi, për hir të dashurisë. “Je me fat që ke gjetur një burrë si unë”, thonë ata, duke pritur që ne, në fakt, të jemi edhe mirënjohëse, sepse martesja dhe bashkëjetesa në çift na ka dhënë

mundësinë të përmbushim rolin tonë si gra (pra t'u shërbejmë atyre). Vetëm atëherë kur burrat do të arrijnë ta shohin punën tonë si punë — dashurinë tonë si punë — dhe mbi të gjitha *vendosmërinë tonë për t'i refuzuar që të dyja*, vetëm atëherë ata do të ndryshojnë qëndrimin ndaj nesh. Kur qindra e mijëra gra të dalin në rrugë për të thënë se të pastrosh çdo ditë, të jesh emocionalisht e hapur dhe të kryesh akte seksuale me forcë nga frika se mund të humbasësh punën, se e gjithë kjo është një punë, e vështirë, e urryer, që po na e çon jetën dëm, vetëm atëherë burrat do të tremben dhe do të ndihen të dobët. Por kjo është gjëja më e mirë që mund të ndodhë edhe nga këndvështrimi i tyre, sepse duke e ekspozuar formën se si kapitali na ka mbajtur të ndarë (kapitali i ka disiplinuar ata përmes nesh dhe ne përmes tyre — secilin prej nesh, kundër njëri-tjetrit), ne — patericat, skllavet, zinxhirët e tyre — do t'i hapim udhë edhe procesit të çlirimit të tyre. Kështu, paga për punët e shtëpisë do të jetë shumë më edukative sesa orvatjet tona për të dëshmuar se ne mund të bëjmë të njëjtat punë me burrat, dhe t'i bëjmë po aq mirë sa ta. Këtë orvatje me vlerë ia kemi lënë “gruas në karrierë”, gruas që shpëton veten nga shtypja, jo përmes pushtetit të bashkimit dhe përpjekjeve, por përmes fuqisë së pronarit dhe pushtetit për të shtypur, sidomos gra të tjera. Ne nuk kemi pse të dëshmojmë se mund të “kapërcejmë hendekun e jakave blu”. Shumë prej nesh e kemi kapërcyer këtë hendek shumë kohë më parë, duke zbuluar se kominoshet nuk të japin më shumë fuqi se përparësja; në fakt, të bëjnë edhe më të dobët po i veshe sipër njëra-tjetrës, dhe nuk kemi më as kohë e as energji të gjejmë forcën për t'i luftuar. *Ne duhet ta dëshmojmë vetëm kapacitetin tonë për ta bërë të dukshme punën tonë, atë çfarë kapitali ushtron mbi ne, dhe forcën tonë për ta luftuar.*

Fatkeqësisht, shumë gra, veçanërisht gratë beqare, kanë frikë nga perspektiva e rrogave për punët e shtëpisë, sepse s'duan të identifikohen as edhe një çast të vetëm si gra shtëpiake.

Ato e dinë që nuk ka pozitë më të pafuqishme në shoqëri se kjo, dhe nuk duan ta pranojnë se edhe ato janë gra të shtëpisë. Kjo është pikërisht dobësia e tyre, një dobësi e cila mbahet gjallë dhe përjetësohet nëpërmjet mungesës së identifikimit me të. Ne duam dhe duhet të themi se të gjitha jemi shtëpiake, të gjitha jemi prostituta dhe të gjitha jemi lezbike. Përderisa ne nuk e pranojmë skllavërinë tonë, ne as nuk mund ta pranojmë luftën tonë kundër saj; pra, kur ne mendojmë se jemi më mirë dhe më ndryshe sesa një amvise, ne huazojmë logjikën e pronarit, një logjikë kjo e ndarjes, dhe, detyrimisht, logjikë e skllavërisë. Të gjitha jemi gra shtëpiake, sepse pavarësisht se ku jemi, gjithmonë mund të llogarisin në më shumë punë nga ne, në më shumë frikë nga ana jonë për të shtruar kërkesat tona, dhe në më pak presion tek ata për para, me shpresën se ne e kemi mendjen diku tjetër, te ai burri i të tashmes dhe i të ardhmes tonë që “do të kujdeset për ne”.

Ne na gënjen mendja se mund t’u shpëtojmë punëve të shtëpisë. Por, sa prej nesh, pavarësisht se punojnë jashtë shtëpisë, kanë shpëtuar nga këto punë? A mundemi vërtetë lehtësisht ta shpërfillimin idenë e të jetuarit me një burrë? Po sikur te ngelemi pa punë? Po kur të fillojë plakja dhe fillojmë e humbasim fuqinë që rinia (produktiviteti) dhe pamja tërheqëse (produktiviteti femëror) na ofrojnë sot? Po fëmijët? A do të pendohemi ndonjëherë që kemi zgjedhur të mos kemi fëmijë, madje duke mos pasur as mundësinë ta shtrojmë realisht këtë pyetje? A mund t’i lejojmë vetes marrëdhënie homoseksuale? A jemi të gatshme të paguajmë çmimin e mundshëm të izolimit dhe përjashtimit? A mund t’i përballojmë vërtetë marrëdhëniet me burrat?

Çështja është kjo: pse kemi vetëm këto alternativa dhe cila është ajo betejë që do të mund të na çojë përtej?

Përktheu: Vasilika Laçi

TEORIA E GRUAS SË SËMURË

Johanna Hedva

2016

1.

Diku nga fundi i vitit 2014, po vuaja e shtrirë nga sëmundja ime kronike e cila, çdo 12 apo 18 muaj, përkeqësohet aq shumë sa, për 5 muaj rresht secilën herë, më bën të paaftë të eci, t'i jap makinës, të punoj, ndonjëherë ma bën të pamundur edhe të flas apo ta kuptoj gjuhën, të lahem pa ndihmën e askujt, apo thjesht të ngrihem nga shtrati. Ky lëngim rastisi në të njëjtën kohë me protestat Black Lives Matter, në të cilat do të isha përfshirë përditë, po të kisha pasur mundësi. Jetoj vetëm një rrugë larg parkut MacArthur në Los Angeles, lagje kjo kryesisht e banuar nga latinët, dhe lagje që njihet si vend ku shumë imigrantë fillojnë jetën e tyre amerikane. Pra, jo rastësisht, ky park është një nga hapësirat më aktive të protestave në qytet.

Dëgjova zërat e marshimit që jehonin deri poshtë dritares sime. Në shenjë solidariteti, ashtu siç isha shtrirë, ngrita grushtin tim prej një gruaje të sëmurë.

Fillova të mendoj se cilat janë format e protestimit për njerëzit e sëmurë — mendova se si shumë nga ata për të cilët lëvizja Black Lives Matter çon kaq shumë peshë, nuk janë as në gjendje të marrin pjesë në marshim, sepse liria e tyre është e privuar nga puna, nga kërcënimi se mund të pushohen nga puna nëse marrin pjesë në marshim, apo se janë vërtetë në burg, dhe, natyrisht, se kanë frikë nga dhuna dhe brutaliteti policor — por, edhe si pasojë e sëmundjeve ose aftësive ndryshe, apo sepse kujdesen për dikë të sëmurë ose me aftësi ndryshe.

Mendova për të gjithë trupat e tjerë të padukshëm, me grushtat e tyre të ngritur, të vetmuar dhe larg syve tanë.

Nëse marrim përkufizimin e Hannah Arendt mbi politikën, përkufizim ky që vazhdon të dominojë diskursin e përditshëm, si çfarëdolloj akti që kryhet në publik, atëherë ne duhet të përballemi me implikimet e asaj çfarë kjo tezë përjashton. Nëse të qenurit

prezent në publik është ajo që kërkohet për të qenë politik, atëherë grupe të tëra të popullsisë mund të reduktohen në *apolitike* — vetëm për faktin se nuk janë fizikisht të aftë të nxjerrin trupat e tyre në rrugë.

Gjatë studimeve të mia të larta, Arendt adhurohej si zot, dhe kisha mësuar të mendoja se përkufizimi i saj i politikës ishte radikalisht çlirues. Jam e vetëdijshme se ndoshta dikur mund të ketë qenë, në mënyrën dhe kohën e vet (fundi i viteve '50): me një lëvizje ajo kishte hedhur poshtë nevojën për infrastrukturën ligjore, për procesin demokratik të votimit, për mbështetjen tek individët që kanë fituar pushtetin për të ndikuar politikën, pra ajo hodhi poshtë nevojën për politikë. Të gjitha këto ishin të nevojshme që një veprim të konsiderohej dhe të ishte dukshëm politik. Jo, thotë Arendt, mjafton të nxjerrësh trupin tënd në rrugë, dhe bam: je politik.

Gjithsesi, kjo premisë ka dy dobësi. E para është se ajo bazohet tek “publikja”, e kundërta e së cilës është privatja, pra është një qasje binare ndaj hapësirës së dukshme dhe asaj të padukshme. Kështu, çdo gjë që ndodh në privat është jo-politike. Për shembull, nëse e dhuron gruan në privat, nuk ka asnjë problem. Nëse dërgon email-e private që përmbajnë fyerje raciste, disi nuk quhesh racist, se ato nuk i janë “drejtuar publikut”. Shqetësimi i Arendt ishte se nëse çdo gjë konsiderohet politike, asgjë nuk është, dhe kjo është arsyeja pse ajo e ndau hapësirën në politike dhe jo-politike. Për hir të këtij shqetësimi, ajo sakrifikoi shumë grupe njerëzish, dhe kontribuoi në reduktimin e tyre të vazhdueshëm në grupe politikisht të padukshme dhe të parëndësishme. Ajo zgjodhi t'i mbante ata jashtë sferës publike. Unë nuk jam e para që e kritikoj Arendt për këtë gjë. Dështimi i politikës së Arendt doli në pah menjëherë, gjatë aktivizimit për të drejtat civile dhe feminizmit të viteve '60 dhe '70. “Personalja është politike” mund të lexohet edhe si “privatja është politike”. Pa dyshim, çdo gjë që bën në privat është edhe politike: me kë bën seks, sa gjatë rri në dush, a ke akses në ujë të pastër për dush, e kështu me radhë.

Por, ka edhe një problem tjetër. Siç thekson edhe Judith Butler gjatë ligjeratës së saj *Vulnerability and Resistance* (Brishtësia dhe rezistenca) të mbajtur në vitin 2015, Arendt nuk arriti të jap llogari se kush lejohet në hapësirën publike, si dhe *kush është në krye të publikes*. Ose, më konkretisht, *kush vendos se kush merr pjesë*. Butler thotë se demonstratat publike e kanë gjithmonë një të vërtetë: policia ose është aty, ose është rrugës. Ka një ngjashmëri të llahtarshme kjo me kontekstin e çështjes Black Lives Matter. Dhuna e pashmangshme në një demonstratë, e sidomos në një demonstratë që lindi për të insistuar mbi rëndësinë e trupave të cilët dhunshmërisht nuk kanë marrë përkujdes, siguron që një numër i madh njerëzish nuk do të dalin, sepse nuk munden. Shto këtu edhe sëmundjet fizike dhe mendore, si dhe aftësitë ndryshe që i mbajnë njerëzit në shtrat dhe në shtëpi, dhe përballemi me faktin se shumë nga ata për të cilët këto protesta ndodhin, nuk kanë mundësi as të marrin pjesë në to, pra nuk arrijnë të jenë të dukshëm si aktivistë politikë.

Gjatë javëve kur ndodhën protestat, hasa në një postim të Tumblr që thoshte pak a shumë: “Respekt për të gjithë ata me nevoja ndryshe, njerëz të sëmurë, ata që luftojnë me çrregullime të stresit post-traumatik, me ankthin, etj., dhe që nuk mund të protestojnë në rrugë, sonte, këtu me ne. Zërat tuaj dëgjohen, çmohen, dhe janë me ne.” Zemër. Riblog.

2.

Unë kam sëmundje kronike. Për ata që nuk e dinë çfarë do të thotë sëmundje kronike, më lejoni t’ju sqaroj: fjala “kronike” vjen nga greqishtja “khronos”, e latinizuar si “chronos”, që do të thotë “e kohës” (mendo “kronologji”), dhe në mënyrë të veçantë “një jetë”. Domethënë, një sëmundje kronike është një sëmundje që zgjat një jetë. Me fjalë të tjera, nuk ka përmirësim. Nuk ka shërim.

Mendo edhe peshën e kohës: ti jeton me sëmundjen çdo ditë. Ndodh shumë rrallë që përhumbem, sikur diçka të më ketë

shkukur nga kjo botë, dhe të kuptoj më vonë se për pak minuta, ose pak orë të çmuara, nuk e kam pasur mendjen te sëmundjet e mia. Këto momente të bekuara të harresës janë për mua përjetimi më i përafërt me mrekullinë. Kur ke sëmundje kronike, jeta reduktohet në një kursim pafund energjie. Çdo lëvizje të konsumon: të dalësh nga shtrati, të gatuar për veten, të vishesh, t'i përgjigjesh një email-i. Ata që nuk kanë sëmundje kronike, mund të shpenzojnë e të shpenzojnë pa asnjë pasojë: atyre nuk u kushton asgjë. Ne që kemi fonde të limituara duhet të kursejmë, burimet tona janë të kufizuara: shpesh na mbarojnë edhe para drekës.

Kam filluar të mendoj ndryshe për sëmundjen kronike.

Ann Cvetkovich shkruan: “Çka nëse depresioni, të paktën në Amerikë, do të mund të gjurmohej, jo tek disbalancat hormonale, por te e kaluara e historive të kolonializmit, gjenocidit, skllavërisë, përjashtimit ligjor, segregimit të përditshëm dhe izolimit që na ka përndjekur gjatë gjithë jetës?” Dua të zëvendësoj këtu fjalën “depresion”, me “sëmundje mendore”. Cvetkovich shkruan më tutje: “Një pjesë e madhe e literaturës mjekësore është e prirur të supozojë se subjekti [që trajton] është një i bardhë nga klasat e mesme, për të cilin, fakti që nuk ndihet mirë ngelet një mister sepse nuk përputhet me jetën ku privilegji dhe rehatia bëjnë që gjërat të duken mirë në sipërfaqe.” Me fjalë të tjera, mirëqenia siç trajtohet në Amerikë sot, është një ide e bardhë dhe e kamur.

Me lejoni të citoj Starhawk, në parathënien e botimit të ri të librit të saj të vitit 1982, *Dreaming the Dark* (Duke ëndërruar errësirën): “Psikologët kanë krijuar mitin se ekziston, atje, diku larg, një gjendje shëndetësore që konsiderohet normë, pra shumica e njerëzve supozohet të gëzojnë këtë gjendje, ndërsa ata që janë anksioz, depresivë, neurotikë, të stresuar, ose përgjithësisht të palumtur, janë me çrregullime”. Unë do ta zëvendësoja fjalën “psikologë” me “superioritet i të bardhëve”, “mjekë”, “shef/shefe”, “neoliberalizëm”, “heteronormativitet”, dhe “Amerikë”.

Viteve të fundit janë botuar disa shkrime mbi trajtimin e dhimbjes “femërore”, ose në fakt, se si nuk trajtohet aq seriozisht sa ajo e burrave nga klinikat e urgjencës, mjekët, specialistët, kompanitë e sigurimeve, familjet, bashkëshortët, shokët, dhe shoqëria në përgjithësi. Në një artikull të botuar nga revista *The Atlantic*, me titull “Si e marrin mjekët më pak seriozisht dhimbjen e grave?”, autori shkruan mbi eksperiencën e së shoqes dhe pritjen e stërzgjatur në urgjencë, përpara se asaj t’i ofrohej shërbimi mjekësor që situata e saj kërkonte (ajo vuante nga një përdredhje e vezoreve, ku një cisti i vezoreve rritet aq shumë sa bie dhe përdredh tubin falopian). “Në nivel kombëtar, burrat presin mesatarisht 49 minuta përpara se të marrin qetësues për dhimbje akute abdominale. Për të njejtën gjë, gratë presin mesatarisht 65 minuta. Rachel-i priti diku mes 90 minutave dhe 2 orëve”, shkruan ai. Në fund të ekzaminimit, Rachel kishte pritur pothuajse 15 orë para se të hynte në sallën e operacionit, që duhet të kishte ndodhur menjëherë pas pranimit në urgjencë. Artikulli në fund flet se si plagët e saj fizike po shërohen, por ajo “ende është duke procesuar dëmin psikologjik, të cilën ajo e quan *trauma e të qenurit e padukshme*”.

Por ky artikull nuk përmend racën, gjë që më bën të mendoj se autori dhe bashkëshortja e tij janë të bardhë. Bardhësia është ajo që çon drejt një qëndrimi padashje neutral: premisa e asgjësë, hamendësimi i universales. (Studimet kanë treguar se njerëzit e bardhë janë më të hapur të dëgjojnë njerëz të tjerë të bardhë duke folur mbi racën, se sa të dëgjojnë dikë me ngjyrë. Si dikush që ngjan si e bardhë, dua t’u them të bardhëve: shikoni fytyrën time të bardhë, dhe më dëgjeni).

Trauma e të qenurit e padukshme. Edhe një herë: *kush lejohet brenda hapësirës publike? Kush lejohet të jetë e dukshme?* Nuk dua ta minimizoj rëndësinë e përvojës së tmerrshme të Rachel-it. Edhe mua më kanë detyruar njëherë të pres mbi 10 orë në urgjencë deri sa më dhanë diagnozën e shpërthimit të një cisti

ovarian. Por, dua të vë në pah supozimet mbi të cilat bazohet tmerri i saj: se brishtësia jonë duhet parë dhe nderuar, se ne të gjithë meritojmë përkujdes, pa vonesa dhe në atë formë që “respekton autonominë e pacientit,” sipas Katër Parimeve të Etikës Bio-Mjekësore. Sigurisht, këto hamendësime duhet të vlejné për të gjithë. Por, duhet të shtrojmë pyetjen se kujt i lejohet t’i ketë këto hamendësime. Kujt ia beson shoqëria këto besime? Dhe ndaj kujt ushtron shoqëria të kundërtën?

Krahasoje përvojën e Rachel-it në duart e të institucioneve mjekësore, me atë të Kam Brock. Në shtator të vitit 2014, Brock, një grua zezake 32 vjeç, e lindur në Jamaica dhe banore e New York-ut, po ngiste një BMW kur e ndaloi policia. E akuzuan se po voziste nën efektin e marihuanës, dhe megjithëse sjellja e saj dhe kontrolli që ata i ushtruan makinës nuk e provoi këtë, ata megjithatë ia konfiskuan makinën. Sipas padisë që Brock ngriti kundër qytetit të New York-ut dhe Spitalit të Harlem-it, kur Brock u paraqit të nesërmen për të marrë makinën e saj, atë e arrestuan sepse, sipas saj, sjellja e saj ishte “emocionale”, dhe kundër vullnetit të saj, e detyruan të shtrohej në pavionin e psikiatrisë pranë Spitalit të Harlem-it. (Si njeri që më kanë hospitalizuar kundër vullnetit tim për sjellje “tepër” emocionale, e njoh aq mirë këtë ngjarje sa më shkon si thikë në tru). Mjekët menduan se ajo vuante nga “deliri” dhe kishte çrregullim bipolar, sepse ajo kishte thënë se Obama e ndiqte në Twitter, gjë që ishte e vërtetë, por fakt të cilin stafi mjekësor as nuk tentoi ta vërtetonte. Më pas ajo u mbajt për tetë ditë, duke u injektuar dhunshëm me qetësues, e detyruar të përpinte ilaçe psikiatrie, të merrte pjesë në terapi grupi, dhe të zhvishej. Kartelat mjekësore të spitalit, të siguruara nga avokatët e saj, zbuluan se: në “planin afatgjatë të trajtimit” të Brock-ut në spital, shkruhej: “Objektivi: Pacientja duhet të artikulojë rëndësinë e arsimimit për të gjetur punë dhe të deklarojë se Obama nuk e ndjek në Twitter”. Shkruhej edhe se ajo kishte “paaftësi për të dalluar realitetin”. Pas

daljes nga spitali, asaj iu lëshua një faturë prej \$13,637.10.

Pyetjes se pse mjekët e spitalit e konsideruan Brock-un “delirante” vetëm se deklaroi që Obama e ndiqte në Twitter mund t’i përgjigjemi lehtësisht: sepse, kjo shoqëri konsideron se një grua e re e zezë nuk ka asnjë shans të jetë kaq e rëndësishme, dhe insistimi i saj do të thotë se ajo është “e sëmurë”.

E shtrirë, e sëmurë, e paaftë të protestoj, të mbaj lart një parullë, të bëj thirrje që dëgjohen, ose të jem e dukshme në kuptimin më tradicional të qenies politike, më lindi pyetja thelbësore e Teorisë së Gruas së Sëmurë: si mund të thyesh xhamin e një banke, nëse nuk mund të çohesh nga shtrati?

3.

Para se të flas për “gruan e sëmurë” në të gjitha format e saj, më duhet të flas fillimisht si individ, dhe të flas nga vendndodhja ime specifike.

Unë jam kundër idesë se kompleksi industrial mjekim-sigurim ka mirëkuptim për qenien time në tërësi, edhe pse sillet sikur më kupton. Më kanë dhënë shumë epitete përgjatë viteve, e megjithëse disa prej tyre më kanë ndihmuar të artikulohem më lehtë — fundja, pavarësisht se sa tentojmë të ndryshojmë botën, ne duhet të gjejmë mënyra për t’u përballur me realitetin rreth nesh — së pari dua të sugjeroj disa mënyra të tjera për të kuptuar “sëmundjen” time.

Ndoshta e gjitha shpjegohet me faktin se Hëna ime është në shenjën e Gaforres në shtëpinë e 8-të, Shtëpinë e Vdekjes, ose që Marsi, Saturni dhe Plutoni im — të cilët astrologjia i quan tre “keqdashësit” ose forcat e liga — janë në shtëpinë e 12-të, Shtëpinë e Sëmundjes, Sekreteve, Pikëllimit, dhe Vetëzhbërjes. Ose, se nëna e babait tim ishte arratisur nga Korea e Veriut si fëmijë, dhe e kishte mbajtur këtë gjë sekret deri para pak vitesh, kur aksidentalisht i shpëtoi, por në sekond, aty për aty, e mohoi. Ose, se nëna ime vuan nga një sëmundje mendore e padiagnostifikuar, të cilën familja gjithmonë e ka mohuar, sëmundje kjo që është përkeqësuar nga

40 vite varësie ndaj ilaçeve, nga trauma seksuale, dhe nga hepatiti prej një gjilpëre të infektuar, që edhe sot e kësaj dite nuk është trajtuar si duhet, ndërkohë që ajo vazhdimisht hyn e del nga burgu, jeton në shtëpi të zaptuara, ose është e pastrehë. Ose, se mua si fëmijë më kanë abuzuar fizikisht dhe emocionalisht, se jam rritur në një ambient varfërie, varësie dhe dhune, dhe se prindërit e mi më kanë mohuar për 13 vite. Ndoshta edhe për faktin se jam e varfër: sipas IRS, në vitin 2014, të ardhurat e mia të normalizuara bruto ishin \$5,730 (sepse nuk jam mjaft e shëndetshme për të punuar me orar të plotë), që do të thotë se sigurimet e mia shëndetësore mbulohen nga shteti i Kalifornisë, se “mjeku im i familjes” është një grup asistentësh mjekësorë dhe infermierësh në një klinikë në katin e dytë të një qendre tregtare, dhe se unë ushqehem falë kuponave. Ndoshta se unë jam queer dhe me gjini jo-binare, dhe kam dalë haptas para prindërve të mi kur isha 14 vjeç; dhe se kam ikur në shtëpia në moshën 16 vjeç, me syrin e nxirë nga shuplaka e fundit që tolerova nga dora e nënës time. Ndoshta e gjitha mund të përmblihet me fjalën “traumë”. Ndoshta jam thjesht njeri i dobët dhe i pafat.

E rëndësishme është se unë përdor terminologjinë mjekësore perëndimore që ma kanë dhënë, pavarësisht se a më pëlqen a jo, sepse ofron një fjalor të përbashkët: “Kjo është gjuha e shtypësit”, shkruante Adrienne Rich në vitin 1971, “e megjithatë më duhet që të mund të flas me ty”. Por, më lejoni të ofroj një gjuhë tjetër. Në gjuhën autoktone amerikane Cree, emri dhe folja pronore janë të strukturuara ndryshe nga anglishtja në një fjali. Në gjuhën Cree, nuk thua “unë jam sëmurë”. Në këtë gjuhë përdoret “më ka rënë sëmundja”.¹ Më pëlqen kjo shprehje dhe dua të jetoj me të.

1. Në tekstin original Hedva citon në gjuhën Cree thënien “sëmundja ka ardhur tek unë”, e përshtatur këtu me thënien e përdorur në gjuhën shqipe “sëmundja më ka rënë”. (shën. i përkth.)

Atëherë, ja çfarë më ka rënë mua:

Endometrioza, një sëmundje që shkakton rritjen e mureve të mitrës aty ku nuk duhet, kryesisht në zonën pelvike, por edhe gjithandej, këmbë, abdomen, deri edhe në kokë. Shkakton dhimbje kronike; kaos gastrointestinal; gjakderdhje epike, monstuoze; në disa raste, kancer; pra, unë kam pësuar abort, nuk mund të kem fëmijë, dhe në të ardhmen do t'i nënshtrohem disa operacioneve. Kur po i shpjegoja shoqes time këtë sëmundje që ajo nuk e njihte, ajo më tha plot habi: “Pra, i gjithë trupi jot është një mitër!” Le të themi që po. (Imagjinoni çfarë do të thonin për këtë mjekët antikë grekë, baballarët e “mitrës endëse”.) Pra, çdo muaj, këto qeliza djallëzore të mitrës që kanë zënë rrënjë në trupin tim “i binden natyrës së vet, dhe derdhin gjak”, siç thotë endro-luftëtarja Hilary Mantel. Kjo çon deri te krijimi i cisteve, të cilat si përfundim plasin, duke lënë pas copëza indesh të vdekura, si mbetje bombash të vogla.

Çrregullimi bipolar, stresi kompleks posttraumatik, çrregullimi i ankthit, dhe çrregullimi i depersonalizimit/deperceptimit, janë disa nga sëmundjet e tjera që më kanë rënë. Kjo mund të nënkuptojë që unë jetoj mes kësaj bote dhe një tjetre, njëra e krijuar nga vetë truri im, të cilës nuk i mjafton të qëndroj brenda konceptit diskret të “vetes”. Si pasojë e këtyre “çrregullimeve”, unë përfshihem nga emocione shpërthyesë, stuhi mendimesh dhe peisazhe vegimesh, nga ndjenja se mendja ime është tretur mes yjesh, deri tek ndjesia se jam shndërruar në një hiç, si dhe përjetime të thella ekstaze, ngazëllimi, pikëllimi, dhe halucinacione të frikshme.

Si pasojë e këtyre, jam hospitalizuar shumë herë, me dhe pa vullnetin tim, dhe një nga ilaçet që më dhanë njëherë, gati sa nuk më shkaktoi vdekje: një nga efektet e rralla anësore të ilaçit ishte rënja e lëkurës. Kjo më kushtoi 800 dollarë në muaj, pavarësisht se unë përfundova te ky ilaç, vetëm pse doktori im ma dha ta provoj falas. Nëse dua të jem e aftë të mbaj një punë, sepse bota

e ka vendosur që se unë duhet të kem një punë, më duhet të marr mjekim anti-psikotik që shkakton çdo ditë, përveç efekteve të tjera tërheqëse, edhe humbje afatshkurtër të kujtesës dhe jargavitje. Këta mysafirë më kanë sjellë edhe miqtë e tyre: kriza nervore, shkatërrim mendor, ose quaje si të duash, tre herë në jetën time. Jam e sigurt që do të më vizitojnë sërish. Më kanë motivuar më shumë se dhjetë herë të tentoj vetëvrasje (në momentet e mia të disasocimit mendor). Herën e parë isha vetëm 9 vjeç.

Dhe e fundit, sëmundja ime (apo sëmundjet?) autoimmune, që vazhdon pështjellon të gjithë doktorët që kam takuar, dhe që më ka rënë mua, dhe që sot e kësaj dite refuzon të ketë një emër. Në të njejtën ditë që ky shkrim u botua për herë të parë në revistën *Mask Magazine*, një neurolog më dha, “sa për fillim”, diagnozën “100% fibromialgji”. Një vit e më shumë para kësaj, mjeku im i “kujdesit parësor”, më kishte këshilluar të vizitohesha nga një neurolog, reumatolog dhe një imunolog, që të mund të filloja testimet për sklerozë të shumëfishtë dhe sëmundje të tjera autoimmune, nisur nga disa prej simptomave të mia. Sigurimi im shëndetësor ende nuk e ka aprovuar këtë këshillim dhe as nuk ka gjetur mjekë specialistë, në rrezen prej 240 kilometrave, që mbulohen nga plani im i sigurimit; neurologu që më dha diagnozën e fibros pranoi të më bënte kontroll mjekësor jashtë-planit-tim, me parane-dorë, si favor miqësor. Nuk kam hapësirë këtu — a do të kem ndonjëherë? — të përshkruaj se si është të jetosh me sëmundje autoimmune. Mund të them se sjell lodhje të paimagjinueshme, dhimbje kudo dhe gjatë gjithë kohës, ndjeshmëri ndaj sëmundjeve, në një trup që performon funksionet e veta “normale” në mënyrë tmerrësisht anormale.

4.

Mes gjithë këtyre mysafirëve, fillova të shkruaj “Teorinë e gruas së sëmurë” si një hap mbijetese në një realitet që më duket i

padurueshëm, dhe si një dëshmi mbi veten time, që nuk arrij as ta kuptoj se si mund të jetë “e imja”.

Nxitja fillestare për projektin e një Teoria e Gruas së Sëmurë, dhe titulli që mori më pas, më erdhi nga disa burime. E para ishte për të menduar se si sëmundja, paaftësia dhe ndjeshmëria *feminizojnë* — pra, e bëjnë “të dobët” dhe “më të brishtë” — çdo njeri që ka nevojë për kujdes. Tjetra erdhi si përgjigje ndaj “Sad Girl Theory” (Teoria e vajzës së trishtuar) nga Audrey Wollen, ku ajo propozon se ripërkufizimi i patologjive historikisht të feminizuara, mund të jetë një formë e protestës politike për vajzat: aty ku “Sad Girl Theory” e merr të mirëqenë bardhësinë, bukurinë, heteronormativitetin, dhe pasurinë e klasës së mesme, aty fillova të pyes se çfarë ndodh me vajzën e varfër, queer, dhe/ose jo të bardhë, kur, dhe nëse, ajo rritet. Më nxit gjithashtu leximi i veprës fantastike *Heroines* (Heroinat) nga Kate Zambreno, që më ngacmoi dëshirën për të tallë pak bythën me konceptin e “heroizmit”, dhe dëshirën për të propozuar një figurë me tipare tradicionalisht anti-heroike — pra, sëmundje, përtaci dhe mosveprim — si një simbol i denjë i një Teorie madhore. Por, një nga ndikimet më kumbuese ishte libri feminist *Complaints and Disorders* (Ankesa dhe çrregullime), i vitit 1973, që bën dallimin mes “gruas së sëmurë” nga shtresat e larta dhe të bardha, dhe “grave që të sëmurin” nga klasat punëtore dhe jo të bardha. Dhe nëse teoria e gruas së sëmurë ka një ndrikull kujdestare, ajo është Audre Lorde.

Teoria e gruas së sëmurë është për ata që përballen me ndjeshmërinë dhe brishtësinë e padurueshme të tyre, çdo ditë, dhe duhet të luftojnë që kjo përvojë e tyre jo vetëm të nderohet, por fillimisht të bëhet e dukshme. Për ata që, në fjalët e Audre Lorde, supozohet se nuk do të mbijetojnë: sepse kjo botë është ndërtuar në kundërshtim me mbijetesën e tyre. Është për të gjithë shëndetligët si puna ime. Ju e dini kush jeni, edhe pse nuk ua kanë thënë

diagnozën akoma: një prej qëllimeve të Teorisë së Gruas së Sëmurë është t'i rezistojë idesë se një insitucion duhet të të legjitimojë, në mënyrë që të të riparojë. Ju, zemrat e mia, nuk keni nevojë për riparim — është bota ajo që ka nevojë të riparohet.

Kjo është thirrja ime për të marrë armët dhe është një dëshmi për të na njohur. Shpresoj që këto mendime të mia të ndihmojnë në artikullim dhe të rezonojnë, dhe të jenë mjet për mbijetesë dhe qëndresë.

Dhe për të gjithë ju që nuk vuani nga një sëmundje kronike apo nuk jeni me aftësi ndryshe, Teoria e Gruas së Sëmurë kërkon nga ju të keni më shumë empati për ne. Të përballeni me ne, të na dëgjoni, të na shihni.

5.

Teoria e Gruas së Sëmurë këmbëngul se shumica e formave politike të protestës janë të përbrendësuara, të jetuara, të mishëruara, të përvuajtura dhe, pa asnjë dyshim, të padukshme. Teoria e Gruas së Sëmurë e përkufizon ekzistencën brenda një trupi si diçka që është kryesisht dhe gjithnjë e brishtë, në vazhden e teorisë së kohëve të fundit nga Judith Butler mbi pasigurinë ekonomike dhe rezistencën. Për shkak se premisa që shtron Butler insiston se trupi nuk preket vetëm përkohësisht nga brishtësia, por brishtësia e përkufizon atë, pra një trupi i duhet infrastrukturë mbështetëse në mënyrë që të durojë, atëherë botën duhet ta ndryshojmë duke u nisur nga ky fakt. Teoria e Gruas së Sëmurë konsideron se trupi dhe mendja janë të ndjeshme dhe reagojnë ndaj regjimeve shtypëse — sidomos ndaj regjimit tonë aktual neoliberal, racist, imperialo-kapitalist dhe hetero-cis-patriarkal. Pra, se trupat dhe mendjet tona e bartin këtë traumë historike, se është vetë bota ajo që po na bën dhe po na mban të sëmurë.

Përdorimi i nocionit “grua” si një pozitë-subjekti i kësaj teorie, është një zgjedhje strategjike, një përqaftim gjithëpërfshirës

dhe një përkushtim ndaj partikulares, dhe jo universales. Edhe pse identiteti “grua” ka fshirë dhe përjashtuar shumë të tjerë (sidomos gra me ngjyrë, dhe njerëz trans/jo-binar/me gjini fluide), unë zgjedh ta përdor, sepse kjo fjalë, megjithatë, vazhdon të përfaqësojë të neglizhuarit, të pabarabartit, të shtypurit, të pa-, të jo-, të nën-. Duhet të provojmë të mendojmë në mënyrë kritike të vazhdueshme mbi aspektet problematike të këtij termi, dhe shpresoj se teoria e gruas së sëmurë mund të ndihmojë në këtë drejtim. Por, mbi të gjitha, u frymëzova të përdor fjalën “grua” sepse këtë vit kuptova se të jesh grua vazhdon të jetë diçka radikale, edhe pse jemi në shekullin 21. E përdor për të nderuar një shoqen time të dashur, e cila para një viti deklaroi gjininë e saj fluide. Për të, ajo çfarë kishte më shumë rëndësi ishte mundësia ta quante veten e saj “grua”, dhe të përdorte përemrat “ajo/e saj”. Ajo nuk donte operacion apo hormone; ajo nuk donte të ndryshonte trupin dhe karin e saj të madh — ajo donte vetëm fjalën. Fjala në vetvete mund të jetë fuqizuese dhe mbi këtë frymë lindi edhe emri i teorisë së gruas së sëmurë.

Gruaja e sëmurë është një identitet dhe një trup që mund t’i përkasë kujtqo që i është mohuar ekzistenca e privilegjuar — ose *premtimi* mizor i mundësisë së kësaj ekzistence — e burrit të bardhë, heteroseksual, të shëndetshëm, neurotipik, nga klasa e mesme dhe e lartë, cis- dhe fizikisht të aftë të ndërtojë shtëpinë e tij në një vend të pasur, gjithmonë me sigurim shëndetësor, dhe rëndësia e të cilit njihet dhe pranohet hapur dhe kudo në shoqëri; rëndësia dhe kujdesi ndaj të cilit *dominon* mbi këtë shoqëri, në kurriz të të gjithë të tjerëve.

Gruaja e sëmurë është kushdo që nuk e ka të garantuar këtë përkujdesje.

Gruas së sëmurë i është thënë se kujdesi ndaj saj, por edhe mbijetesa e saj në këtë shoqëri, nuk kanë rëndësi.

Gruaja e sëmurë janë të gjithë trupat “disfunksionale”,

“të rrezikshëm” dhe “në rrezik”, “të pasjellshëm”, “të çmendur”, “të pashërueshëm”, “të traumatizuar”, “të çrregullt”, “të sëmurë”, “kronikë”, “të pasigurueshëm”, “të rrënuar”, “të padëshirueshëm”, dhe përgjithësisht “disfunksionalë”, që iu përkasin grave, njerëzve me ngjyrë, të varfër, të sëmurë neuro-atipikë, me aftësi ndryshe, queer, trans, dhe me gjini fluide, që historikisht janë patologjizuar, hospitalizuar, institucionalizuar, brutalizuar, dhe janë bërë trupa “të pamenaxhueshëm”, dhe për rrjedhojë, kulturalisht të jashtëligjshëm dhe politikisht të padukshëm.

Gruaja e sëmurë është një grua e zezë trans që kalon kriza paniku sa herë përdor një banjo publike, nga frika prej dhunës që e pret.

Gruaja e sëmurë është fëmija i prindërve indigjenë, historitë e të cilëve janë zhdukur, që vuan nga traumat e brezave të kolonializmit dhe dhunës.

Gruaja e sëmurë është një person i pastrehë, sidomos kur vuan nga një sëmundje dhe që nuk ka asnjë mundësi për trajtim, dhe që ka qasje në kujdesin shëndetësor mendor vetëm kur e mbajnë 72 orë në spitalin e qarkut.

Gruaja e sëmurë është një grua e zezë me probleme mendore, familja e së cilës telefoni policinë për ndihmë kur ajo po kalonte një episod krize, të cilën e vrasin më vonë nën kujdesin policor, dhe historinë e saj e mohojnë të gjithë ata që operojnë nën petkun e supremacisë së bardhë. Emri i saj është Tanesha Anderson.

Gruaja e sëmurë është një burrë gej 50 vjeçar që e kanë përdhunuar në adoleshencë, por i cili ka heshtur i turpëruar duke besuar se burrat nuk mund të përdhunen.

Gruaja e sëmurë është një person me aftësi ndryshe që nuk mund të marr pjesë në një ligjëratë mbi aftësitë ndryshe, sepse ligjëratata mbahet në një sallë ku ajo nuk ka akses.

Gruaja e sëmurë është një grua e bardhë me sëmundje

kronike të rrënjësura në trauma seksuale e cila duhet të marrë qetësues që të mund të çohet nga krevati.

Gruaja e sëmurë është një burrë heteroseksual me depresion i cili është mjekuar (menaxhuar) që në adoleshencë të hershme dhe i duhet të luftojë për të plotësuar 60 orët e punës në javë.

Gruaja e sëmurë është dikush që është diagnostifikuar me sëmundje kronike, familja dhe shoqëria e së cilës vazhdimisht i thonë të ushtrojë sa më shumë aktivitete fizike.

Gruaja e sëmurë është një grua queer me ngjyrë, aktivizmi, intelekti, zemërimi, dhe depresioni i së cilës, perceptohen nga pjesa e bardhë e shoqërisë si tipare problematike të personalitetit të saj.

Gruaja e sëmurë është një burrë i zi i vrarë gjatë shoqërimit në stacionin policor, dhe për të cilin zyrtarisht u tha se ai kishte dëmtuar shtyllën e tij kurrizore. Emri i tij është Freddie Gray.

Gruaja e sëmurë është një veteran lufte që vuan nga çrregullimet e stresit post-traumatik, dhe që pret me muaj për t'u vizituar nga një mjek i administratës së veteranëve.

Gruaja e sëmurë është një nënë e vetme, që ka emigruar ilegalisht në "tokën e të lirëve", dhe punon te "vendi i të lirëve", dhe mban tre punë për të ushqyer familjen e saj, dhe frymëmarrja e saj vështirësohet gjithmonë e më shumë.

Gruaja e sëmurë është refugjati.

Gruaja e sëmurë është fëmija i abuzuar.

Gruaja e sëmurë është personi me autizëm, të cilën bota përpiqet ta "shërojë".

Gruaja e sëmurë janë të uriturit.

Gruaja e sëmurë janë ata që po vdesin.

Dhe, kryesorja: Gruaja e sëmurë është ajo për të cilën kapitalizmi ka nevojë për të përjetësuar veten.

Pse?

Sepse, që kapitalizmi të mbijetojë, nuk mund ta marrë përsipër përgjegjësinë e përkujdesit ndaj nesh: logjika shfrytëzuese

e kapitalizmit kërkon që disa prej nesh të vdesin.

“Sëmundja” siç ne flasim për të sot është një konstrukt kapitalist, siç është edhe kundërta binare e perceptuar e saj “të jesh mirë”. Njeriu “mirë” është njeriu që është mjaftueshëm mirë të shkojë në punë. Njeriu “i sëmurë” është ai që nuk mundet. Është tejet e mbrapshtë të konsiderosh gjendjen e të qenurit “mirë” si një e mirëqenë, si një premisë bazike e ekzistencës sonë, sepse bën që *sëmundja të perceptohet si e përkohshme*. Kur sëmundja perceptohet si çoroditje e normës, *në të njëjtën formë perceptohet edhe përkujdesi dhe mbështetja ndaj të sëmurëve*.

Përkujdesi, brenda kësaj kornize, nevojitet vetëm ndonjëherë. Kur sëmundja është e përkohshme, përkujdesi nuk është normal.

Një ushtrim për ju: dilni para pasqyrës, shikojeni veten në sy, dhe thoni me zë të lartë: “Të kujdesem për ty nuk është normale. Jam në gjendje ta bëj vetëm përkohësisht”.

T’ia thuash vetes këtë është vetëm një jehonë e asaj që bota e përsërit gjatë gjithë kohës.

6.

Dikur mendoja se çdo akt kundër kapitalizmit kishte të bënte me dashurinë, dhe në veçanti me poezitë e dashurisë: të shkruash një poezi dhe t’ia kushtosh dikujt që e dëshiron, duhet të ishte forma më radikale e rezistencës. Sot e di se nuk paskam pasur të drejtë.

Forma më anti-kapitaliste e protestës është përkujdesi ndaj njëri-tjetrit dhe përkujdesi ndaj vetes. Le ta marrim shembull praktikën historikisht femërore, dhe rrjedhimisht të padukshme, të ushqyerjes, rritjes, përkujdesit. Le ta marrim seriozisht brishtësinë, dobësinë dhe pasigurinë që ndjejmë, dhe ta mbështesim, nderojmë dhe fuqizojmë atë. Le të mbrojmë njëri-tjetrin, të krijojmë dhe të jetojmë komunitetin. Një afrimitet radikal, një shoqërizim i ndërvarur, një politikë e përkujdesit.

Sepse, kur të gjithë të jemi të sëmurë dhe pengje shtrati, dhe të flasim për historitë tona të terapisë dhe qetësuesve, dhe të formojmë grupet tona mbështetëse, dhe të bëhemi dëshmitarë të traumave të njëri-tjetrit, dhe t'i japim përparësi perkujdesit dhe dashurisë për trupat tanë të sëmurë, të shtrenjtë, të ndjeshëm, të mahnitshëm dhe në dhimbje, dhe kur askush të mos jetë më në gjendje të shkojë në punë, ndoshta vetëm atëherë, më në fund, do të dëgjojmë klithmat e fundit të lavdishëm, por kaq të vonuar dhe të duhur, të kapitalizmit.

Versioni i parë i këtij shkrimi është botuar në revistën *Mask Magazine*, maskmagazine.com, në janar 2016. Redaktuar nga Hanna Hurr dhe Isabelle Nastasia. Teksti është përshtatur nga ligjërata "Trupi im është një burg dhimbjeje dhe dua ta lë si një mistik, por edhe e dua & dua të ketë vlerë politike", të mbajtur në Human Resources, mbështetur nga Qendra e Grave për Punë Krijuese, në Los Angeles, më 7 tetor 2015.

Përktheu: Aurora Birbilaj

TEORIA TRASTË E RRËFIMIT

Ursula K. Le Guin

1986

Në vendet e buta dhe tropikale, ku mendohet se hominidët kanë evoluar në qenie njerëzore, ushqimi parësor i specieve ishte bimor. Në kohën e paleolitit dhe neolitit, gjashtëdhjetëepesë deri në tetëdhjetë për qind e asaj që hanin njerëzit në këto vende, mbledhej; përveç në Arktikun e largët, ku ushqimi kryesor ishte mishi.

Gjahtarët e mamuthëve zënë vend, në mënyrë spektakolare, në muret e shpellave dhe mendjeve tona, por në fakt, për të mbajtur veten gjallë dhe të dhjamosur, na është dashur të mbledhim fara, rrënjë, lakra, fidanë, gjethe, arra, fruta pylli dhe drithëra, duke shtuar insektet dhe molusqet, si dhe kemi kapur me rrjeta dhe me gracka zogj, peshq, minj, lepuj dhe gjallesa të tjera të vogla pa dhëmbë, për të shtuar proteinën. Madje nuk na është dashur as të punojmë fort për to — shumë më pak sesa fshatarët që shfrytëzoheshin për të punuar arën e pronarit pas shpikjes së bujqësisë, dhe shumë më pak sesa punëtorët me rrogë që nga shpikja e qytetërimit. Njeriu mesatar parahistorik mund të siguronte një jetesë të mirë me rreth pesëmbëdhjetë orë pune në javë.

Pesëmbëdhjetë orë pune në javë për mbijetesë, linte shumë kohë për gjëra të tjera. Aq shumë kohë sa ndoshta, ata që nuk rrinin dot duarkryq, që nuk kishin fëmijë për t'ua gjallëruar jetën, apo aftësi për të krijuar, gatuar ose kënduar, apo mendje të ndritura për të menduar, vendosën të marrin rrugët dhe të gjuajnë mamuthë. Gjahtarët e zotë më pas ktheheshin lavdishëm me një ngarkesë mishi, plot fildish, si dhe një tregim. Nuk ishte mishi që bënte diferencën. Ishte tregimi.

Është e vështirë të rrëfesh një histori vërtet mbresëlënëse për mënyrën se si unë e shkoqa farën e tërshërës së egër nga gërdhushta, farë pas fare, farë pas fare, dhe pastaj u kruajta aty ku më kishin pickuar mushkonjat, dhe Ooli tha diçka për të qeshur, dhe bashkë shkuam te kreshta dhe aty pimë diçka dhe për një kohë soditëm hardhucën dhe pastaj unë gjeta një grusht tjetër tërshëre...

Jo, nuk krahasohet, dhe as nuk mund të matet me tregimin se si unë e ngula shtizën time thellë në krahun leshtor të titanit, ndërkohë që Oobi, i çarë nga njëri çatall i mprehtë, përpëlitej duke u çjerrë, dhe gjaku shpërtheu gjithandej si rrëke dhe Boobi që u bë petë kur mamuthi u plandos sipër tij kur shigjeta ime e qëlloi në shenjë, mu në dritë të syrit, drejt e në tru.

Kjo histori, përveç që ka një Akt, ka edhe një Hero. Heronjtë janë të fuqishëm. Krejt papritur, burrat dhe gratë e kërrusur mbi grumbullin e tërshërës së egër dhe fëmijët e tyre dhe aftësitë e zejtarëve dhe mendimet e mendimtarëve dhe këngët e këngëtarëve, të gjithë marrin pjesë në këtë tregim, dhe të gjitha vihen në shërbim të përrallës së Heroit. Por ky nuk është tregimi i tyre. Është i tij.

Kur po hartonte librin që në fund mori titullin *Three Guineas* (Tre qindarkat), Virginia Woolf, në bllokun e saj të shënimeve, kishte shënuar mbititullin “Fjalorth”; ajo mendonte të rishpikte anglishten sipas një plani të ri, që të mund të rrëfente një tregim ndryshe. Një nga prurjet në këtë fjalorth është fjala *heroizëm*, i përkufizuar si “botulizëm”.¹ Dhe *heroi*, në fjalorin e Woolf, ishte “shishe.” Heroi si shishe, një rivlerësim i saktë. Unë tani propozoj shishen si hero.

Jo vetëm shishen e rakisë apo të verës, por shishen në kuptimin e saj më të vjetër, si enë mbajtëse në përgjithësi, si diçka që mban diçka tjetër.

Nëse nuk ke se ku ta mbash, ushqimi mund të të rrëshqasë nga duart — madje të rrëshqet edhe diçka krejt joluftarake dhe e ngathtë si vetë tërshëra. Kur i ke nëpër duar, mund të fusësh sa të duash në bark, si ena jote mbajtëse parësore; po çfarë do të bësh nesër në mëngjes kur të zgjohesh dhe është mot i ftohtë me shi, a

1. Botulizmi është një sëmundje e rrallë dhe serioze helmimi e shkaktuar nga toksina botulinum. (shën. i përkth.)

nuk do të ishte mirë sikur të kishe një grusht nga ajo tërshëra që ta përtypësh dhe ta ushqesh Omin e vogël që qan pa pushim, dhe si t'ia bësh që të marrësh me vete në shtëpi më shumë se sa të mban barku dhe duart? Atëherë ngrihesh në këmbë dhe nisesh nëpër shi te ngastra e tërshërës, qull e baltë, dhe sa mirë do të ishte sikur të kishe diçka ku mund ta mbaje bebin Om, dhe të mund të mblidhje tërshërë me të dyja duart? Një gjethe, një pagure, një guackë, një rrjetë, një trastë, një torbë, një hobe, një thes, një shishe, një poçe, një kuti, një enë. Një mbajtëse. Një marrëse.

Vegla e parë kulturore mbase ka qenë një mbajtëse...

Shumë teoricienë mendojnë se shpikjet më të hershme kulturore duhet të kenë qenë enë që shërbenin për të mbajtur produktet e mbledhura dhe ndonjë lloj mbajtëse lecke apo rrjete.

Kështu shkruan Elizabeth Fisher në *Women's Creation* (Krijimi i grave). Por jo, kjo nuk vlen. Ku mbeti ajo gjëja e mprehtë, e gjatë, e fortë, ajo kocka besoj, me të cilën njeriu majmun e goditi për herë të parë dikë në një film dhe më pas, me hungërima deri në ekstazë se kishte kryer vrasjen e tij të parë, fluturoi në qiell, dhe duke u rrotulluar u shndërrua në anije kozmike që arrin të depërtojë në kozmos për ta fekonduar dhe, në fund të filmit, të prodhojë një fetus të lezetshëm, djalë sigurisht, që endet nëpër Rrugën e Qumështit pa (për çudi) ndonjë mitër apo një matricë aty pranë? Nuk e di. As nuk dua t'ia di. Nuk është ky tregimi që po rrëfej. E kemi dëgjuar, të gjithë ne i kemi dëgjuar të gjitha, për të gjithë shtagat dhe shtizat dhe shpatat, mjetet për të gjuajtur dhe ngulur dhe për të goditur, sende të gjata dhe të mprehta, por nuk kemi dëgjuar kurrë për atë gjënë që mban gjëra, enën, pra mbajtësen e gjërave që mbahen. Ky është një tregim i ri. Ky është lajm.

E megjithatë lajm i vjetër. Më parë — po të mendosh, natyrisht, shumë kohë më parë — arma është një vegël e vonë, e padobishme, luksoze; shumë kohë para thikës dhe sopatës së

dobishme; përkrah me të domosdoshmit topuz, blues dhe gërmues — cili ishte qëllimi i mihjes së shumë patateve kur nuk kishe me çfarë t'i merrje me vete në shtëpi ato që tepronin — pra para veglës që nxjerrë energjinë jashtë, ne kemi krijuar veglën që sjell energjinë në shtëpi. Kështu e kuptoj unë. Unë jam përkrahëse e asaj që Fisher e quan Teoria Trastë e evolucionit njerëzor.

Kjo teori jo vetëm që hedh dritë mbi hapësira të pandriçuarra teorike dhe i shmang hapësirat e përhapura të broçkullave teorike (të banuara kryesisht nga tigrat, dhelprat dhe gjitarë të tjerë tejet territorialë); por mua, personalisht, më kthen me dy këmbë në tokë, në kulturën njerëzore, si kurrë më parë. Për aq kohë sa thuhej se kultura dhe prejardhja e saj shpjegohen vetëm nëpërmjet përdorimit të gjësendeve të gjata dhe të forta për të ngulur, goditur dhe vrarë, kjo ishte diçka që nuk e ndjeja se më përkiste apo ku doja të përkisja. (“Ajo çfarë Frojdi e ngatërroi si mungesë civilizimi te gruaja, është mungesa e *besnikërisë* së saj ndaj civilizimit”, shkruan Lillian Smith). Shoqëria, civilizimi për të cilin flitej nga këta teoricienë, ishte dukshëm i tyri; ata e zotëronin, atyre u pëlqente; ata ishin njerëzorë, krejtësisht njerëzorë, duke goditur, qëlluar, vrarë. Duke dashur të jem edhe unë njerëzore, unë kërkova dëshmi se jam; por nëse duhej kaq pak për t'u bërë njeri, vetëm një armë për të vrarë dhe kaq, atëherë, me gjasë, ose kam pasur shumë defekte si genie njerëzore, ose nuk kam qenë kurrë njeri.

Kështu është, thanë ata. Ti je vetëm një grua. Vështirë se je njeri, por edhe nëse je, ke të meta. Tani hesht, derisa ne tregojmë Historinë e Naltësimit të Njeriut Hero.

Jepi, them unë, e përhumbur rrugës për te tërshëra e egër, me Oo Oo në trastë dhe Omin e vogël që mban shportën. Ti vazhdo, trego se si mamuthi ra mbi Boobin dhe se si Kaini ra mbi Abelin dhe se si bomba ra mbi Nagasaki dhe se si kandili përcëllues ra mbi fshatarët dhe se si predhat do të bien mbi Perandorinë e Djallit, dhe për të gjithë rrugëtimin e Naltësimit të Njeriut.

Nëse është njerëzore të marrësh diçka që e do, sepse është e dobishme, hahet, apo të duket e bukur, dhe ta fusësh në një çantë, ose në një shportë, ose në një lëvore apo gjethe, ose rrjetë leshi e thurur nga flokët e tu, ose çfarë të kesh, dhe pastaj ta marrësh me vete në shtëpi, shtëpia si një çantë apo torbë e llojit të vet, më e madhe, një enë për njerëz, dhe më vonë ta nxjerrësh nga torba për ta ngrënë, ose për ta ruajtur për dimër, në një enë më solide ose ta vendosësh te sirtari i ilaçeve apo në faltore, në muze, te altari, apo aty ku mbahen gjërat e shenjta, dhe të nesërmen të bësh pothuajse të njëjtën gjë — dhe nëse kjo është krejtësisht njerëzore, kjo dhe asgjë më shumë, atëherë unë megjithatë jam genie njerëzore. Plotësisht, lirisht, lumturisht, për të parën herë, njeri.

Dhe, le ta themi për herë të parë në jetë, një genie njerëzore joagresive dhe joluftarake. Unë jam grua në moshë, e zemëruar, që vetes i jap forcë me çantën time, dhe luftoj keqbërësit. Megjithatë as unë, e as dikush tjetër, nuk e quajmë veten heroinë për këtë gjë. Është vetëm një nga ato punët e dreqit që duhet t'i bësh, nëse do të vazhdosh të mbledhësh tërshërë të egër dhe të tregosh histori.

E gjitha është te tregimi. Ishte tregimi mbi Heroin ai që e fshehu njerëzimin tim nga unë, ai tregim i gjuetarëve të mamuthëve për goditjen, gjujtjet, përdhunimet, vrasjet. Tregimi i mrekullueshëm, toksik i Botulizmit. Tregimi vrastar.

Nganjëherë duket se këtij tregimi po i vjen fundi. Që të mos ketë më fare rrëfime historish, disa prej nesh këtu mbi tërshërën e egër, mes misrit të panjohur, mendojmë se duhet të fillojmë të rrëfejme një tregim ndryshe, të cilin njerëzit mund ta vazhdojnë kur ai i vjetri të ketë marrë fund. Ndoshta. Problemi është se ne, të gjithë ne, kemi lejuar të bëhemi pjesë e tregimit vrastar dhe ne mund të marrim fund bashkë me të. Prandaj, e shtyrë nga një ndjenjë që nuk duron më, me ngulm po kërkoj natyrën, subjektin, fjalët e tregimit tjetër, atij tregimi të patreguar, tregimit të jetës.

Ende e pazbuluar, kjo histori nuk më del aq lehtë nga goja, jo siç më del tregimi vrashtar; por megjithatë, kur them “i patreguar” ndoshta po e teproj. Tregimi i jetës është treguar ndër shekuj, në gjuhë e forma të ndryshme. Mite mbi krijimin dhe shndërrimin, fabula dinake, përralla popullore, anekdota, romane, ...

Romani në thelb është një rrëfim joheroik. Patjetër që Heroi shpesh e ka dominuar, pra natyra e tij perandorake dhe impulsi i tij i pakontrolluar, e ka shtyrë të marrë çdo gjë në dorën e tij, që ta udhëheqë, duke nxjerrë dekrete dhe ligje të ashpra që kontrollojnë impulsin e tij të pakontrollueshëm për ta vvarë atë. Kështu Heroi, përmes gojëve Ligjvënëse që i shërbejnë atij, ka dekretuar se, së pari, forma e duhur e narrativës është ajo e shigjetës apo shtizës, që nisat *këtu* dhe fluturon drejt *atje* dhe FAP! e qëllon shënjestrën (dhe e vret në vend); së dyti, që boshti kryesor i tregimit, përfshirë romanin, është konflikti; dhe, së treti, që tregimi nuk ka vlerë, nëse ai, heroi, nuk është në të.

Unë mendoj krejt ndryshe. Unë shkoj aq larg sa them se forma e natyrshme, e duhur dhe e përshtatshme e romanit është ajo e thesit, e torbës. Libri përmban fjalë. Fjalët përmbajnë gjëra. Ato përmbajnë kuptime. Romani është si një kuti mjekimi, që mban gjëra që ndërlidhen në një formë krejt të veçantë e të fuqishme me njëra-tjetrën dhe me ne.

Elementët brenda një romani mund edhe të ndërlidhen nëpërmjet konfliktit, por është absurde të reduktosh të gjithë rrëfimin në konflikt. (Kam lexuar njëherë një udhëzues mbi shkrimin që thoshte se: “Tregimi duhet parë si një betejë”, dhe vazhdonte me strategjitë, sulmet, fitoret, etj.) Konflikti, gara, stresi, lufta, etj., brenda tregimit të menduar si qese/torbë/rreth belit/kuti/shtëpi/kuti barnash, mund të shihen si elemente të dhura të një tërësie, që në vetvete nuk mund të karakterizohet as si konflikt, dhe as si harmoni, duke qenë se qëllimi i tij nuk është as zgjidhje dhe as vakuum, por është një proces i vazhdueshëm.

Si përfundim, është e qartë se Heroi nuk duket mirë në këtë thes. Atij i duhet një skenë ose një pedestal ose një majë mali. Po e fute atë në thes, ai do të duket si një lepur, si një patate.

Ja pse më pëlqejnë romanet: në vend të heronjve ato kanë njerëz në to.

Dhe kështu, kur nisa të shkruaja romane fantastiko-shkencore, e tërhiqja zvarrë këtë thesin e madh e të rëndë me gjëra, torbën time plot me qyqarë e torollakë, dhe me thërrime më të vogla se një farë mustarde, dhe me rrjeta të thurura aq ndërlikueshëm, të cilat nëse shthurren me shumë mundim, gjejmë se brenda tyre mbajnë një guralec të kaltër, një kronometër që punon pa ndërhyrje, që tregon kohën në një botë tjetër, dhe një kafkë miu; plot me fillime që nuk kanë fund, nisje, humbje, transformime dhe interpretime dhe shumë më shumë rrengje sesa konflikte, shumë më pak triumfe sesa kurthe dhe iluzione; plot me anije kozmike që ngecin, misione që dështojnë dhe njerëz që nuk kuptojnë. Unë thashë se është e vështirë të tregosh një histori mbresëlënëse për mënyrën se si e shkoqëm tërshërën e egër nga gërdhushatat e saj, por nuk thashë se është e pamundur. A ka thënë ndonjëherë kush se është e lehtë të shkruash roman?

Nëse fantashkenca është mitologjia e teknologjisë moderne, atëherë miti i saj është tragjik. “Teknologjia” ose “shkenca moderne” (duke i përdorur këto fjalë siç përdoren zakonisht, në shënimet e nxituara stenografike, dhe që nënkuptojnë shkencën “serioze” dhe teknologjinë e “lartë”, të cilat bazohen mbi rritjen e vazhdueshme ekonomike), është një sipërmarrje heroike, herkuliane, prometeane, e konceptuar si triumf dhe, përfundimisht, si tragjedi. Trillimi që mishëron këtë mit do të jetë, dhe ka qenë, triumfues (njeriu pushton tokën, hapësirën, jashtëtokësorët, vdekjen, të ardhmen, etj.) dhe tragjik (apokalipsi, holokausti, dje ose sot).

Megjithatë, nëse arrin të shmangësh mënyrën lineare, progresive, të shigjetës-(vrasëse)-të kohës së Tekno-Heroikes dhe

ridefinon teknologjinë dhe shkencën kryesisht si torbë kulturore, dhe jo si armë mbizotëruese, efekti anësor i kënaqshëm është se fantashkenca mund të shihet si një zhanër jo aq i ngurtë, një fushe jo e ngushtë, jo domosdoshmërisht prometeane dhe aspak apokaliptike, në fakt si një zhanër jo aq mitologjik, sa realist.

Është një realizëm i çuditshëm, por realiteti është i çuditshëm.

Fantashkenca e konceptuar si duhet, si të gjitha trillimet serioze, qoftë edhe komike, është një mënyrë për të shpjeguar atë që në fakt po ndodh, atë çfarë njerëzit në fakt bëjnë dhe ndiejnë, se si njerëzit ndërliiden me çdo gjë tjetër në këtë thes të madh, këtë bark të gjithësisë, këtë mitër për gjërat që do të vinë dhe varr për gjërat që kanë qenë, këtë tregim pafund. Në të, si në çdo trillim, ka mjaft vend për të mbajtur edhe Burrin, aty ku e ka vendin, në këtë skemë gjërash; ka mjaft kohë të grumbullosh plot tërshërë të egër dhe ta korrësh po ashtu, dhe t'i këndosh të voglit Om, dhe të dëgjosh shakanë e Olit, dhe të sodisësh hardhucën, dhe prapë tregimi s'ka mbarim. Ka prapë fara për t'u grumbulluar, dhe ka mjaft vend në çantën e yjeve.

Përktheu: Mikela Kakeli

TRAGJEDIA E EMANCIPIIMIT TË GRUAS

Emma Goldman

1906

Do t'ia nis me një pohim: pavarësisht të gjitha teorive politike dhe ekonomike, trajtimit të dallimeve thelbësore ndërmjet grupeve të ndryshme brenda racës njerëzore; pavarësisht dallimeve klasore dhe racore, pavarësisht të gjithë kufijve artificialë midis të drejtave të gruas dhe të burrit, mendoj se ekziston një pikë ku këto dallime mund të bashkohen dhe të shndërrohen në një tërësi të përkryer.

Me këtë nuk kam për qëllim të propozoj një traktat paqeje. Antagonizmi i përgjithshëm shoqëror që sot ka zaptuar gjithë jetën tonë publike, dhe që shpërfaqet nëpërmjet forcës së interesave të kundërta e kontradiktore, do të zhbëhet atëherë kur riorganizimi i jetës sonë shoqërore, bazuar mbi principet e drejtësisë ekonomike, do të jetë bërë realitet.

Paqja dhe harmonia ndërmjet sekseve dhe individëve, jo domosdoshmërisht varet nga barazia e përciptë e qenieve njerëzore dhe as nuk bën thirrje për eliminimin e tipareve dhe veçorive personale. Problemi me të cilin ne përballemi sot, dhe që kërkon zgjidhje në të ardhmen e afërt, është si të jesh vetvetja por në harmoni me të tjerët, si të bashkëndjesh thellë me të tjerët dhe megjithatë të ruash tiparet që të veçojnë. Kjo për mua është baza mbi të cilën masa dhe individi, demokracia dhe individualiteti i vërtetë, burri dhe gruaja, mund të takohen pa përplasje dhe kundërshti. Motoja nuk do duhet të jetë: "Faleni njëri-tjetrin!" por "Kuptojeni njëri-tjetrin!". Thënia aq shpesh e cituar e Madame de Staël: "Të kuptosh gjithçka do të thotë të falësh gjithçka", nuk më ka pëlqyer asnjëherë. Kjo thënie kundërmon si një dhomë rrëfimi. Të falësh një njeri tjetër zgjon idenë e fanatikut hipokrit, por disi superior. Mjafton të kuptosh një njeri tjetër. Pranimi përfaqëson deri diku thelbin e pikëpamjeve të mia mbi emancipimin e gruas dhe efektet e këtij emancipimi mbi të gjithë seksin.

Emancipimi duhet t'i garantojë një gruaje mundësinë për të qenë *njeri* në kuptimin më të vërtetë të fjalës. Gjithçka brenda saj,

që kërkon të pranohet dhe të gjallojë, duhet të shprehet në formën më të plotë; të gjitha barrierat artificiale meritojnë të thyhen dhe rruga drejt lirisë së gjithanshme duhet pastruar nga çdo gjurmë shekullore nënshtrimi dhe skllavërie.

Ky ka qenë qëllimi kryesor i lëvizjes për emancipimin e gruas. Megjithatë, rezultatet e deritanishme vetëm sa e kanë izoluar gruan edhe më tej, dhe e kanë zhvatur atë nga burimet e asaj lumturie që është aq qenësore për të. Emancipimi vetëm së jashtmi e ka shndërruar gruan moderne në një qenie artificiale, që na kujton ato produktet tipike të oborreve franceze, me pemët dekorative, shkurret, piramidat e gjelbëra, rrotat dhe kurorat e stolisura; çdo lloj forme, përveç asaj që arrihet nëpërmjet manifestimit të vlerave të saj të brendshme. Këto bimë të rritura artificialisht të seksit femëror gjenden me shumicë, veçanërisht në të ashtuquajturën sferë intelektuale të jetës sonë.

Liri dhe barazi për gruan! Çfarë shpresash dhe aspiratash zgjuan këto fjalë kur u thanë për herë të parë nga disa prej shpirtave më fisnikë dhe guximtarë të asaj kohe. Dielli me gjithë shkëlqimin dhe lavdinë e tij, do të lindte mbi një botë të re; në këtë botë gruaja do të ishte e lirë të udhëhiqte fatin e saj — një qëllim ky që padyshim meritonte gjithë entuziazmin, guximin, këmbënguljen dhe përpjekjen e vazhdueshme të morisë së jashtëzakonshme të burrave dhe grave pionerë, të cilët rrezikuan gjithçka kundër një bote injorante dhe përplot paragjykime.

Shpresat e mia gjithashtu janë orientuar drejt këtij qëllimi, por mendoj se emancipimi i gruas, ashtu siç interpretohet dhe zbatohet sot, nuk e ka arritur këtë qëllim madhor. Nëse sot një grua dëshiron vërtetë të jetë e lirë, ajo duhet të përballlet me nevojën për t'u emancipuar nga vetë emancipimi. Kjo mund të tingëllojë paradoksale, por është, megjithatë, tepër e vërtetë.

Çfarë ka arritur gruaja përmes emancipimit? Të drejtën e barabartë të votës në disa shtete. A e ka pastruar kjo gjë jetën

tonë politike, sikurse parashikuan shumë përkrahës dashamirës të kauzës? Qartazi, jo. Meqë ra fjala, ka ardhur koha që personat me gjykim të shëndoshë, të mos flasin më për korrupsionin në politikë me një ton naiv e pedant. Korrupsioni në politikë nuk ka të bëjë aspak me moralin apo shthurjen morale të personave të ndryshëm që mirren me politikë. Korrupsionin e udhëheq një motiv krejtësisht material. Politika është reflektimi i botës industriale dhe asaj të biznesit, motot e së cilave janë: “Të marrësh ka më shumë vlerë sesa të japësh”; “bli lirë dhe shit shtrenjtë”; “njëra dorë e fëlliqur, lan tjetrën”. Sot nuk ka më as shpresë se ndoshta gruaja, me të drejtën e saj për të votuar, do të arrijë ta purifikojë ndonjëherë jetën politike.

Emancipimi i ka ofruar gruas barazi ekonomike me burrin, në kuptimin që ajo mund të zgjedhë zanatin dhe profesionin e saj; por, duke qenë se përgatitja e saj fizike, dje dhe sot, nuk e ka pajisur atë me forcën e nevojshme për të konkurruar me burrin, ajo është shpesh e detyruar që t’i shterojë të gjitha energjitë, ta konsumojë të gjithë vitalitetin e saj dhe të tendosë çdo nerv, në mënyrë që të jetë e vlefshme për tregun. Shumë pak prej tyre ia kanë dalë, pasi është fakt se gratë mësuese, mjekte, avokate, arkitekte dhe inxhinieri, as nuk janë mbrujtur me të njëjtin vetëbesim si kolegët e tyre burra dhe as nuk shpërblehen njëlloj si ata për punën që bëjnë. Ndërkohë, ato që e arrijnë barazinë e lakmuar, përgjithësisht, ia dalin në kurriz të mirëqenies së tyre mendore dhe fizike. Përsa i përket masës së gjerë të vajzave dhe grave punëtore, sa pavarësi është fituar nëse kufizimet dhe mungesa e lirisë në shtëpi, thjesht është shkëmbyer me kufizimet dhe mungesën e lirisë në fabrikë, në tezgat e rrobave të lira, në magazinat ushqimore apo të veshmbathjeve, ose në zyrë? Për më tepër, edhe pas një dite të lodhshme pune, shumica e grave mbajnë mbi supe barrën e përkujdesjes për “shtëpinë, të mirën shtëpi” — të akulltë, të zymtë, të parregullt e aspak ftuese. Pavarësia e lavdishme! S’është aspak për t’u çuditur se pse qindra

vajza janë të gatshme të pranojnë ofertën e parë për martesë, pasi u ka ardhur në majë të hundës nga “pavarësia” gjysmake pas banakut, makinës së qepjes apo asaj të shkrimit. Ato janë po aq të gatshme për t’u martuar sa edhe vajzat e shtresës së mesme, të cilat vdesin për t’u kapur për lakun e supremacisë prindërore. Kjo e ashtuquajtur “pavarësi”, që siguron vetëm nivelin më të ulët të mbijetesës, nuk është aq e kënaqshme, dhe as ideale, sa gruaja të sakrifikojë gjithçka për të. Kjo pavarësi e jona, që e kanë ngritur në qiell është, në fund të fundit, veçse një proces që redukton dhe tkurr natyrën e gruas, instiktin e saj të dashurisë dhe të amësisë.

Megjithatë, pozita e vajzës punëtore është shumë më e natyrshme dhe njerëzore sesa ajo e motrës së saj, në dukje më fatlume, që ka zgjedhur rrugë më të kulturuara profesionale në jetë — mësuese, fizikante, avokate, inxhinierë, etj. — të cilat detyrohen të kenë një paraqitje të rregullt dhe sa më dinjtoze, përderisa jeta e tyre nga brenda, tretet e venitet çdo ditë e më shumë.

Mendjengushtësia përsa i përket konceptit ekzistues së pavarësisë dhe emancipimit të gruas; droja nga dashuria për një burrë që i përket një rangu tjetër shoqëror; frika se dashuria do t’ia rrëmbejë asaj lirinë dhe pavarësinë; tmërri se dashuria apo lumturia e amësisë do ta pengojë në ushtrimin e plotë të profesionit të saj — të gjitha këto së bashku, e bëjnë gruan e emancipuar moderne një virgjëreshë të përbetuar, ndërkohë që jeta e saj, mes brengash e gëzimesh, të ashpra e magjepsëse, vazhdon nga dita në ditë, pa ia prekur apo mbërthyer kurrë shpirtin.

Emancipimi, siç kuptohet nga pjesa dërrmuese e përkrahësve dhe eksponentëve të tij më të flaktë, është një sferë tepër e ngushtë që nuk e lejon në vetvete manifestimin e dashurisë së pakusht dhe ekstazën e pafundme që gjendet në ndjenjën e thellë të gruas së vërtetë, të dashur, nënës, në liri.

Tragjedia e mëvetësisë apo pavarësisë ekonomike të gruas, ka të bëjë me faktin se një gjë e tillë është përqëndruar në shumë

pak përvoja. Është e vërtetë se ajo sot e tejkalon motrën e saj të shumë brezave më parë, në njohuritë që ka mbi botën dhe natyrën njerëzore, e pikërisht prej kësaj, ajo e ndien kaq fort mungesën e thelbit të jetës, e asaj çfarë e pasuron në mënyrë të veçantë shpirtin e njeriut dhe pa të cilin, pjesa më e madhe e grave kanë përfunduar thjesht si profesioniste automatike.

Që një gjendje e tillë do të vinte, ishte parashikuar nga ata të cilët e kishin kuptuar se fusha e etikës, vazhdonte të ngërthente ende gërmadhat e kalbura nga koha e superioritetit të padiskutueshëm të burrit; gërmadha që konsiderohen ende të vlefshme. Ç'është më e rëndësishme, një numër i mirë i atyre që e konsiderojnë veten të emancipuar(a), e kanë të pamundur të bashkëjetojnë pa to. Çdo lëvizje që ka për qëllim shkatërrimin e institucioneve ekzistuese dhe zëvendësimin e tyre me diçka më të përparuar, më të përkryer, ka përkrahësit e vet që në teori i qëndrojnë besnikë ideve më radikale por që gjithsesi, në jetën e tyre të përditshme, sillen si ai filistini i rëndomtë i cili nga njëra anë shtretet sikur është i respektuar dhe, nga ana tjetër, ngre zërin e bën zhurmë për të fituar opinionin e mirë të kundërshtarëve të tij. Ka, për shembull, socialistë apo edhe anarkistë, që i janë besnik idesë se prona është e barazvlefshme me grabitjen, por që megjithatë, do t'u mbetej hatri nëse dikush do t'u kishte borxh vlerën e një gjysmë duzinë gjilpërash me kokë.

I njëjti filistin gjendet edhe në lëvizjen për emancipimin e gruas. Gazetarucët dhe shkrimtarët e vakët kanë pasqyruar një imazh të gruas së emancipuar, që do t'i ngrinte qimet përplotë çdo qytetari përsëmbari. Çdo anëtare e lëvizjes për të drejtat e gruas përfytyrohej si një George Sand, që s'e përfillte aspak moralin. Asgjë nuk ishte e shenjtë për të. Ajo s'kishte respekt për marrëdhënien ideale mes një burri dhe një gruaje. Thënë shkurt, sipas tyre, emancipimi kishte të bënte vetëm me një jetë të shkujdesur, plot epsh dhe mëkat, pavarësisht pranisë së

shoqërisë, fesë apo moralit. Eksponentet e të drejtave të gruas u indinjuan për së tepërmi me një personifikim të këtyllë, dhe pa kurrfarë humori, ato mblodhën forcat për të vërtetuar se nuk ishin aq keq sa i kishin portretizuar, përkundrazi. Sigurisht, për aq kohë sa gruaja ishte skllave e burrit, ajo nuk mund të ishte e mirë dhe e dëlirë, por tashmë që ajo ishte e lirë dhe e pavarur, ajo do të vërtetonte se sa e mirë mund të ishte dhe se si ndikimi i saj do të kishte një efekt purifikues të gjitha institucionet shoqërore. Padyshim, lëvizja për të drejtat e gruas ka këputur shumë zinxhirë të vjetër, por nga ana tjetër ajo i ka zëvendësuar ato me pranga të reja. Lëvizja madhështore e emancipimit të vërtetë nuk ka njohur ende një numër të madh grash që do të përballëshin me lirinë pa iu dridhur qerpiku. Vizioni i tyre mendjengushtë dhe puritan e dëboi burrin nga ndjenjat e tyre, duke e reduktuar atë në një personazh trazovaç dhe të dyshimtë, jashtë jetës së tyre emocionale. Burri nuk mund të tolerohej assesi, përveçse si babai i një fëmije, duke qenë se një fëmijë nuk mund të vijë në jetë pa një burrë. Fatmirësisht, as puritanet më të flakta nuk do jenë kurrë mjaftueshëm të fuqishme, sa të vrasin dëshirën jetike për amësi. Por liria e gruas është e lidhur ngushtë me lirinë e burrit dhe shumë nga motrat e mia të ashtuquajtura të emancipuara, duket se e nënvlerësojnë faktin se një fëmijë i lindur në liri, ka nevojë për dashurinë dhe përkushtimin e çdo qenieje njerëzore rreth tij, të burrit sikurse të gruas. Fatkeqësisht, pikërisht një koncept i atillë mendjengushtë ka shkaktuar kaq shumë tragjedi në jetët e burrave dhe grave moderne.

Rreth pesëmbëdhjetë vite më parë erdhi në jetë një vepër nga pena brilante e norvegjezes Laura Marholm, e titulluar “Gruaja, një studim karakteri”. Ajo ishte një ndër të parat që solli në vëmendje boshllëkun dhe mendjengushtësinë e konceptit ekzistues të emancipimit të gruas dhe ndikimin e tij tragjik në jetët e brendshme të grave. Në veprën e saj, Laura Marholm flet për

fatim e disa grave të talentuara dhe të njohura botërisht: gjenialen Eleonora Duse; matematicienen dhe shkrimtaren e madhe Sonya Kovalevskaia; artisten dhe poeteshën Marie Bashkirtzeff, që vdiq aq e re. Përshkrimi i secilës prej jetëve të këtyre grave me një mendësi të jashtëzakonshme, zbulon një shteg të përbashkët të dëshirave të tyre të paplotësuara për një jetë të bukur, të vërtetë, të plotë e në harmoni, si dhe ankthin dhe vetminë që vijnë si pasojë e kësaj mungese. Nëpërmjet këtyre skicave mjeshtërisht psikologjike, nuk mund të mos vërejmë se sa më i lartë të jetë zhvillimi intelektual i një gruaje, aq më pak e mundur do të jetë për të gjetja e partnerit të duhur, i cili do të shquajë tek ajo jo vetëm seksin, por edhe qenien njerëzore, mikeshën, shoqen¹ dhe individualitetin e fortë të saj, dhe që nuk mund dhe nuk do të duhet të humbasë asnjë tipar të karakterit të saj.

Burri i zakonshëm, me vetëmjaftueshmërinë e tij, me manifestimin qesharak të superioritetit patronizues ndaj seksit femëror, përbën një pamundësi për gruan siç e përshkruan Laura Marholm në “Studim karakteri”. Njëlloj i pamundur është për të edhe burri që nuk mund të shquajë asgjë tek ajo, veç inteligjencës dhe gjenialitetit, dhe i cili dështon t’ia zgjojë natyrën prej gruaje.

Një intelekt i pasur dhe një shpirt delikat, janë konsideruar zakonisht attribute të nevojshme për një personalitet të thellë dhe të bukur. Në rastin e gruas moderne, këto attribute shërbejnë si pengesë për pranimin e plotë të qenies së saj. Për më shumë se njëqind vjet, forma e vjetër e martesës, bazuar tek Bibla, “derisa vdekja të na ndajë”, është denoncuar si një institucion që i shërben sovranitetit të burrit mbi gruan, nënshtrimit të saj të plotë ndaj tekave dhe urdhërave të tij, dhe varësisë së saj absolute ndaj tij. Është vërtetuar me herë të tëra, se marrëdhëniet e vjetra martesore,

1. Emma Goldman përdor këtu fjalën “comrade”/“shoqe” që ka një konotacion ideologjik. (shën. i përkth.)

e reduktonin gruan në rolin e shërbëtores së burrit dhe bartëses së fëmijëve të tij. E prapësërapë, ka shumë gra të emancipuara të cilat parapëlqejnë martesën, me të gjitha të metat e saj, në vend të asfiksimit nga një jete prej beqareje: e ngushtë dhe e padurueshme, për shkak të zinxhirëve të paragjykimeve morale dhe shoqërore, që ngulfasin dhe pengojnë jetën e saj.

Ky lloj qëndrimi i luatur, nga ana e shumë grave përparimtare, spjegohet me faktin se ato kurrë nuk e kuptuan se ç'domethënë në të vërtetë emancipimi. Ato menduan se duhej vetëm të fitonin pavarësinë nga tiranitë e jashtme; ndërkohë që tiranët e brendshëm — konvencionet shoqërore dhe etike — shumëfish më të dëmshme për jetë dhe zhvillim, u lanë që të rregulloheshin vetvetiu; dhe ashtu u bë.

Mesa duket këto konvencione kanë gjetur vend për bukuri, tek kokat dhe zemrat e përfaqësueseve më aktive për emancipimin e gruas, ashtu si dikur në kokat dhe zemrat e gjysheve tona. Këta tiranë të brendshëm, qofshin në formën e opinionit publik, apo të drojës se çfarë do të mendojë nëna, vëllai, babai, halla apo ndonjë tjetër familjar; ç'do të thonë znj. Grundi, z. Komstok, punëdhënësi, Bordi i Edukimit? Të gjithë këta njerëz që fusin hundët kudo, këta detektivë moralë, xhandarë të shpirtit njerëzor, ç'do të thonë ata? Nëse një grua nuk arrin të mësojë si t'i shpërfillë këta zëra, se si të mos bëjë asnjë kompromis, dhe të këmbëngulë deri në fund mbi lirinë e saj; se si ta dëgjojë pra zërin e natyrës së saj, edhe kur ky zë thërret për zbulimin e thesarit më të madh të jetës, për dashurinë për një burrë, apo për privilegjin e saj më të lavdishëm, të drejtën për të sjellë në jetë një fëmijë, ajo nuk mund ta quajë veten të emancipuar. Sa gra të emancipuara e kanë guximin e duhur për ta pranuar zërin e dashurisë që thërret, që rreh furishëm brenda gjoksit të tyre, që kërkon të dëgjohej, të plotësohet.

Shkrimtari francez Jean Reibrach, në një nga novelat e tij të titulluar *New Beauty* (Bukuria e re), tenton të përshkruajë

gruan e përkryer, të bukur dhe të emancipuar. Ky ideal trupëzohet në një vajzë të re, një fizikante. Ajo flet plot zgjuarësi dhe mençuri se si ushqehen foshnjat; ajo është zemërmirë dhe u ofron ilaçe falas nënave të varfëra. Ajo përfshihet në bisedë me një djalë të ri, një të njohurin e saj, mbi kushtet sanitare të së ardhmes, dhe sesi bakteret dhe mikrobet do të zhduken nëpërmjet përdorimit të mureve dhe dyshemeve prej guri dhe nga heqja dorë prej qilimave dhe perdeve. Sigurisht, ajo vishet në një mënyrë të thjeshtë dhe të rëndomtë, kryesisht me të zeza. Burri i ri, i cili qysh në takimin e tyre të parë mrekullohet nga mençuria e shoqes së tij të emancipuar, dalëngadalë fillon ta kuptojë atë, dhe një ditë të bukur zbulon se ka rënë në dashuri. Ata janë të rinj dhe ajo është zemërmirë dhe e bukur. Edhe pse vishet në mënyrë serioze, jaka dhe mëngët e bardha qelibar të këmishës së saj, ia zbusin pamjen. Do të ishte e pritshme që ai t'ia rrëfente vajzës dashurinë që ndjen për të, por djali nuk është nga ata që përfshihen në absurditete romantike. Poezia dhe zjarri i dashurisë fshehin skuqjen e fytyrës së tyre, kur janë përballë bukurisë së dëlirë të zonjës. Ai e shuan zërin e brendshëm, dhe mbetet korrekt. Ajo gjithashtu është gjithmonë e saktë, e arsyeshme, e sjellshme. Kam frikë se nëse do të bëheshin bashkë, ai me shumë gjasë do të ngrinte nga i ftohti. Më duhet ta pranoj se nuk shoh asgjë të bukur te kjo *bukuri e re*, me ftohtësinë e saj prej dyshemeve dhe mureve prej guri, për të cilat ajo vet ëndërron. Në vend të kësaj korrektësie dhe sjellje të matur me kandar, parapëlqej shumë më shumë, këngët e dashurisë së epokës romantike, një Don Juan apo një Madame Venus, preferoj ikjet me një litar të hedhur nga ballkoni mes natës me hënë, mes mallkimeve të babait, rënkimeve të nënës dhe llafeve të komshinjve që gjykojnë. Nëse në dashuri nuk jep e merr pa u kursyer, ajo nuk është dashuri, por një transaksion që mat çdo qindarkë.

E meta më e madhe e emancipimit sot qëndron në ngurtësinë artificiale të tij dhe në ngushtësinë e mirësjelljes

konvencionale, që krijon një zbrazëti në shpirtin e gruas dhe e pengon atë të pijë nga burimi i jetës. E pata thënë diku se më e thellë më duket marrëdhënia mes një nëne dhe nikoqire me botëkuptime të vjetra, e cila kujdeset në çdo moment për lumturinë e të vegjëleve dhe të afërmeve të saj, dhe një gruaje të re; sesa mes kësaj të fundit dhe simotrës së saj relativisht të emancipuar. Dishepujt e emancipimit, shkurt e prerazi, më quajtën heretike, të denjë vetëm për turrë të druve. Zelli i tyre i verbër nuk i la të shihnin se krahasimi që unë bëra ndërmjet të vjetrës dhe të resë, kishte për qëllim thjesht të tregonte se në gjakun e shumicës së gjysheve tona të mira, ka pasur më shumë jetë, më shumë humor dhe ironi, dhe sigurisht më shumë natyralitet, dhembshuri dhe thjeshtësi, krahasuar me shumicën e grave të emancipuara dhe profesioniste, të cilat mbushin shkollat e larta, sallat e leksioneve dhe zyrat e ndryshme. Kjo gjë nuk shpreh dëshirën për t'u rikthyer në të kaluarën, e as nuk e degdis gruan në botën e vjetër të kuzhinës dhe përkujdesjes për të tjerët.

Shpëtimin mund ta gjejmë tek marshimi i palodhur përpara, drejt një të ardhmeje më të qartë dhe më të ndritur. Kemi nevojë të na lënë të rritemi pa na frenuar traditat dhe zakonet e vjetra. Deri sot, lëvizja për emancipimin e gruas e ka hedhur vetëm hapin e parë në këtë drejtim. Ka shpresë se ajo do të gjejë forcën për të hedhur edhe një tjetër hap. E drejta për të votuar, apo të drejtat civile të barabarta, mund të jenë kërkesa të mira, por emancipimi i vërtetë nuk fillon as të sondazhet, dhe as në gjykata. Emancipimi fillon në shpirtin e gruas. Historia na mëson se çdo klasë e shtypur e ka fituar lirinë e vërtetë duke bërë përpjekje. Është e rëndësishme që gruaja ta ketë parasysh këtë mësim, që ajo të kuptojë se liria e saj do të shkojë aq larg, sa shkon edhe fuqia e saj për ta fituar këtë liri. Është shumë më e rëndësishme, rrjedhimisht, që për të nisur ripërtëritjen e saj të brendshme, ajo të çlirohet nga pesha e paragjykimeve, traditave dhe zakoneve.

Është e drejtë që të kërkohet barazi e plotë në çdo aspekt të jetës; por, në fund të fundit, e drejta më themelore, është ajo për të dashuruar, dhe për t'u dashuruar. Ndaj, nëse emancipimi gjysmak do të shndërrohej në emancipim të plotë dhe të vërtetë të gruas, ajo do të duhej që të hiqte dorë nga nocioni qesharak se të dashurohesh, të jesh e dashur dhe nënë, është sinonim i të qenurit skllave dhe e nënshtruar. Asaj do t'i duhej të hiqte dorë nga nocioni absurd i dualizmit të sekseve, apo i idesë se burri dhe gruaja përfaqësojnë dy botë antagonistë.

Vogëlsia përçan, gjerësia bashkon. Le të jemi të hapura dhe të mëdha. Le të mos i anashkalojmë gjërat e rëndësishme për shkak të një grushti imtësirash me të cilat përballemi. Një konceptim i drejtë i marrëdhënies së sekseve nuk pranon pushtues dhe të pushtuar; por njeh diçka madhore: të japësh nga vetja pakushte, në mënyrë që ta gjesh veten më të pasur, më të thellë, më të mirë. Vetëm kjo mund ta mbushë zbrazëtinë, dhe ta shndërrojë tragjedinë e emancipimit të gruas në kënaqësi, në kënaqësi të pakufishme.

Përktheu: Gresa Hasa

MIDIS PËRGJITHMONË & KUDO KU JE: NJË TRANS POETIKË JO BINARE

xtian w

2018

I

Dëshira, duke qenë

gjëja më e natyrshme. Brenda & jashtë ëndrrës, asgjë nuk paraprin. Çfarë mund t'i paraprijë dëshirës? As dridhjet e rrahjes së zemrës, dhe as keqfunksionimi digjital blu i kutive & ekraneve. Lutu në gjunjët varrë për tjetrën ditë, për orën, minutin e çastin që vjen sa hap e mbyll sytë, për pritshmëritë që kalojnë, & që mbesin, dëshira që kapërcen kufi (rraskapitëse, e papërfillshme) të mban përherë në lëvizje.

Midis dritës së kapur të hënës & diellit, ku e vendos gjininë? Ajri & uji përzihen me baltën, i japin formë mishit deri në kockë, por shto shenja kafshimi & trupat thyhen të pambaruar. #Poetika. Ti e di se je një trup & se trupat kanë kuptim, se mbajnë kohën e tyre, se masin & harrojnë përkundër tërheqjes së pamëshirshme. Ja ku je, me dëshirën për pyetje, & por në një gjuhë që pothuajse nuk ekziston.

Përvojat TRANS jetët TRANS janë

forma të përkushtimit të mishëruara ndaj, & dëshirë për, mundësinë. Ti zbrasesh & zbrasesh & vazhdon të zbrasesh përtej polariteteve që nuk janë vërtet reale. Çfarë do të kapi? betoni grushti grila; butësia apo foleja e qetësisë, një trup tjetër apo ndonjë faqe? Ti pyet se si mund të veprojë poetika TRANS, se si mund të lëvizti poetika JO BINARE TRANS. Ti vallëzon vallëzon tund bythën se trupi tashmë e di, & ke ardhur këtu të dëgjosh & lëvizësh, të ndalosh vallëzimin për të marrë frymë & aty + këtu të shkruash. Për ty, shkrimi krijon reflektim, bën pyetjet e duhura, bart trupin e pyetjeve

në një moment në kohë. Por TBH,¹

a pyet veten ndonjëherë nëse ti ekziston apo jo në hapësirën e gjuhës që të ka ngecur mu në fyt? A do të doje, po të kishe mundësi, apo po të arrijë gjuha jote të mësojë t'i rrotullojë tingujt ndryshe? Po t'i përgjigjesh me jo njërës prej pyetjeve, atëherë ku do të gjejë vend trupi jot, vetja jote? #TFW²

Të jesh QUEER është një vendndodhje

përtej kufijve të vendeve. Hartografi e skicuar me bojë të fshehtë, që ndonjëherë shihet nga majat e botëve *më të pranueshme*. Por trupi e di. Trupi e di. Trupi bën fakte arti për t'i kujtuar botës se çfarë i kushton një trupi të dijë. Pyesni.

Shkrimi = praktikë somatike, diçka që e bëni me trupin tuaj. Autorësia është një vend nga ku lëvizjet e shkrimit materializohen. TRANS ndërlidhje. Shkrimi është një formë e drejtpërdrejtë e PËRKTHIMIT të trupit në fjalë mbi sipërfaqe. Me sy prek faqen & zbrasesh. Oooiiii, një sipërfaqe tjetër! Një lloj trupi tjetër, në lindje. Lëvizje e vazhdueshme, vazhdimësi e thellë. Dije që zbret poshtë krahut tek gishtërinjtë e dorës dhe tutje jashtë & jashtë...

Të shkruash trupin JO-BINAR, trupin midis & përtej trupave, është t'i japësh vetes leje për të minuar trupat për të cilat është rënë dakord që të mund të prekësh trupin që gjallon. Të shtrosh pyetje mbi trupin me një gjuhë të pamjaftueshme për përgjigje. Të bësh pyetje rreth shkrimit që nuk arrin të shkruhet kur nuk kemi gjuhë për trupat tanë.

1. TBH = to be honest (të jem e sinqertë). (shën. i përkth.)

2. TFW = that feeling when (ajo ndjenja kur). (shën. i përkth.)

Duke mos pasur gjuhë për trupin tanë, (wtaf³)
 realiteti hetero gjithmonë = dhunë)
 ne dëshirojmë të krijohemi vazhdimisht përmes hapësirave së asaj
 ÇKA NUK ËSHTË ATY. Parë nga jashtë, poetikat & estetikat TRANS
 JO BINARE janë një mohim i përhershëm; refuzim i gjetjes së
 vetvetes, komunitet, & punë brenda kufijve të projekteve që ndërtojnë
 identitete heteronormative, të njohura ndryshe edhe si distopi. Ne
 plotësojmë atë çfarë mungon, si fryma primordiale që noton mbi
 ujërat e lira. Në këtë vend, do të ngatërrosh rrugë, e çorientuar,
 do të kthehesh mbrapsht; do të kthesh kokën, do të gjesh familje,
 do t'i kthehesh trupit, ndihesh e huaj; do t'a flakësh stilolapsin ose
 tastierën për të tundur ijet; të qish e të qihesh; të derdhesh & LOL.⁴
 Këtu, shkëlqimi zhvendos përkohësinë ashtu si kur godet atë që
 është Queer: nuk është se bëhet gjithmonë e më mirë, por bëhet
 (#tëlutemmosvdisështënjëmënyrëtjetëpërtëthënësetëdua). Koha
 TRANS nuk dëshiron pika konvergjente, dëshiron t'i tërheqë dhe t'i
 zgjasë ato, megjithëse ndonjëherë forcat mund të të frenojnë. Bota
 gjithmonë kërcënon të të frenojë.

Lëvizje e përhershme, vazhdimësi e thellë, fantazma, t'i mbash.
 Bashkë ne nuk do të arrijmë atje sepse ne nuk lëvizim drejt një
 pikëmbërritje. Të lirë, të paprekshëm! Ndiz një buzëqeshje që di.
 Shpresoj të takohemi diku & dhe të puthemi në shi, gjuhët tona të
 shkëmbejnë fjalë.

Të shkruash trupin në TRANZICION është diçka që ti e bën me
 gjithë trupin.

3. WTAF = what the actual fuck (kur e mendon çfarë drejtin). (shën. i përkth.)

4. LOL = laugh out loud (qesh me zë). (shën. i përkth.)

PUSHIM:

Art Queer nga artistë Queer për njerëz Queer.

A ka poetikë specifike që ka të bëjë me TRANSART, apo me mënyrën se si e jeton jetën? Pra çka vjen së pari, të qenit TRANS apo të dish diçka LOL?!?

II

Si të shkruash një trup të paqëndrueshëm? Nuk ka përgjigje për këtë pyetje, & kështu poetikë Trans Jo Binare mund të jetë çdolloj praktike — prodhuese, trans-disiplinore, somatike, përherë subversive — që kërkon një proces pambarim që shtron pyetje.

Në proces, kur shoh një identitet në formim, e kuptoj nëse pyetja ime nuk shkon aq thellë sa duhet, se përmban në vetvete njëfarë bote heteronormative brenda së cilës jam plotësisht e painteresuar dhe e paaftë të jetoj. Kjo nuk do të thotë se gjatë procesit krijues nuk merren disa vendime, por se duhet të përpiqesh vazhdimisht për të imagjinuar & krijuar hapësirë për më shumë mundësi. Teksa një vepër merr formë(a) nga vendimet e akumuluar, mbase kupton se zgjedhja që ke bërë para tre potencialesh është e kufizuar. Për fat të mirë: TRANS JO BINARJA, me lirinë për të copëzuar & për t'u rifutur në proces kudo, kurdo që t'ju dojë bytha. hahahaha!

Në një mënyrë ose tjetër, dua të më lexojnë për shpërfilljen time ndaj lexueshmërisë (moslexueshmëria si një nga përkufizimet e të qenurit QUEER).

Pavarësisht mediumit, proceset e mia kanë ngjashmëri, vetëm se janë të PËRKTHYERA. Unë jam gjithmonë duke përkthyer. Jeta Jo-binare, si art, është thjesht një proces në tranzicion, por që jo vetëm nuk ka fund, por, duke mos pasur një pikëmbërritje, nuk kërkon

fund. Pra je gjithmonë duke PËRKTHYER.

Krijoj art për të formuluar një (disa) pyetje për veten time & komunitetin tim, për të thënë *se ekziston një problem, një rrezik, një lak, diçka që kërkon punë (nëse jo gjatë gjithë kohës)*, & prej aty, mediumi shqyrton pyetjen. Kur unë kam bërë punën time mirë, kur ti ke bërë punën tënde mirë, atëherë materiali që një ditë në “fund” të procesit do të quhet “art” (arti është çdo draft, çdo shënim, çdo lexim i melodisë apo i pjesës së koreografisë tarallake që dështon, çdo komunikim me shkrim, argument, ose rrugë për të ngrënë darkë pas provave) duhet diku të funksionojë, diku të dështojë, & të ngrejë më shumë pyetje mbi të cilat mund të vazhdojmë të ndërtojmë, pra të pyesim, pra TRANS-. Nëse nuk ka mbetje, nuk ka ndodhur.

Aq shpesh, trupi im jeta ime praktika ime përjetohen si një rrjedhë e turbullt mbetjesh & si pikëpyetje. Pyes veten, kush mund ta dashurojë një? shënjojë, lexojë një? Shëno, kupto një pyetje që kërkon vetëm të bëjë pyetje të tjera. Jeta ime ndërtohet rreth kësaj strukture të jostrukturuar, gjinije të pagjini, & mbi këtë hartë që ngashënen, ky proces krijues dëshiron një *ja ku jam*. Ti ku je? WYD?⁵

Të jesh Queer është një mundësi. E përjetoj veten si TRANS JO BINARE FEMËRORE. Është një mënyrë për të fokusuar kuriozitetin tim, dëshirat e mia, të gjitha gjërat që trupi im i di. Për aq sa etiketat nuk kanë kuptim sa i përket identitetit jo binar, ato mund të krijojnë lidhje përmes përvojës së përkohshme. Unë jam gjithmonë Jo Binare, jam gjithmonë Tranzicion, & ato Transformime, në shumë mënyra, gjejnë rrënjë, mençuri, drejtim & frymëzim, nën ombrellën masive kulturore somatike, & nën ombrellën e ditur të femërores.

5. WYD = what you doing (çka po bën). (shën. i përkth.)

Dëshira, duke qenë gjëja më e natyrshme, është pikënisja.

JO BINARJA është një formë e përkushtimit ndaj mundësisë së ndryshueshme.

SOLIDARITETI me TRANZICIONIN është PËRGJITHMONË

III

Tranzicioni është përherë një poetikë midis përgjithmonë & kudo ku je.

Përktheu: Silvi Naçi

RAPORTIM NGA BAHAMAS

June Jordan

1982

Jam vendosur në një hotel që e quan veten Sheratoni Kolonial Britanik. Në njërën prej reklamave të hotelit është fotografia e një burri të zi në moshë të mesme, veshur me një kostum *tuxedo*, që buzëqesh. Më ngacmon kjo fotografi më së shumti për këtë arsye: një burrë i zi mban mbi supin e tij të majtë një tabaka plot me kokteje “shumë-ngjyrëshe”, ndërkohë që të dyja këmbët, bashkë me këpucë e pantallona, pothuajse deri në gju, i ka futur në ujin e kripur e “shumë-ngjyrësh” të Karaibeve. Pra, nga kënaqësia që po shërben, ai është i gatshëm me të hidhet në ujë dhe të të shërbejë një daikiri me banane ndërkohë që ti noton! Thënë më saktë, ai do të hidhet në ujë ashtu siç është, pa menduar dy herë se mund t'i dëmtojë këpucët, pantallonat apo shëndetin e tij, dhe do ta bëjë edhe me buzëqeshje.

Jam në Bahamas. Pranë telefonit të dhomës sime është një katalog me faqe të plastifikuara rreth një spine, me një listë informatash të dobishme për MAKINA ME QIRA dhe KAZINO. Diku nga mesi i këtij katalogu këshillues për turistë, shfaqet një mesazh i Ministrisë së Turizmit që hapet me fjalën “MIRËSEVINI” dhe më poshtë pason “NJË FAQE HISTORI” në të cilën shkruhet si vijon:

Historia e Botës së Re fillon në të njëjtën ditë kur fillon edhe historia bahamase — më 12 tetor 1492. Kjo është data kur Kolombi zbarkoi në breg — Ndikimi britanik erdhi fillimisht me aventurierët eleuterianë më 1647 — Pas Revolucioneve, luajalistët amerikanë u larguan nga shtetet që sapo kishin shpallur pavarësinë, dhe u vendosën në Bahamas. Udhëheqësit-kundërshtarë të konfederatës e përdorën ishullin si një parajsë gjatë Luftës mes Shteteve, dhe pas Luftës, shumë jugorë u zhvendosën në Bahamas...

Ja ku na del përsëri. Diçka që vetëshpallet histori legjitime, ndërkohë që ndjek vetëm gjurmët e të bardhit z. Kolombi, më pas ato të elutearianëve britanik, deri te jugorët e konfederatës, ku ata

përplasheshin me dallgët e Botës së Re, zbarkonin në tokën e Botës së Re, dhe askush nuk e thotë as një fjalë të vetme për njerëzit bahamas, të zinj të e këtij vendi, për të cilët e vetmja gjë e re në ishullin e tyre ishte kjo hallkë e çuditshme furacakësh të pagdhendur dhe pasojat koloniale që ata sollën.

Kjo është ndërgjegjja ime racore, teksa nxjerr nga valixhja rrobat e plazhit, në një Sheraton Kolonial Britanik. As ky hotel, e as britanikët, e as italianët para shumë kohësh, e as pilotët e bardhë të avionit Delta, sigurisht, nuk e kanë vendin këtu. Dhe sa herë e shoh fotografinë e atij të çmendurit me këmbë në det, më vjen të plas nga inati im prej indianeje perëndimore, megjithëse e di mirë se ai nuk është thjesht një i çmendur; ai është një burrë i zi i moshës së mesme, që ka nevojë për punë — dhe puna e tij është të shtiret si një shërbëtor i përkushtuar ndaj kënaqësive të të pasurve. (Krahasuar me mundësitë e tij në jetë, edhe unë jam një grua e pasur. Krahasuar me shumicën e afro-amerikanëve që janë këtu në këtë fundjavë Pashkësh, falë një pakete të lirë turistike tre-netëshe e katër-ditëshe, ky kamarier është një burrë i zi dhe i varfër).

Do t'i fërkojmë brrylat këto ditë me turistë të tjerë (të bardhë) nëpër dyqane suveniresh apo kur ne, të zinjë e të bardhë amerikanë bashkë, duke qeshur me një zë, do të mësojmë se si bëhet pazar dhe si t'i ulim sa më shumë çmimet e produkteve artizanale që shiten në tregun e kashtës, aty ku tregtarët, kryesisht gra të zeza pa dhëmbë, të ulura mbi beton e të veshura me fustanin e tyre më të mirë, do t'i përgjigjen kësaj lojës tonë të pandershme:

“Po? A të pëlqen? Tetë dollarë.”

“Pesë.”

“Ta jap unë. Merre për shtatë.”

Dhe kështu vazhdon kjo punë, kjo hallkë e çuditshme furacakësh të pagdhendur, ku sot, bashkë me motrat dhe vëllezërit e mi veriorë, marr pjesë edhe unë.

Kjo është ndërgjegjja ime klasore, teksa bëj llogari se sa

para mund të shpenzoj në dhurata bahamase për familjen time në Brooklyn. Ani se këto gra të zeza thurrin pareshtur fjalë e lule nëpër kapela e çanta prej kashte që i kanë renditë aty pranë vetes, mbi pluhurin e kësaj rrugice që përcëllon. Ani se këto gra të zeza si unë, për të fituar bukën e gojës, shkrijnë gjithë ndjeshmërinë e tyre për të bukurën, në këto gjësende që ne i blejmë me çmim sa më të lirë.

Ne, megjithatë, nuk jemi të bardhë. Buxhetin e kemi të kufizuar. Kohën tonë e shtyjmë padëmshëmrisht duke pi ponç me rum te pishina dhe duke pa “Shfaqjen Vendase te Oborri i Madh”, që jepet sonte jashtë restorantit të hotelit.

Kjo është ndërgjegja ime e racës, e klasës dhe e identitetit gjinor, teksa vërej se sa e ngurtë është marrëdhënia mes këtyre grave të zeza dhe vetes time. Ato shesin, ndërsa une blej ose nuk blej. Ato rrezikojnë të mbesin pa ngrënë. Unë rrezikoj të ngelem pa kokërr leku, qysh në pasditen e parë të pushimit tim.

Ne nuk jemi më specifikisht gra; ne jemi palë të një transaksioni që është krijuar për të na vendosur kundër njëra-tjetrës.

“Ullire” quhet gruaja e zezë që pastron dhomën time të hotelit. Rrugës për në plazh mendoj me vete se çfarë do të mendonte “Ullirja” po t’i tregoja arsyet pse po rri tek ky Sheraton Kolonial Britanik; nëse i them se doja të notoja. Doja të flija. Nuk doja të më ngacmonte kamarieri në meso-moshë, e as nipi i tij. Nuk doja të më përdhunonte askush (as i bardhë, as i zi) dhe ma mori mendja se siguria ime, si një grua e zezë që udhëton vetëm, do të ishte më e madhe nëse hoteli im i përket një korporate ndërkombëtare. Përvoja më thotë se të mëdhenjtë i marrin ankesat e klientëve shumë më seriozisht sesa të vegjlit. Mendja më thotë se kjo është edhe një nga arsyet pse ata janë të mëdhenj; atyre nuk u pëlqen të humbasin as edhe një cent, po aq sa nuk më pëlqen mua të më trazojë dikush kur lexoj librin tim nën hijen e palmës ku jam shtrirë falë 264 dollarëve që kam paguar. Që një grua e zezë të gjejë strehim tek një korporatë ndërkombëtare është një kontradiktë

në vetvete, por, ja ku jam. Në rastin tim kjo është një rastësi e bazuar në interesa krejt të kundërta: Sheratoni/para *në dorë* = siguri e përkohshme për mua, June Jordan.

Sidoqoftë, jam e sigurtë që në sytë e “Ullires” unë jam dikush që vjen nga një vend i largët si Brooklyn-i. Në një moment, duke mbledhur, me të drejtë, fshesën e saj me korrent nga dhoma ime, ajo me shumë gjasë do t'i lejoj vetes një pyetje që po e bren: “Po pse ke ardhë deri këtu vetëm, pa burrin tënd?”

Nuk mundem as ta imagjinoj se si do të filloja t'i përgjigjem.

T'i flas për “të drejtat” e mia, “lirinë” time, dhe “dëshirën” time, si dhe për një mori vlerash të tjera nga Bota e Re; si do t'i tingëllonin këto një gruaja të zezë e cila në kartelën e vendosur mbi tryezën e shkrimit në dhomën time të hotelit përshkruhet si “Shërbyesja Ullire”? “Ullirja” është më e madhe se unë në moshë dhe ndërkohë që ajo ndërron çarçafët e mi, unë mund të pi një cigare. Pra, të drejtat e kujt? Liria e kujt? Dëshira e kujt?

Dhe pse duhet t'i interesojë asaj për të miat, nëse unë nuk bëj diçka, të vërtetë, për të sajat?

Ndodhi që libri që e lexova nën hijen e palmës, ishte romani *The Bread Givers* (Ata që japin bukë) nga Anzia Yeziarska. Libër ky pa dyshim autobiografik, ku Yeziarska përshkruan sa e vështirë është të jesh femër, por edhe thjesht “një person”, në një familje tradicionale hebreje në fillim të shekullit 20-të. Rrallë ose kurrë nuk dëgjojmë për gra hebreje, që kanë bërë jetë më të mirë sesa thjesht shërbëtoreshë të keqtrajtuara nga babai apo nga bashkëshorti. Por ja që Yeziarska ka arritur të bëjë më shumë me jetën e saj. Në *The Bread Givers*, heroina e librit arrin me sukses t'i shpëtojë deri diku fatit të një femre që vjen nga një traditë hebraike. Dhe a nuk mu duk se e pashë tek babai i saj i pamëshirshëm e despotik, studiues i Talmudit dhe i familjes hebreje, babain tim, dhe ndjeva urrejtje të dyfishtë, përsëri? Kur heroina, si fëmijë i vogël hebre, përhumbet nëpër rrugë duke shitur peshk harenga në një kovë të ndryshkur, që

e ka huazuar për t'i ndihmuar familjes me qiranë në geto, dhe kur ajo klithë: "Asgjë nuk kishim në shtëpi, po të mos isha unë, përveç urisë, dhe as bukë për të ngrënë po të mos shisja unë harenga. Jo si zjarr me motorr, por si një tufë gojësh të uritura me zemër bërtisja 'harenga-harenga! Dy cent, një copë!'", nuk ka asnjë dyshim se një bisede prej motrash do të ishte krejt e mundur, mes asaj vajze të bardhë dhe atyre grave të zeza që shesin çanta kashte nëpër rrugicat e parajsës, sepse asnjëra palë nuk e dëshiron vdekjen? Dhe a nuk është krejt e qartë se gruaja e atij studiuesit të Talmudit dhe "Ullirja" që pastron dhomën time të hotelit, kanë më shumë gjëra të përbashkëta me njëra-tjetrën, sesa me mua?

Kjo është ndërgjegja ime e racës, e klasës, dhe e identitetit gjinor, teksa mbledh peshqirin e lagur, syzet e diellit, orën e dorës, dhe nisem për të bërë një dush.

Më vjen ndërmend djali që ma pati dhënë ta lexoj këtë roman. Ai është i bardhë, hebre, dhe pjesë e një projekti të pavaruar studimi me mua, në Universitetin Shtetëror ku unë jap mësim, dua apo s'dua, ku punoj tërë kohës sepse, edhe unë si ai kamarieri, kam mend në kokë. Kjo është puna ime, dhe më duhet ose të punoj ose të heq dorë nga të mirat materiale që na vijnë nga paratë. Ky djalë ma kishte dhënë romanin me idenë se mua më intereson të di se si një shkrimtare amerikano-hebreje e përdorë anglishten në atë formë, sa sintaksa, dhe rrjedhimisht shprehitë kulturore të mendjes që shprehen në jidisht, t'i mbijetojnë përkthimit. Ma kishte dhënë librin me dëshirën për të krijuar një lidhje mes nesh që ka të bëjë me gjuhën, me njohurinë/dashurinë e tij për jidishten dhe njohurinë/dashurinë time për anglishten e zezë.

Ai kishte të drejtë për mbijetesën e fuqishme të jidishtes. U emocionova nga ekzistenca e këtij lloj shkrimi që ngërthen zërin e gjuhës së folur, të pacënuar nga monodroni i anglishtes "standarde", dhe kjo rrethanë sikur na afroi edhe më shumë. Por pak më vonë, kur filluam një bisedë mbi jetën studentore në përgjithësi, kuptova

se këtij studenti nuk i interesonte aspak që Programi Shtetëror Federal i Huave Studentore ishte në rrezik, sepse, siç ma tha edhe vetë, ndryshimet në këtë program nuk e prekjin atë. Atij i ndihmonte familja e tij dhe ai nuk kishte nevojë për ndihmë tjetër financiare. Por, djali im është i zi. Dhe unë jam e vetmja ndihmë familjare që ai ka, që do të thotë se nëse Regani arrin të eliminojë me sukses programin federal të ndihmave për studentë minoritarë, biri im duhet ta harrojë vazhdimin e studimeve, sepse, ose ai ose unë, ose të dy bashkë, do të prekim shifra që nuk mund t'i përballojmë. Edhe pse biseda jonë vazhdoi, dallimet mes nesh sikur na larguan më shumë nga njëri-tjetri.

Ndërgjegjja ime i kthehet edhe një herë racës, por edhe klasës.

Pak javë më vonë, te e njëjta karriker ku kishte qenë i ulur djali, më erdhi në zyrë një studente e imja masteri për të diskutuar notën e saj. I thashë fjalët më të mira, se sa e shkëlqyer ishte puna e saj përfundimtare që kishte dorëzuar; në fakt, më ishte dukur një shkrimje e jashtëzakonshme e hulumtimeve të fundit mbi trurin e majtë/trurin e djathtë, dhe e motiveve të poezisë transhendentale.

Ajo, në anën tjetër, më tha se i kishte lexuar esetë e mia politike. “Je shumë me fat”, më tha.

“Çfarë do të thuash me fat?”

“Ti ke një kauzë. Ke një qëllim në jetë.”

E pashë me kujdes këtë grua të bardhë; çfarë po më thoshte?

“Në çfarë kuptimi?”, e pyeta edhe njëherë.

“Varfëria. Dhuna policore. Diskriminimi në përgjithësi.”

(Oh zot, mendova me vete: kështu e mendon fatlumen kjo?)

“Po ti si ndihesh?”, e pyeta.

“Unë?”

“Po, ti. A nuk ke edhe ti një kauzë?”

“Unë? Unë s’jam askush, pos një grua e bardhë në moshë të mesme: grua e shtëpisë dhe nënë.”

Për njëfarë kohe, nuk thash asnjë fjalë.

Pikë së pari, nëse flasim për racën, klasën dhe për gjininë me një frymë, çfarë ajo nënkuptonte me të sajën ishte se këto preokupime fatlume të miat, që nga dhuna policore e deri te shfarosja nukleare, nuk i përkisnin asaj. Pra, ato ishin të miat, por jo të saj. Por, ja ku ishte, e ulur përballë meje, e dashur si një arush i përdorur gëzofi, që më rrezaton vullnet të mirë dhe më uron “fat”.

Së dyti, me këto fjalë, kjo grua e bardhë nënkuptonte se ajo nuk e perceptonte veten e saj si “një person”, sepse ajo tashmë e kishte përmbushur rolin e saj tradicional të një femre, rol ky që babai i hebrejes imigrante, Anzia Yeziarska-s, e çmonte deri në qiell. Gruaja përballë meje nuk ishte hebreje. Kjo nuk ishte lidhja mes tyre. Lidhja mes tyre ishte ekskluzivisht femërore. Megjithatë, si mund të krijonim unë dhe kjo grua, një lidhje femërore mes nesh, përtej kësaj bisede të çuditshme?

Nëse ajo beson se unë kam fatin të përballem rregullisht me pengesa diskriminuese, atëherë pse mos të insistoj edhe unë se, në fakt, ishte ajo që kishte fatin e mirë, si një grua e bardhë anglo-saksone që jeton në rehatinë e saj normative dhe të mirërregulluar, sa ka edhe luksin ta mohojë pushtetin e privilegjeve që ajo gëzon dhe që ja kanë paralizuar jetën?

Nëse ajo më braktisë mua dhe “kauzën time” aty ku ne dallojmë, nëse, për shembull, ajo më lë mua vetëm me problemet “e mia” të racës, atëherë pse duhet ta mbështes unë atë në problemet “e saj”, si një shtëpiake që e kanë lënë në harresë?

Ky moment më bie ndërmend teksa lahem në banjor që ka pastruar “Ullirja”. Mendoj për gjithë kurrikulën e Studimeve të Grave, që nuk kanë të bëjnë aspak me “Ulliren” e as me punën e saj; atë nuk do ta gjeni të përmendet askund në listën e leximeve. Me shumë gjasë, rrallë apo kurrë, nuk do të dëgjoni as për Anzia Yeziarska-n. Por, sigurisht, do të gjeni emra si Florence Nightingale e deri te Adrienne Rich, një vargan shkrimtaresh gra të bardha,

të pavarura dhe të suksesshme. (Gertrude Stein/Virginia Woolf/ Hilda Doolittle janë vetëm disa nga emrat më të shpeshtë në listën “themelore” të shkrimtareve gra.)

Me fjalë të tjera, shumica e grave të kësaj bote — të zeza e nga bota e zhvilluar e të bardha e që punojmë se nuk kemi rrugëdalje tjetër — pra, pjesa dërrmuese e grave të botës janë lënë jashtë përmbajtjes së mësimëve në departamentet e Studimeve të Grave.

Ngjashëm, një lëndë e zakonshme e Historisë së Zezë, përjashton një pjesë të madhe të asaj përvoje që pretendon ta përfaqësojë. Për shembull, Mary McLeod Bethune nuk merr kurrë aq vëmendje sa Nat Turner, edhe pse numri i grave të zeza që plot guxim e mençuri kanë dhënë aq shumë për arsimimin e të zinjëve, është shumëherë më i lartë se numri i burrave të zinj që kanë organizuar kryengritje, herë me fitore e herë me humbje, kundër skllavërisë. Në fakt, emri i Mary McLeod Bethune nuk nderohet, sepse Historia e Zezë imiton lëndët qesharake të historisë së të bardhëve, të cilat prodhojnë mbeturina si “historia” e Sheratonit Britanik Kolonial në Bahamas. Lëndët e historisë, e të bardhëve dhe e të zinjëve, nuk marrin parasysh ato që nuk kanë vrarë e nuk kanë pushtuar asnjëri për të krijuar një identitet të ri, ato që janë kujdesur për çdo njeri që ka dashur të jetë “një person”, ato që vazhdojnë edhe sot të kujdesen për jetën në fjalë: ato që lajnë dhe ushqejnë dhe edukojnë dhe me përkushtim thurin kapela e çanta kashte me gjithë dashurinë e butësinë historikisht të pashpërblyer: Gratë.

O kryq i moçëm jetëgjatë

Mbi atë kodrinë të largët

Dhe unë i falem kryqit të moçëm jetëgjatë

Sot në Bahamas është e Premtja e Shenjtë. Njëzet e pesë gradë nën hije. Përveç territorit të Sheratonit, çdo gjë tjetër është e mbyllur.

Ndodhi krejt rastësisht, për arsye krejt sekulare, që tre ditët e fundit kam agjëruar. Uria ime tashmë ka marrë përmasa të dhunshme. Tek këndi i sanduiçeve brenda në hotel, një grua e zezë

që përkujdeset për bufenë ankohet për turistët; pse nuk e kanë mbyllë edhe këtë dyqan, dhe pse turistët një herë në jetë nuk rrinë pa ngrënë. Unë po vdes dhe porosis një sallatë me pulë dhe djath të butë gjize dhe sallatë me domate dhe një vezë të zier fort dhe një simite të ngrohtë me kryq dhe një lëng molle.

Ajo më sheh me gërdi.

Për të qenë e sinqertë, orari i stomakut tim ka fyer rëndë ritualet religjioze, dhe serioze, të saj. Asnjëra nga ne nuk kërkon falje. Ajo hedh shumë piper mbi sallatën time të pulës, ndërsa unë dëgjoj zërin e lartë të radios që jep muzikë kishtare, të cilën ajo e dëgjon për të ngushëlluar veten. Është një version *country* i këngës “Kryqi i moçëm jetëgjatë”.

Kapërdij një copë të madhe pule dhe sytë më mbushen me lot. Nuk e kam nga piperi. Unë, megjithatë, jam e bija e një indiani perëndimor. Muzika e të Premtes së Shenjtë mbizotëron mbi atmosferën plot lagështi.

Dhë unë i falem kryqit të moçëm jetëgjatë

Mendja më fluturon, më shpejt se një avion 747, në Brooklyn, tek shtëpia e prindërve të mi, aty ku mot për mot pyesnim veten nëse terri do të kaplonte qiellin kur Krishti të hynte në varr. Qielli do të nxihej nëse Zoti ishte në qiejt e vet. Dhe rreth orës tre pasdite, pasi mbaronim shërbesën tonë të trishtë kishtare në lagjen Shën Filipi, e krejt të shtangur ngulnim sytë te mbulesa sterrë mbi altarin e artë dhe mbi qirinjtë e hollë e të pandezur, prisnim diellin të rikthehej mes dritareve të larta gotike dhe të përligjte kështu besimin tonë se Zoti, për Pashkë, do të ngrihej përsëri.

Si e kisha zakon ta përkulja kokën time kur përmendej emri i Krishtit: e ngazëllyer përulesha për të nderuar Lartmadhërinë e tij.

Gojën e kam plot sallatë. Më duket sikur nuk do të ngopem kurrë. Nuk e di se si mund t’ia fal vetes këtë vepër penale ndaj oreksit tim. E vetmja grua tjetër e zezë në këtë hapësirë, ajo që me plot mosmiratim më pregatiti këtë ndërhyrje të shijshme ndaj

agjërimit tim, nuk e thotë asnjë fjalë. Ajo nuk ka luajtur mendsh. Ajo e di se ka nevojë për këtë punë. Besoj se ajo e ka vënë re se, së paku, unë porosita edhe një simite me kryq. Ndoshta ma vlerëson këtë gjest. Por jo, mendoj se nuk mjafton.

Papritmas më vjen dëshira të eci. Ngjitem përpjetë një rruge kodrinore, ngadalë. Nëpër ngjyrat e shkreta pasteli të këtij qyteti të vogël, arrij tek një shtëpi e bardhë dhe rozë, në një plantacion sheqeri. Tek porta e kryesore më shfaqet një statujë panevojshmërisht e madhe e Kristofor Kolombit, që më sheh, ose provon me më pa, nga lart. Dorën e ka mbledhë në grusht dhe e ka mbështetë tek ija e tij. E shoh, i qesh pa fije konsiderate, dhe kthej rrugën majtas.

Është koha të bëj valixhen gati. Të marr avionin. E skanoj me sy dhomën e hotelit se mos kam harruar diçka. Ajo kartela e bardhë e raportit vazhdon e rri mbi tavolinën e shkrimit.

“I/e dashur mysafir”, shkruan aty, nën emrin “Ullirja”. “Unë jam shërbyesja e juaj për sot. Ju lutem më vlerësoni: Shembullore. Mirë. Mesatare. Dobët. Faleminderit”.

E shënoj këtë moment të Sheratonit Britanik Kolonial në bllokun tim. Si do të më vlerësonte “Ullirja” mua? Çka do të thotë të jemi “të mira” për njëra-tjetrën? Çka na duhet për një vlerësim të tillë?

Por nuk kam kohë. Nuk mund të vonohem edhe sikur dikush të më ofroj një supë breshke a një byrek me mëlçi a ndonjë specialitet me guaska kërmijsh deti. Kam pushuar, këtu në Bahamas, dhe jam gati t’i kthehem punës, jetës time. Por e ndjej se si lëkura e trupit dhe mendja ime kanë ndryshuar. E kuptoj më vonë, gjatë fluturimit me Deltën rrugës për në shtëpi se, në të vërtetë, po më djeg lëkura.

Për aq sa shoh, idetë e rëndomta mbi marrëdhënien mes racës dhe klasës, apo supozimi i një uniteti gjinor, nuk qëndrojnë. Dyshoj të kenë pasur ndonjëherë kuptim. Si mund ta shpjegojmë ndryshe faktin se përballë momenteve serioze, popullsia e zezë

vajton gjithmonë mungesën e solidaritetit. Dhe nëse uniteti mes atyre që vuajnë nga shtypja seksuale ndodh natyrshëm, atëherë pse ne gratë, popullatë dërrmuese mbi këtë tokë, vazhdojmë ta kemi këtë problem?

Avioni është gati për t'u nisur. Shtrëngoj rripin e sigurimit dhe e lë turbullimën e kokës sime të lodrojë e lirë. Po: raca dhe klasa dhe gjinia janë po aq të vërteta sa edhe moti. Por, se çfarë domethënie kanë ato për lidhjen mes dy individëve, ngelet e paqartë, dhe njëjtë sikur moti, e paparashikueshme.

Këta faktorë të racës, klasës dhe gjinisë, kolapsojnë totalisht sa herë provojmë t'i përdorim ato si koncepte që automatikisht prodhojnë ndërlidhje. Ato mund të shërbejnë si indikatorë përballë një konflikti të përbashkët, por si elementë që krijojnë lidhje, janë po aq të besueshme sa vetë mundësia për të pasur reshje pas disa ditësh.

Mendoj me vete edhe se si një pjesë e madhe e dhimbjes rreth organizimit do të mund të shmangej, nëse njerëzit do ta kuptonin se bashkëpjesëmarrja në vuajtje nuk do të thotë patjetër edhe bashkëpjesëmarrje në ndryshim: *Kur t'i flakim përbindëshat që na kanë hypur mbi shpinë, secila prej nesh e ka lirinë të vrapojë andej nga i do zemra.*

Dhe jo vetëm kaq: “unë” dhe “Ullirja” jetojmë brenda të njëjtit konflikt që nuk e kemi krijuar ne, por, edhe pse brenda këtij konflikti të dyja jemi të lënduara, unë megjithatë mund të jem një nga përbindshat që ajo duhet ta zhdukë nga universi i saj, dhe në njëfarë kuptimi, edhe ajo mund të jetë një nga përbindëshat e mi.

Po mendojmë të gjej fjalët e duhura për të përshkruar *dallimin* mes identitetit të përbashkët që na është imponuar, dhe identitetit individual që çdonjëra nga ne e zgjedh, sa herë na jepet kjo mundësi.

Është pikërisht ky *dallim* që na bën të ngelemi të çiltër si fëmijë sa herë vërejmë një detaj të veçantë a mësojmë diçka të re për dikë që nuk e njohim, por me të cilën duhet të kishim një *lidhje*

sepse kështu ka vendosur një palë e tretë, dhe që duam apo nuk duam ne, na manifestohet si armiku ynë i përbashkët. *Çfarë ndodh përtej idesë së këtij armiku dhe përtej pasojave nga ky armik?*

Dua të them se ajo çfarë na lidh përfundimisht nuk mund të jetë armiku. Lidhja më qenësore mes nesh duhet të jetë nevoja që kemi për njëra-tjetrën. Me fjalë të tjera, lidhja mes nesh përcaktohet jo vetëm në bazë të asaj se kush jemi, por në bazë të asaj se çfarë mund të bëjmë për njëra-tjetrën.

Me këtë fluturim po i kthehem edhe punës time. Këtë semestër po jap lëndën e poezisë bashkëkohore të grave. Një nga enigmat që kam vendosur të zgjidh, bashkë me studentët e mi, është ajo e marrjes së përgjegjësisë kur nuk kemi pushtet. Për javë të tëra jemi kacafytë me këto ide, derisa një ditë pas mësimit, një grua e re e zezë, nga Afrika e Jugut, më kërkoi ndihmë.

Sokutu më tha se për disa javë rresht ishte “në një trans” dhe se dy javët e fundit nuk kishte fuqi as të hante.

“Çfarë po ndodh?” e pyeta e trembur nga pamja e saj e dobët, dhe nga trupi i saj që po dridhej.

“Burri im. Ai pi tërë kohës. Më rreh. Përfundoj në spital. Nuk mund të ha. Nuk di, nuk di asgjë.”

Ishim në zyrën time kur më foli për situatën e saj. U përmbajta, dhe nuk pata guxim t’i flisja për frikën dhe tmerrin që ndjeva. Ajo po e tërhiqte veten zvarrë, ditë për ditë, krejt e frikësuar.

Burri i saj, një i ri i zi nga Afrika e Jugut, pinte aq shumë sa çdo ditë ushtronte dhunë të tmerrshme ndaj saj.

Sokutu më tha se trupi i saj nuk mbante më asgjë. Derisa më fliste, me sy dukej se nuk peshonte më shumë se 40 kg. Kishte përfunduar edhe në spital, kur burri i saj tërbohej dhe e rrihte.

Të dy i njihja nga disa takime që kisha organizuar me një grup studentësh në mbështetje të përpjekjeve çlirimtare të Afrikës së Jugut.

Një si pështjellim m’u mblodh në fyt. Ja një lidhje e pritshme:

ky burrë dhe kjo grua e kanë lënë vendlindjen e tyre për t'i ikur urrejtjes, e çka tash? Ai po shkatërron veten. Nëse dikush nuk e ndalon, ai pa dyshim do ta vrasë edhe gruan e tij.

Ajo kishte nevojë për një doktor, menjeherë. Ishte urgjencë mjekësore. Ajo kishte nevojë për mbrojtje. Ishte krizë sigurie. Ajo kishte nevojë për strehim për gratë e dhunuara, si dhe për terapi personale dhe për këshillim ligjor. Asaj i duhej një shoqe.

U ktheva në zyrë dhe mora në telefon secilin numër që e gjeta në librin me numrat telefonik të universitetit, që ndoshta mund të ofronte ndonjë ndihmë. Nuk gjeta asnjë zgjidhje. Nuk kishte asnjë ndihmë institucionale që mund ta mbështeste Sokutun dhe problemet e saj të llahtarshme, të gjithanshme, të zakonshme, prej një gruaje.

Mora në telefon edhe disa studentë. U këshillova edhe me dekanin e Departamentit të Anglishtes. Kërkova ndihmë nga të gjithë.

Më në fund, një studente tjetër e imja, Keti, një grua e re nga Irlanda, që ishte aktive në kampus me aktivitetet e IRA-s, më ktheu përgjigje. Më kërkoi më shumë detaje. Ia thashë të gjitha.

“Burri i saj është një alkoolist”, më tha Keti, “Një gjë duhet ta kemi të qartë për alkoolistët. Ata janë ndryshe nga gjithçka e çdo gjë tjetër. Nuk është sëmundje që trajtohet si gjithë të tjerat”.

E dëgjova, plot frikë. A do të thotë kjo që s’kemi asnjë rrugëdalje?

“Jo, nuk po e them këtë gjë”, m’u përgjigj. “Por duhet ta kemi parasysh gjatë tërë kohës faktin që ai është pijanec, përndryshe ai mund ta vrasë atë. Ose mund të vrasë veten.”

“A mund të vish me mua”, e pyeta, pasi heshta. “A mund të vish me mua, të shohim nëse mund të bëjmë diçka bashkë, ta ndihmojmë?”

Keti më tha që mund të vinte, por kishte pak turp: Sukotu vinte nga Afrika e Jugut. Çfarë mund të mendonte për Ketin?

“Nuk e di”, i thashë. “Ta provojmë”.

U nisëm të gjenim një dhomë konvikti për gra të dhunuara. Ishte vonë dhe nata kishte errësuar gjithçka.

Me makinën time e ndoqa Ketin në Volksvagenin e saj, ku në pjesën e mbrapme ishte ngjitur një shenjë ku shkruhej: BOBBY SANDS MË NË FUND I LIRË. E lexova dhe rilexova këtë fjali, deri sa m'u megjulluan sytë. Ja ku ishte edhe një lidhje tjetër: Bobby Sands dhe Martin Luther King, Jr. dhe kujt do t'i shkonte mendja? Unë nuk do ta kisha besuar kurrë; jam rritur e terrorizuar nga fëmijët irlandez të lagjes sime nga të cilët edhe kam dëgjuar për herë të parë fjalën "nigga". Dhe ja ku isha, duke i shkuar nga pas gruas irlandeze, drejt dhomës së gruas së zezë nga Afrika e Jugut. Po shkonim drejt dhomës së saj për të shpëtuar një jetë bashkë.

Kur u futëm te ajo dhomë e vogël na erdhi si zor dhe nuk po gjenim vend. Sokutu u mundua të na priste me bujarinë më të madhe, sikur të ishim ne mysafirë nderi. Sikur u befasua nga prania e Ketit, por mbi të gjitha e kaploi një ndjenjë e madhe çlirimi dhe gëzimi, sepse ne ishim aty, afër saj.

Nuk dija si t'i thoja se nuk na duhej një mikpritje aq e përzemërt, se në fakt, qëllimi i vizitës sonë ishte krejt tjetër: ishte mosushqyerja e saj dhe rreziku ekstrem që i kanosej trupit të saj.

Më në fund, Ketu u ul përtokë dhe ja zgjati duart Sokutus.

"Jam këtu", i tha me qetësi, "sepse June më ka thënë se çfarë të ka bërë vaki. Të kuptoj shumë mirë. Burri jot është alkoolist. Kjo është sëmundje. E njoh mirë. Babai im ka qenë alkoolist. Ai në fund vrau veten. Por desh vrau edhe nënën time. Dua të jemi shoqe".

"Ah", ishte tingulli i vetëm që doli nga goja e Sokutut. Pas pak të dy studentet u përqaftuan. Në atë moment çdo gjë ndryshoi, dhe unë e pashë me sytë e mi se si ndodhi dhe jam krejt e bindur se ndodhi: kjo lidhje.

Dikur morëm në telefon edhe policinë dhe shkëmbyem numrat e telefonit dhe bëmë plane për atë natë dhe për mëngjesin e

nesërm, dhe gruaja e re nga Afrika e Jugut u largua nëpër korridorin e konviktit, duke na thënë mirëupafshim dhe faleminderit.

Unë eca pas atyre të djave, një irlandeze dhe një afrikanojugore, dhe i pashë tek ecnin siç ecin dy motra, duke u përqaftuar, duke pëshpëritur, të sigurt që ato kishin njëra-tjetrën dhe aty kuptova se nuk kishte rëndësi se kush ato ishin, por se çfarë ato dinin, dhe çfarë ato ishin të gatshme të bënin për të arritur aty ku të dyja, më në fund, do të ishin të lira.

Shoh përtej dritares së avionit dhe shoh retë që nuk janë vrastare dhe e di se një ditë, shumë shpejt, re të tjera mund të formësohen dhe mund të na vrasin të gjithëve.

Dhe i them Jo faleminderit stjuardesës që më ofron një pije. Shoh rreth meje njëqind fytyra të panjohura në këtë fluturim, me pijet që mbajnë në dorë, dhe mendoj se si më duhet të krijoj një lidhje të vërtetë mes nesh, sot dhe këtu, para se të vijnë retë vrastare, dhe neve leckamanëve të na gjejnë duke u bashkuar, tepër vonë.

Përktheu: Doruntina Vinca

BIOGRAFITË

MARY BEARD është studiuese klasicizmi dhe profesoreshë në kolegjin Newnham, Cambridge. Veprat më të njohura të saj janë *Pompeii: The Life of a Roman Town* (Pompeii: Jeta e një qyteti romak, 2008) dhe *SPQR: A History of Ancient Rome* (SPQR: Një histori e Romës së lashtë, 2015). Libri i saj i fundit titullohet *Women & Power: A Manifesto* (Gratë dhe pushteti: Një manifesto, 2017).

SILVIA FEDERICI është studiuese, mendimtare dhe aktiviste radikale e traditës marksiste feministe. Ajo ishte një nga themelueset e Kolektivit Feminist Internacional dhe organizatore e fushatës Pagë për Punë Shtëpiake. Ajo është autore e shumë librave, përfshirë *Caliban and the Witch: Women, the Body, and Primitive Accumulation* (Kalibani dhe shtriga: Gratë, trupi dhe akumulimi primitiv, 2004).

EMMA GOLDMAN (1869–1940) njihet si aktiviste, mendimtare anarkiste dhe një nga zërat e parë për avancimin e të drejtave të grave, kontraceptivëve, lirisë së fjalës dhe sindikatave. Ajo ka luajtur rol kyç në zhvillimin e filozofisë politike anarkiste në gjysmën e parë të shekullit 20-të.

JOHANNA HEDVA është shkrimtare, artiste, muzikante dhe astrologe koreano-amerikane, e lindur dhe e rritur në Los Angeles në një familje shtrigash. Praktika e saj e punës përfshin magjinë, sehiret dhe parashikimet e së ardhmes, që çojnë drejt gjendjes mistike mes tërbimit dhe ekstazës. Sot ajo jeton në Los Angeles dhe Berlin.

JUNE JORDAN (1936–2002) ishte poete, eseiste, dramaturge, gazetare, shkrimtare librash për fëmijë, aktiviste dhe pedagoge. Ajo është marrë kryesisht me seksizmin, racizmin, anglishten e zezë dhe klasën. Gjatë kohës që jepte mësim në SUNY Stony Brook, ajo udhëhoqi Qendrën për Poezi, dhe më vonë, në universitetin Berkeley, California, themeloi qendrën Poezia për Njerëz.

URSULA K. LE GUIN (1929–2018) ishte eseiste, poete dhe shkrimtare, e njohur mbi të gjitha për librat e saj radikal fantastiko-shkencor. Një nga librat e saj më të shquar, *The Left Hand of Darkness* (Dora e majtë e errësirës, 1969), ndryshoi thelbësisht rolin që luan letërsia fantastiko-shkencore në sfidimin e roleve gjinore.

AUDRE LORDE (1934–1992) ishte, siç e quante ajo veten, grua “e zezë, lezbike, nënë, luftëtare dhe poete” e cila gjithë jetën dhe punën e saj krijuese ia dedikoi luftës kundër padrejtësive sa i përket të drejtave civile, racizmit, seksizmit, klasicizmit, heteroseksizmit, homofobisë dhe përsiatjes mbi identitetin e gruas së zezë.

ADRIENNE RICH (1929–2012) ishte poete dhe eseiste e njohur për shkrimet e saj mbi feminizmin, gjininë, seksualitetin, racizmin dhe të drejtat civile. Ajo është autore e dhjetra librave me poezi dhe prozë, përfshirë, *Diving into the Wreck* (Në rrënojat e fundosura, 1973), *Of Woman Born: Motherhood as Experience and Institution* (Lindur nga gruaja: Amësia si përvojë dhe institucion, 1976), dhe *The Dream of a Common Language* (Ëndrra për një gjuhë të përbashkët, 1978).

VALERIE SOLANAS (1936–1988) ishte shkrimtare dhe artiste radikale. Ajo shkroi *SCUM Manifesto* (Manifesti SKAM) në vitin 1967 dhe dramën *Up Your Ass* (Fute në bythë) në vitin 1965. Si rezultat i atentatit të saj kundër artistit Andy Warhol, Solanas kaloi një pjesë të madhe të jetës nëpër institucione mendore, duke bërë një jetë radikale, nëpër skutat e shoqërisë.

XTIAN W janë shkrimtar/e dhe performues/e queer/femme. Me origjinë nga Amerika Jugore, ata jetojnë, punojnë dhe rregullojnë thonjtë në Brooklyn.

RADICAL SENSE

VËLLIMI 1

BOTIM NGA
28 November

AUTORË/E

Mary Beard, Silvia Federici, Emma Goldman, Johanna Hedva,
June Jordan, Ursula K. Le Guin, Audre Lorde, Adrienne Rich,
Valerie Solanas, xtian w

PËRKTHYEN

Aurora Birbilaj, Gresa Hasa, Silvi Naçi, Mikela Kakeli, Vasilika Laçi,
Anna Shkreli, Doruntina Vinca

REDAKTORE

Doruntina Vinca

KORREKTORE

Ana Zhibaj

(ç) 2020, 28 November
ISBN 978-9928-4641-0-1

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

305 -055.2 (082)

1.Gra 2.Përkatësia gjinore 3.Feminizmi

28 November

Rruga 28 Nëntori

Tiranë, Shqipëri

info@28november.al

www.28november.al



Adrienne Rich
Gratë dhe nderi: Disa shënime mbi të gënjerit (1975)

Audre Lorde
Përdorimi i erotikës: Erotika si pushtet (1978)

Mary Beard
Zëri publik i grave (2017)

Valerie Solanas
Manifesti SKAM (1967)

Silvia Federici
Pagë kundër punëve të shtëpisë (1974)

Johanna Hedva
Teoria e gruas së sëmurë (2016)

Ursula K. Le Guin
Teoria trastë e rrëfimit (1986)

Emma Goldman
Tragedia e emancipimit të gruas (1906)

xtian w
Midis përgjithmonë & kudo ku je: Një trans poetikë
jo binare (2018)

June Jordan
Raportim nga Bahamas (1982)

